



KRAHËT E THYER

Halil Xhubran



© LOGOS·A
S H K U P
PRISHTINË
T I R A N Ë
2 0 1 3



LOGOS-A

Halil Xhubran
KRAHËT E THYER

Boton: LOGOS-A
Biblioteka: DIVAN

Për botuesin: Adnan Ismaili
Kryeredaktor: Husamedin Abazi
Redaktor biblioteke: Milazim Krasniqi

Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjyshi
Redaktor teknik: Halil Berisha
Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili
Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup
Shtypi: Focus Print - Shkup

ISBN 978-9989-58-489-3

www.logos-a.com

Copyright©Logos-A, 2013

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.

Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.

KRAHËT E THYER

Xhubran Halil Xhubran

Përktheu nga arabishtja:
MA Jahja Hondozi

Titulli në original:

الأجنحة المتكسرة

جبران خليل جبران

El-Exhniha El-Mutekessire

Xhubran Halil Xhubran

Bejrut - Liban

El-Mektebe Eth-Thekafije

2003



PËRMBAJTJA:

PARATHËNIE.....	7
Letërsia dhe krijimtaria e tij.....	13
Veprimtaria letrare e Xhubranit	15
Vepra <i>Krahët e thyer</i>	17
 PROLOG	 21
 DËSHPËRIMI I HESHTUR	 25
DORA E FATIT	29
PRANË DERËS SË TEMPULLIT	35
PISHTARI I BARDHË	41
STUHIA	45
LIQENI I ZJARRTË	59
PARA FRONIT TË VDEKJES	77
NDËRMJET ASTARTËS DHE KRISHTIT	93
FLIJIMI	99
SHPËTIMTARI	109

*“Asaj që e vështron diellin me ngulm,
që e kap flakën me gishtërinj të butë,
që e dëgjon himnin e Shpirtit të Gjithmbarshëm përtej
bërtimës dhe ulërimës së të verbërve,
M. E. H. ia kushtoj këtë libër”.*

Xhubran

PARATHËNIE

Qysh në vitet '80 të shek. XIX e deri në dekadën e tretë të shekullit të kaluar, një numër i konsiderueshëm letrarësh arabë nga Libani, Siria dhe Egjipti filluan të shpërnguleshin në të dy Amerikat, për të kërkuar në vendet e arit, siç shpresonin, buri-me më të pasura të ekzistencës, gjë që do t'ua siguronte atyre një jetë më të kënaqshme.

Këtu, ata themeluan kolonitë e tyre në të cilat kultivonin kulturën dhe traditën arabe. Kësisoj, u themelua e ashtuquajtura "*letërsia e migrimit*", e cila krijimet e veta më produktive i dha në pjesën e parë të shekullit të kaluar.

Këtë letërsi e krijoi një grup letrarësh nga radhët e emigrantëve arabë në SHBA, të cilët për nga shtrirja gjeografike ndahen në dy grupe:

1. Shkrimtarët që emigruan në viset e Amerikës veriore dhe përbënin grupin i cili u quajt الرابطة القلمية (*Shoqata e pendës*) dhe

2. Shkrimtarët që emigruan në shtetet e Amerikës Jugore, si në: Brazil, Argjentinë, Meksikë, Venezuelë etj. Atje ata formuan العصبة الأندلسية (*Grupin e Andaluzisë*).

Ç'është e vërteta, ndonëse jo shumë i njohur, ekzistonte edhe një grup i tretë letrarësh të cilët nuk u përfshinë në asnjë prej dy grupeve të mëparshme. Këta nuk themeluan ndonjë grup të posaçëm për shkak të shpërndarjes së tyre në disa shtete të Evropës, Afrikës, në Australi si dhe në disa shtete arabe.

Falë komunikimit intenziv me krijimtarinë joarabe dhe prodhimin artistik letrar të rrethit qytetëruar perëndimor, këta letrarë e kanë persiatur letërsinë në një mënyrë të re dhe kri-

juan vepra të tilla artistike të cilat i dhanë impuls të fuqishëm renesansës letrare arabe.

Shkrimtarët e këtyre grupeve karakterizohen me interesimin më të madh për njeriun dhe natyrën, prirjen për analizë psikologjike (që deri atëherë ishte e rrallë në letërsinë arabe), me elasticitet dhe ritëm modern të gjuhës.

Letërsia e migritimit karakterizohej edhe me disa gjini të reja letrare, si: romani, tregimi, drama etj.

Përsa i përket *Shoqatës së pendës*, ajo paraqiste një grup poetik homogjen, të cilin e krijuan më 1920 dhjetë entuziastë të afërt për nga shija artistike dhe afinitetet e tyre. Në krye të saj ishte libanezi i talentuar, Xhubran Halil Xhubran¹ (1883-1931).

Duke mos i ndërprerë kurrë kontaktet e ngushta me letërsinë arabe në Lindje, Xhubrani – si një shtyllë ideore e shpirtërore e emigracionit arab në SHBA, organizoi tërë shkollën letrare (*mehxher*), ku letrarët arabë, duke vepruar në formë të organizuar, kryesisht ndërmjet dy luftërave botërore, kanë pasur veprimtarinë e vet botuese në gjuhën arabe dhe i kanë botuar afro tridhjetë gazeta në gjuhën arabe, edhe pse disa prej tyre me ndërprerje të kohëpaskohshme.

Shoqata e pendës për një deçenie të veprimtarisë ndikoi fuqishëm në orientimin e letërsisë moderne arabe kah rrjedhat e reja. Në këtë shoqëri, e njohur poashtu edhe si *Poetët emigrantë* (شعراء المهجر), Xhubrani ambicioz i tuboi letrarët më të talentuar libanezë, në mesin e të cilëve ishin: Mihail Nuajme (1889-1988), Ilija Ebu Madi (1889-1957) dhe Nesib Arida (1887-1946).

Veprimtaria botuese e këtyre letrarëve ishte e përqendruar kryesisht në disa revista, siç ishin: *Es-Semir* (Njujork, 1929), *El-Funun* (1913), *Es-Saih* (1912) dhe *El-Muhaxhir*.

¹ E shohim të arsyeshme të theksojmë se jo rrallë emri i Xhubranit shkruhet gabimisht në variantin Khalil Gibran.

Shoqata e pendës ka qenë e pranishme në jetën letrare 11 vjet. Me vdekjen e Xhubranit, në vitin 1931 në Njujork, merr fund edhe veprimtaria e organizuar e emigracionit letrar arab. Një numër i konsiderueshëm i gazetave dhe revistave përfundimisht u shua, pasi që shumë letrarë tashmë u kthyen në vendet arabe.

Njëkohësisht, me vdekjen e tij, shuhet edhe *Shoqata e pendës*, kryetar dhe shtyllë e së cilës ai mbeti deri në fund të jetës.

Të paktë janë ata letrarë në botë, vepra e të cilëve gëzon një nam aq të madh në të dy rrethet kulturore-qytetëruese, në atë oriental-islam dhe perëndimor-evropian, siç e gëzon për nga tematika dhe opusi krijues i Halil Xhubranit, poet, prozator dhe piktor të cilin perëndimi e quajti me të drejtë 'Danteja i shek XX'.²

Xhubran Halil Xhubran është një figurë e shquar në letërsinë bashkëkohore arabe. Ishte i njohur për ambicien e tij të pafund, për rezistencën e tij kundër të gjitha traditave të prapambetura shoqërore dhe për vendosmërinë e tij në ballafaqimin me varfërinë, nga e cila vuajti që në vegjëli.

Xhubran Halil Xhubran u lind më 6 janar 1883 në Libanin verior, në fshatin Bsherra që ndodhet pranë burimit të lumit Kadisha.

Në moshën 12-veçare, së bashku me familjen e tij, emigron në Boston (SHBA), për shkaqe ekonomike. Aty kaloi një pjesë të jetës, ndërsa pjesën tjetër e kaloi në Njujork. Që në vegjëli kishte shfaqur talent të madh për të pikturuar, prandaj në Boston një kohë mëson për pikturë.

Duke qenë se herët është ndarë nga bota arabe, familja e tij dëshironte që ai ta përvetësojë mirë gjuhën arabe dhe ta njohë kulturën e Lindjes. Në fakt, ishte nëna e tij ajo e cila, duke da-

² I magjepsur me veprën e Xhubranit, presidenti amerikan, Roosvelt, në kohën e tij pati thënë: "*Xhubrani është stuhia e parë e cila fryu nga Lindja në Perëndim, mirëpo është një stuhi që solli vetëm lule*".

shur që ai të absorbojë më shumë trashëgiminë e tyre lindore sesa atë perëndimore e cila e tërhiqte, në moshën 15 vjeçare e kthen në vendlindje, ku studion në shkollën maronite dhe në institutin e edukimit të lartë (*El-Hikme*) në Bejrut.

Xhubrani këtu vijon mësimet e gjuhës arabe, dhe pikërisht kjo periudhë kohore, qëndrimi katërvjeçar në Bejrut (1898-1902) ka lënë gjurmë të pashlyer në personalitetin, krijimtarinë dhe qenien e tij poetike.

Pas përfundimit të studimeve, në vitin 1902 sërish kthehet në Boston, ku përjeton dhembjen e vdekjes së nënës dhe vëllait (1902-1904).

Gjatë ekspozitës së tij të parë të pikturave mistike më 1904 në Boston, Xhubrani, 21 vjeçar takohet me mikeshën e tij të ardhshme, 31 vjeçaren Mary Elizabeth Haskell.

Më vonë, Xhubrani do ta përshkruajë atë si *“engjëlli cila më udhëzoi kah ardhmëria e ndritshme dhe më drejtoi kah suksesi intelektual dhe financiar”*.

Ata dy krijuan një miqësi të rëndësishme që zgjati deri në fund të jetës së Xhubranit.

Krahas ofrimit të përkrahjes morale, Haskell e ndihmoi edhe materialisht, ndonëse edhe vetë nuk ishte aq e pasur. Xhubrani, nga ana e tij, këtë miqësi stabile e shpërblente, mes tjerash, duke ia kushtuar një numër të veprave gruas me iniciale M. E. H.

Ishte ajo e cila e zbuloi talentin e tij të madh për art, prandaj e dërgoi në Paris ku qëndroi dy vite (1908-1910). Gjatë kësaj kohe, Xhubrani i viziton edhe qendrat e tjera evropiane: Londrën, Brukselin dhe Romën. Njihet me veprat e poetit anglez, William Blake si dhe me veprat e filozofit gjerman, Friedrich Nietzsche, idetë e të cilit lanë ndikim të madh tek ai.

Gjatë dy viteve qëndrimi në Paris, Xhubrani studion artin tek Auguste Rodin. Gjatë kësaj kohe ekspozon piktura, për të

cilat vetë Auguste Rodin thotë se mund të krahasohen me veprat figurative të poetit dhe piktorit të madh, William Blake.

Pas kthimit nga Parisi, Xhubrani vendoset në një banesë në Greenwich village, në Njujork, ku qëndroi nga viti 1911 e deri në vdekje.

Ajo banesë njëdhomëshe, të cilën ai e quante 'kthinë të shkretuar', pas një kohe do të shndërrohet në çerdhe të shkrimtarëve dhe artistëve, veçmas letrarëve emigrantë arabë.

Më vonë, Xhubrani do të njihet me një mike tjetër, Barbara Young, një mësuese e re e gjuhës angleze e cila synonte të bëhej poete. Aq shumë ishte e magjepsur me Xhubranin, sa që edhe pas vdekjes së tij, tërë jetën ia kushtoi studimeve dhe artikujve për të. Më 1945 e boton librin biografik *This Man from Lebanon* (Ky njeri nga Libani).

Xhubrani krijoi një lidhje dashurie me poeten Mej Zijade, e cila jetonte në Kairo. Ata korrespondonin që nga viti 1912 e deri në mars 1931, gjysmë muaji para vdekjes së Xhubranit. Letrat e ndërsjella mes tyre përmbanin studime rreth veprave të Xhubranit dhe zhvillimet e lëvizjes kulturore në Njujork dhe Egjipt. Kjo lidhje vazhdoi në këtë mënyrë pa u takuar asnjëherë.

Lufta e parë botërore i ofroi Xhubranit materiale mjaft të bollshme dhe të pasura për vështrim rrënjësor mbi karakterin e forcës dhe natyrën e dobësisë në shpirtin njerëzor.

Xhubrani fitoi famë të madhe në Amerikë, të tillë çfarë nuk arriti ta fitonte asnjë nga bashkëkohanikët e tij të talentuar. Veprat e tij i sollën përfitime të mëdha. Dhe derisa ishte në majën e famës letrare, e goditi sëmundja e tuberkulozit, nga e cila ndërroi jetë në spitalin *Vinsent* në Njujork, më 10 prill 1931.

Disa muaj pas vdekjes, më 21 gusht të të njëjtit vit, trupi i tij, sipas testamentit që ia ka lënë motrës, u transferua me anije në Liban, ku u prit me nderime të larta ushtarake dhe u varros

në një manastir, afër vendlindjes së tij, Bsherra. Që nga ajo kohë ky manastir bëhet muze i Xhubranit.

Kësisoj, sikur ishte realizuar vizioni i tij, i përmbledhur në poemën *Juve Libani juaj, e mua – Libani im*, ku, duke i përshkruar “bijtë e Libanit të tij me të cilët mburret”, thotë:

“Ata janë njerëz të cilët e braktisën Libanin duke mos pasur gjë pos zemrës entuziaste dhe muskujve të fortë, ndërsa kthehen në të me të gjitha të mirat e botës në duar dhe me kurora dafinash mbi kokë”.

Xhubrani iku pa arritur ta thoshte frazën e tij që e konsideronte mesazhin e tij në jetë. Ai i pati thënë njëherë mikeshtës së tij, Mej Zijade: *“Jo, nuk e kam thënë ende frazën time, dhe nga ky pishtar nuk doli gjë tjetër pos tymit ...”.*

Kështu e pati përshkruar njëherë Xhubranin mikesha e tij Mej Zijade: *“Xhubran Halil Xhubran është një njeri nga Libani, nga ky vend të cilin e goditnin vazhdimisht fatkeqësitë e ndryshme. Që në moshë të njomë u detyrua ta lë Libanin për të emigruar në Amerikë. Megjithatë, mendja, zemra dhe ndjenjat e tij mbetën në Lindje ... ishte perëndimor me trupin e tij, mirëpo mbeti lindor me idetë, synimet dhe ndjenjat e tij”.*

Xhubrani u nderua në shtete të ndryshme të botës me rastin e aktiviteteve të shumta të cilat e bënë të pavdekshëm emrin e tij. Disa prej tyre janë:

Kopshti i Xhubranit në Vashington. Në fillim të 90-ave të shekullit të kaluar, në Vashington u ndërtua një kopsht afër bibliotekës kombëtare, i cili u emërtua *“Xhubran Halil Xhubran”*.

Kongresi i parë botëror për Xhubranin. Në vitin 1999 universiteti Maryland (SHBA), në bashkëpunim me këshillin kombëtar të Xhubranit, organizoi kongresin e parë për Xhubranin me temën: *“Xhubran Halil Xhubran – pacifist dhe pionier për të drejtat e njeriut”*. Kjo koinçidonte me shpalljen e UNE-

SKO-s vitin 2000 – vit ndërkombëtar të paqes. Në kongres morën pjesë 42 studiues, profesorë universitarë, poetë dhe shkrimtarë nga shtetet e ndryshme të botës.

Kopshti i Xhubranit në Bejrut. Nën përkujdesjen e kryeministrit libanez, më 27 korrik 2000, kopshti i Bejrutit merr emrin e poetit, letrarit dhe filozofit libanez, Xhubran Halil Xhubran. Pllaka e bustit në kopsht mban frazën e Xhubranit: *“Sikur të mos ishte Libani vendlindja ime, do ta merrja Libanin për vendlindje timen”*.

Letërsia dhe krijimtaria e tij

I rritur me traditat e kishës maronite nga njëra anë dhe i zhytur në detin e qytetërimit islam, në anën tjetër, Xhubrani shumë shpejt do ta flakë formalizmin religjioz të stërgjyshërve të tij, duke sinkretizuar pak nga pak të dyja traditat.

Ai shfaqte interesim për filozofinë, fenë islame dhe atë krishtere. Në të kanë ndikuar edhe Ibn Sina, Ibn Rushdi dhe El-Gazali.

Halil Xhubrani e njihnte për mrekulli traditën e pasur të letërsisë arabe dhe pasurinë leksikore, pothuaj të paarrirë të gjuhës arabe. Nga ana tjetër, ai ishte i mahnitur me përvojat e letërsisë së rrethit perëndimor – në radhë të parë me veprën e W. Blake-ut dhe romansierëve të tjerë në përgjithësi, pastaj me veprën e W. Whitman-it dhe të tjerëve.

Siç shkruan Carl Brokelmann, romantiku libanez ka kultivuar një stil në të cilin nuk i ka paraprirë asnjë autor në gjuhën angleze e as në gjuhën arabe.

Shkrimet e tij shquhen me një imagjinatë të rrallë, me një shije të hollë dhe me stil të thjeshtë. Këto veçori vënë në pah si në gjuhën e tij arabe, ashtu edhe në atë angleze një dukuri e cila më vonë do të njihet si ‘poema prozaike’ apo ‘poezia bashkëkohore’.

Në shkrimet e tij vërehen dy rryma. Njëra veçohet me stil të fortë dhe me shpërthimet e tij ndaj parimeve fetare dhe fesë, ndërsa tjetra vë në dukje optimizmin dhe dëshirën për t'u kënaqur me jetën.

Derisa shumica e shkrimeve të tij të hershme janë në gjuhën arabe, pjesa më e madhe e veprimtarisë së tij, e botuar pas vitit 1918, është në gjuhën angleze.

Në krijimtarinë e Xhubranit nuk mbizotëron poezia, mirëpo pavarësisht kësaj duhet theksuar se poezitë e tij vlerësohen lart në traditën letrare arabe. Në këtë kontekst, duhet thënë se poezia e tij, në kuptimin poetik, shpeshherë i ngjan një gjinie të veçantë letrare, *muveshshesh*³, e cila lindi dhe u zhvillua shumë në letërsinë e Spanjës muslimane (në letërsi e njohur si “Letërsia andaluziane”).

Një numër të madh poemash Xhubrani i shkroi në formën e *muveshsheshu-t*.

³ *Muveshsheshat*-et andaluziane janë krijime lirike të cilat përveç mesazhit poetik, sjellin edhe forma të përzgjedhura të leksikut arab që e pasurojnë dhe e zbukurojnë kasiden klasike arabe. *Muveshshesh* në gjuhën arabe emërtohet kordelja e femrës flokëgjatë që ia shton bukurinë e saj. (Shih: *Lisanu-l-‘areb*, vëll. 15, f. 305-306, rrënja وشح). Dhe, ky lloj i poetikës arabe që lindi në fund të shek. IX dhe u kultivua me të madhe në Andaluzinë islame është emërtuar *muveshshesh* (bukuri apo zbukurim) në saje të bukurisë së kordeles së femrës. *Muveshshesh* është risi e plotë në poezinë arabe për shkak se në të, për herë të parë në vjershërimin arab, paraqitet edhe strofa, me një skemë të rregullt të rimës. *Muveshshesh*-u i është dedikuar të kënduarit. Temat e tij janë dashuria, gëzimet e jetës dhe përshkrimet e natyrës. Si një gjini e veçantë letrare, ajo paraqet arritje të madhe të poezisë klasike arabe për të cilën është karakteristike monorima dhe struktura e rreptë metrike. Veçoritë kryesore të *muveshshesh*-ut janë: llojlojshmëria e rimës dhe metrit, e ashtuquajtur “gjuha e thjeshtë, e kuptueshme” dhe mbi të gjitha melodja. Një nga poetët më eminentë andaluzianë, Ibn Kuzmani (vdiq më 1160), një poet endacak, do ta bëjë të famshëm *zexhelin*, një formë e posaçme e *muveshshesh*-ut, që këndohej me gjuhën e folur nëpër rrugët e qyteteve të Spanjës arabe. Ky lloj krijues i letërsisë është kultivuar më vonë edhe nga poetë eminentë bashkëkohorë arabë, si: Ahmed Shevki, Hafiz Ibrahim etj.

Për dallim nga poetët e tjerë të njohur arabë të cilët përdorin një gjuhë komplekse poetike, Xhubrani në veprat e tij futi, ndonëse të stilizuar, gjuhën e përditshme të popullit. Përmes kësaj edhe mund të shpjegohet deri diku popullariteti i tij i jash-tëzakonshëm në botën arabe, edhe ndër njerëzit më të thjeshtë.

Xhubrani kultivoi një lloj të veçantë të shkrimeve të shkurtra lirike dhe pikërisht në këtë gjini letrare ai arriti suksese më të mëdha.

Në periudhën e fundit të jetës, Xhubrani shkruan ekskluzivisht prozë të rimuar, gjë që i solli famë botërore.

Veprimtaria letrare e Xhubranit

Megjithë vështirësitë e shumta me të cilat u përball Xhubrani, shëndetin e tij të lig dhe jetën e shkurtër, ai la pas vetes një krijimtari të pasur – gjithsej 17 vepra në gjuhën arabe dhe angleze dhe mijëra piktura, disa prej të cilave i përdori gjatë ilustrimit të veprave të tij.

Halil Xhubrani shkruante njëlloj mirë si në gjuhën arabe ashtu edhe në atë angleze. Kështu, në shkrimet e tij vihen në pah si qytetërimi lindor ashtu edhe ai perëndimor.

Pjesën më të madhe të krijimtarisë së tij në gjuhën arabe e shkroi që në rininë e hershme. Që nga artikulli i parë të cilin e botoi me titullin *Ëndrra* dhe ekspozita e parë e pikturave të tij e deri më sot, përhapja e krijimeve të tij vazhdimisht zgjerohet. Në botë veprat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë.⁴

Nga viti 1923 Xhubrani fillon të shkruajë në gjuhën angleze me një sukses të rrallë. Gjatë tetë viteve të ardhshme, Xhubrani do të botojë shtatë vepra në këtë gjuhë.

⁴ Veprat e Xhubranit janë përkthyer në mbi 30 gjuhë të botës, kurse në gjuhën shqipe deri më tani janë përkthyer dy: *Profeti*, nga Nehat S. Hoxha (Rilindja, Prishtinë, 1987) dhe *Jezusi, biri i njeriut*, nga P. Lorenci (Kuvendi françeskan, Gjakovë, 2008).

Në mesin e këtyre veprave, më e njohura konsiderohet padyshim *Profeti*, një vepër që përmban 26 ese filozofiko-letrare, të shkruara në prozë e cila fitoi famë botërore. Me thjeshtësinë, thellësinë, mesazhet të cilat i përçon dhe me muzikën poetike, ajo e dridhi ndërgjegjen e botës arabe, amerikane dhe evropiane. *Profeti* shërbeu si literaturë studimi nëpër universitete të ndryshme botërore. Vepra u bë veçanërisht e njohur në vitet 60-ta. të shekullit të kaluar. Është përkthyer në më se 40 gjuhë të botës dhe ishte njëri ndër librat më të shitur të shekullit të kaluar në Amerikë. Dhe, vetëm dy vjet pas botimit, është përkthyer në gjuhën gjermane dhe franceze. *Profeti* konsiderohet libri i katërt në botë për nga përhapja.

Xhubrani konsiderohet poeti i tretë më i lexuar i të gjitha kohërave, pas Shekspirit dhe Lao Tze-s. Metropolet botërore sot mburren me disa nga veprat e tij artistike të cilat ruhen në bibliotekat dhe muzetë më të njohura të botës.

Veprat e tij në gjuhën arabe janë:

1. Pjesë mbi artin e muzikës, 1905 (نبذة في فنّ الموسيقى);
2. Nimfat e luginës, 1906 (عرائس المروج);
3. Shpirtrat rebelë, 1908 (الأرواح المتمردة);
4. Krahët e thyer, 1912 (الأجنحة المتكسرة);
5. Lot dhe buzëqeshje, 1914 (دمعة وابتهامة);
6. Procesione, 1919 (المواكب);
7. Stuhitë, 1920 (العواصف) dhe
8. Të rejat dhe raritetet, 1923 (البدائع والطرائف);

Ndërkaq, veprat e tij në gjuhën angleze janë:

1. I marri (The Madman, 1918)
2. Paraardhësi (The Forerunner, 1920)
3. Profeti (The Prophet, 1923) .

4. Rëra dhe shkuma (Sand and Foam, 1926)
5. Mbretëria e imagjinatës (Kingdom of the Imagination, 1927)
6. Jezusi, biri i njeriut (Jesus, The Son of Man, 1928)
7. Zotërat e tokës (The Earth Gods, 1931)
8. Endacaku (The Wanderer, 1932) dhe
9. Kopshti i profetit (Garden of the Prophet, 1933)

Të gjitha këto vepra shkrimtarët e mehxherit i përkthenin menjëherë në gjuhën arabe nën mbikëqyrjen e Xhubranit, me përjashtim të dy veprave të fundit, të botuara pas vdekjes së tij.

Vepra Krahët e thyer

Krahët e thyer – konsiderohet njëri prej romaneve më të njohura të tij në gjuhën arabe, madje paraqet njërën prej përpjekjeve të para të romanit arab. Për herë të parë vepra u botua në fillim të vitit 1912, nga botuesi *Mir'atu-l-garb*, në Njujork dhe për më shumë se katër dekada, ishte libri më i shitur në tërë botën arabe.

Krahët e thyer është një novelë autobiografike e cila flet për dashurinë e parë të autorit. Ajo paraqet një rrëfim romantik për një djalosh dhe një vajzë që i lidh dashuria e pastër shpirtërore, larg nga kënaqësitë fizike. Heroi i romanit është një djalosh tetëmbëdhjetë vjeçar i cili rrëfen tregimin e dashurisë së tij të parë, si një ndjenjë e shenjtë dhe e papërsëritur të cilën e përjetoi në një lidhje me një vajzë të quajtur Hala Daher, e cila në vepër paraqitet me emrin Selma Kerame.

Kjo vajzë, ndërkaq, fejohej dhe martohet me një person tjetër të pasur, duke iu nënshtuar kështu pa vullnetin e saj ligjeve dhe traditave të kohës. Autori këtu flet në formën e vetës së parë, respektivisht e bën veten personazh kryesor të rrëfimit.

Vepra njëherësh është edhe një tregim në të cilin autori përmes fatit të heroinës kryesore e akuzon shoqërinë patriarkale, viktimë e së cilës ishte edhe ajo, meqë *“burri e blen autoritetin dhe famën, mirëpo është gruaja ajo e cila e paguan atë çmim”*.

Xhubrani mendon se vdekja e liron njeriun nga robërimi i trupit dhe burgu i materies dhe se vetëm jeta pas vdekjes është jeta reale. Kjo shihet më së miri në rrëfimin e Xhubranit që e paraqet përmes njërit prej personazheve të tij, të quajtur Faris Kerame, i cili duke qenë në shtratin e vdekjes, i drejtohet së bijës me këto fjalë: *“Lëre trupin tim të pushojë me ata që tashmë pushojnë, dhe lëre shpirtin tim të zgjohet, meqë agimi tashmë ka dalë, e ëndrra ka marrë fund”*.

Sipas modelit të shumë romantikëve, edhe Xhubrani këtu thekson dualizmin e shpirtit dhe materies, me ç’rast e shenjtëron shpirtin, kurse e nënçmon materien, pasi *“etja e shpirtit është më e madhe se sa ngopja e materies, ndërsa frika e shpirtit është më e dashur se sa qetësia e trupit”*.

Si zakonisht, Xhubrani në këtë roman të tij e ngrit zërin kundër ligjeve njerëzore të cilat i konsideron të pavlera, meqë janë prodhim i njeriut, derisa ligji i dashurisë është më i fortë duke qenë se paraqet ligj qiellor. Aty, ai shfaq poashtu edhe kundërshtimin dhe mllëfin e tij ndaj klasës aristokrate, prijësve fetarë dhe pasanikëve të cilët e legalizojnë çdo gjë me qëllim të realizimit të dëshirave të tyre të ulta.

Për fund, e ndiejmë për obligim të theksojmë se përkthyesi i veprave të Xhubranit nga gjuha arabe përballet me vështirësi dukshëm më të mëdha se sa gjatë përkthimit të shkrimtarëve të tjerë arabë, mbase shumicës së tyre.

Vështirësia themelore qëndron, në radhë të parë, në stilin karakteristik të Xhubranit me të cilin në botën arabe ai u veçua si një stilist i shkëlqyer.

Shprehja parabolike, përdorimi shumë i shpeshtë i figurave të vjetra semite, kujdesi për shfrytëzimin optimal të leksikut jashtëzakonisht të pasur arab, të cilin Xhubrani e njihte shkëlqyeshëm – janë vetëm disa elemente të cilat në letërsinë moderne krijuan termin “*Stili i Xhubranit*” apo “*Xhubranizmi*”.

Përkthimi i veprave me veçori të tilla në një gjuhë krejtësisht të ndryshme nga arabishtja, kërkon gjithsesi përpjekje dhe mund të madh. Besojmë se në përkthim nuk është e mundur të arrihet eleganca e formës dhe pasuria e gjuhës siç është në origjinal, mirëpo shpresojmë se kemi arritur të bartim bile një pjesë të bukurisë nga burimi i veprës.

Jahja Hondozi
Rahovec, qershor 2011

PROLOG

Kisha tetëmbëdhjetë vjet kur dashuria m'i hapi sytë me rrezet e saj magjepsëse dhe për herë të parë ma preku shpirtin me gishtërinjtë e saj të zjarhtë.

Selma Kerame ishte gruaja e parë e cila ma zgjoi shpirtin me hijeshitë e saj dhe ishte nisur para meje për në kopshtin e ndjenjave të larta, atje ku ditët kalojnë si ëndrra, kurse netët mbarojnë si dasma.

Ishte pikërisht Selma Kerame ajo e cila me bukurinë e saj më mësoi si ta adhuroj të bukurën, me ndjenjat e saj m'i tregoi sekretet e dashurisë dhe ishte ajo e cila ma këndoi në vesh vargun e parë nga poezia e jetës shpirtërore.

Cili djalosh nuk e kujton vajzën e parë e cila me butësinë e saj ia ndërroi rininë e shkujdesur përmes zhgjiëndrrës madhështore, duke e plagosur me shijen e saj dhe duke e copëtuar me ëmbëlsinë e saj.

Cili prej nesh nuk shkrihet nga malli për atë çast të çuditshëm në të cilin u zgjua befas me ç'rast vëreu se si e tërë qenia e tij u ndryshua rrënjësisht, thellësitë në të u zgjeruan e u bënë edhe më të thella dhe u mbushën me ndjenja të ëmbla, por që në vete fshehin edhe hidhësinë, të mbërthyer nga lotët, përballimi e pagjumësia.

Secili djalosh ka Selmën e tij e cila shfaqet papritur në pranverën e kthjellët të jetës së tij. Ajo i jep domethënie poetike vetmisë së tij, ia ndryshon ditët e tij të errëta me shoqërim të këndshëm, kurse netët e qeta – me melodi të lehta.

I tëri isha i humbur mes mallëngjimeve të natyrës dhe frymëzimeve nga librat dhe shpalljet e shenjta, kur e dëgjova da-

shurinë duke pëshpëritur me buzët e Selmës në veshët e shpirtit tim.

Jeta ime ishte e zbrazët, e vetmuar dhe e ftohtë që i ngjasonte qëndrimin të Ademit në parajsë deri në momentin kur e pashë Selmën, të drejtuar karshi meje si një shtyllë ndriçuese.

Meqë, Selma Kerame ishte Hava⁵ e kësaj zemre, të mbushur me sekrete e çudira. Ishte ajo e cila ia sqaroi esencën e kësaj gjithësie dhe iu shfaq si pasqyrë para këtyre fantazmave.

Hava e parë e nxori Ademin nga parajsa me dëshirën e saj dhe nënshtrimin e tij, ndërkaq Selma mua më futi në parajsën e dashurisë dhe pastërtisë me ëmbëlsinë e saj dhe gatishmërinë time.

Mirëpo, njeriut të parë nuk i ndodhi ajo që më ndodhi mua, pasi shpata e zjarhtë që e largoi atë nga parajsa ishte pikërisht shpata e cila më frikësoi me mprehtësinë e saj shndritëse dhe më largoi dhunshëm nga parajsa e dashurisë para se të arrija t'i bëj ballë dhe para se t'i shijoj frytet e së mirës dhe së keqes.

Sot, pas një varg vitesh të errëta që i zhdukën edhe vetë gjurmët e atyre ditëve, nga ajo ëndërr e mrekullueshme mua s'më mbeti gjë veçse kujtimet e dhembshme të cilat valëviten rreth kokës sime si krahët e padukshëm që më nxisin psherëtimat e dhembshme në thellësinë e gjoksit, për të cilat nga qerpikët kullojnë lotët e dëshpërimit dhe përmallimit.

Ndërkaq, Selma – Selma e bukur dhe e hijshme ishte tretur diku prapa horizontit të kaltër, ndërsa nga gjurmët e saj në këtë botë mbetën vetëm psherëtimat e dhembshme në zemrën time dhe varri i mermertë, i ngritur në hijen e drunjve të qiparisit.

Ai varr dhe kjo zemër imja janë gjithçka që mbeti për t'ia rrëfyer botës për Selma Keramen.

⁵ Femra e parë në këtë botë, bashkëshortja e Ademit a.s., njeriut të parë. (shën. i përkth.)

Megjithatë, ajo qetësi që i gropon varrezat nuk ta zbulon dot fshehtësinë të cilën Zoti e fsheh në errësirat e tabutit, e as degët që thithin lëngjet e trupit nuk i zbulojnë me fëshfërimën e tyre sekretet e varrit.

Në anën tjetër, psherëtimat dhe vuajtjet e kësaj zemre janë pikërisht ato që flasin dhe derdhen tani së bashku me pikat e ngjyrës së zezë, duke ia rrëfyer dritës figurat e asaj tragjedie të cilën e paraqesin dashuria, bukuria dhe vdekja.

O ju shokë të rinisë sime, ju që jeni shpërndarë nëpër Bejrut! Kur të kaloni pranë atij varri, afër pyllit të cedrit, hyni të heshtur në të dhe ecni ngadalë që të mos i shqetësoni me këmbët tuaja ata që pushojnë nën shtresat e tokës. Ndaluni me frikërespekt pranë varrit të Selmës dhe përshëndeteni dheun që e mbërtheu trupin e saj.

Pastaj, më kujtoni mua me psherëtimë dhe thuani qetë në vete:

“Këtu janë varrosur shpresat e atij djaloshi të cilin dallgët e jetës e dëbuan prapa deteve. Këtu janë mbuluar dëshirat e tij, janë fshehur gëzimet dhe lotët e tij dhe janë tretur buzëqeshjet e tij. Mes këtyre varreve të heshtura rritet edhe dëshpërimi i tij, së bashku me drunjtë e qiparisit dhe plepit. Përmbi këtë varr shpirti i tij i rrah krahët çdo natë, duke u shoqëruar me kujtimet, i përsërit me fantazmat e vetmisë thirrjet e pikëllimit dhe dëshpërimit, e vajton me degët e drunjve rininë e cila deri dje ishte një melodi e ëmbël në buzët e jetës, kurse sot u shndërrua në një fshehtësi të heshtur në gjirin e tokës”.

O ju shokë të rinisë, ju përbetohem me gratë të cilat i donit me zemër, që t’i vendosni kurora lulësh mbi varrin e gruas të cilën e donte zemra ime – mbase lulja që do ta vendosni mbi varrin e harruar do të bëhet si një pikë vese të cilën qerpikët e mëngjesit e derdhin në gjethet e luleve të vyshkura.

DËSHPËRIMI I HESHTUR

Ju, o njerëz, e kujtoni lulen e rinisë, i gëzoheni evokimit të gjurmëve të saj dhe pikëlloheni që ka marrë fund. Ndërsa unë, e kujtoj atë ashtu siç i kujton njeriu i liruar muret e burgut dhe barrën e prangave.

Ju i thërrisni ato vite të cilat kalojnë mes fëmijërisë dhe rinisë si një periudhë e artë e cila nuk çan kokën për hallet dhe shqetësimet e jetës, por fluturon duke valëvitur mbi fatkeqësitë e brengat, mu siç fluturon bleta mbi moçalet e pista për të mbërritur te kopshtet e lulëzuara.

Ndërkaq, unë, e kujtoj moshën e rinisë vetëm si një periudhë e dhembjeve të fshehta e të heshtura të cilat ma pushtojnë zemrën dhe shpërthenin si stuhitë në të tëra anët që rriteshin gjithnjë e më shumë.

Unë nuk e gjeja dot kuptimin e kësaj bote derisa dashuria hyri në zemrën time, m'i hapi dyert e rinisë dhe e ndriçoi çdo qoshe.

Ishte dashuria ajo e cila ma çliroi gjuhën dhe fillova të flas, m'i copëtoi qerpikët dhe nisa të qaj, ma hapi fytin dhe fillova të psherëtim e të vuaj.

Ju, o njerëz, i kujtoni fushat e kopshtet, oborret e sokakët që i vështronin lojërat tuaja dhe i dëgjonin pëshpëritjet tuaja të pastërta, ndërsa unë, gjithashtu, i kujtoj ato lugina të mrekullueshme në veri të Libanit.

Sapo i mbyll sytë para këtij oqeani, i shoh ato lugina, të mbushura me magji dhe frikërespekt, ato male që qëndrojnë lart me krenari e madhështi. Sapo i mbyll veshët nga zhurma e kësaj tollovie, dëgjoj gurgullimën e atyre përroskave dhe fëshfërimën e degëve.

Mirëpo, të gjitha këto bukuri të cilat po i përmend tani dhe për të cilat më merr malli ashtu si foshnjen për krahët e nënës, janë po ato për të cilat vuante shpirti im në errësirën e rinisë, ashtu siç vuan zogu brenda grilave të kafazit kur e vështron tu-fën e zogjve duke fluturuar lirshëm në horizontin e gjerë.

Ato bukuri ma mbushnin gjoksin me meditime të dhembshme e mendime të hidhura, duke qëndisur rreth zemrës sime një vello të dëshpërimit dhe pashpresës me gishtërinj të shtangies dhe mëdyshjes.

Saherë që shkoja në ato horizonte të hapura, kthehesha nga to i mërzhitur, duke mos ditur shkaqet e mërzhisë.

Saherë që i vështroja në mbrëmje retë, të ngjyrosura me rrezet e diellit, gjithherë ndieja një tkurrje vrasëse e cila zmadhohej gjithnjë, duke qenë se nuk e perceptoja dot domethënien e saj.

Saherë që e dëgjoja cicërimën e mëllenjës apo këngën e përroit, bëhesha i pikëlluar meqë nuk e dija burimin e pikëllimit tim.

Thonë që marrëzia është djep i përhershmerisë, ndërkaq përhershmeria – pikënisje e rehatisë.

Kjo, mbase, mund të jetë e vërtetë për ata të cilët lindin të vdekur dhe jetojnë si trupa të shuar e të ftohtë mbi sipërfaqen e tokës, mirëpo nëse marrëzia e verbër i pushton edhe ndjenjat e zgjuara, atëherë ajo mund të jetë më e thellë se humnera dhe më e hidhur se vetë vdekja.

Djaloshi sensitiv i cili ndien shumë, kurse di pak është krijesa më fatkeqe nën kupën e qiellit, meqë shpirti i tij ndodhet ndërmjet dy forcave të mëdha e të ndryshme: njëra është forca e fshehtë e cila e ngrit lart në qiej dhe ia shfaq bukuritë e qenieve prapa mjegullës së ëndrrave, ndërsa tjetra – një forcë e dukshme e cila e mbërthen për toke dhe ia mbulon zemrën me pluhur, duke e lënë të humbur e të frikësuar në një errësirë të plotë.

Dëshpërimi ka duar me prekje të mëndafshhtë dhe me dridhje të forta që i mbërthejnë zemrat dhe i shkaktojnë dhembje me vetmi, pasi, vetmia është aleat i dëshpërimit ashtu siç është njëherësh shoqërues i çdo lëvizjeje shpirtërore.

Shpirti i djaloshit, që qëndron para faktorëve të vetmisë dhe pasojave të dëshpërimit i ngjan manushaqes së bardhë që mbin nga toka, dridhet para puhisë, ia çel zemrën rrezeve të mëngjesit dhe i bashkon fletët me ardhjen e hijeve të mbrëmjes.

Nëse i riu nuk gjen argëtim i cili do t'ia kënaq mendjen dhe shoqëri me të cilën do t'i ndajë shpresat, atëherë jeta do t'i bëhet si një burg i ngushtë, ku nuk sheh gjë tjetër përpos cer-gave dhe në skajet e të cilit dëgjon vetëm zvarritjen e insekteve.

Sa i përket atij dëshpërimi që e ndieja në rininë time, ai nuk ishte rrjedhojë e nevojës sime për argëtim, meqë këtë e kisha mjaft, e as si pasojë e mungesës sime për shoqëri, pasi që shokë kisha ngado që shkoja.

Ai dëshpërim, në fakt, lindi si rrjedhojë e nevojës natyrore të shpirtit, e cila ma bëri të dashur vetminë dhe izolimin dhe mbyti në brendinë time dëshirën për t'u kënaqur dhe për të bërë jetë luksoze.

Ai dëshpërim m'i shqeu nga supet krahët e rinisë dhe më bëri, kundrejt botës, si një liqen midis maleve, i cili me qetësinë e tij pikëlluese reflekton tiparet e ngjyrat e reve dhe gjurmët e degëve, mirëpo nuk arrin të gjejë një rrugë nëpër të cilën do të kalonte në det si një përrua që këndon.

E këtillë qe jeta ime para moshës tetëmbëdhjetë vjeçare, e kjo moshë për mua, paraqet, në fakt, majën e malit duke qenë se pikërisht atëherë kam filluar ta vështroj këtë botë.

Nga ajo pozitë i kam parë rrugët e njerëzve dhe kopshetet e shpresave të tyre.

I kam parë pengesat që i vendosnin ata si dhe shpellat që i shndërronin në ligje e tradita.

Atë vit kam lindur për së dyti e njeriu i cili nuk është i ngarkuar me dëshpërim, të cilin nuk e pushton pikëllimi dhe të cilin dashuria nuk e vë në djepin e ëndrrave, e kalon jetën si një fletë e bardhë e zbrazët në librin e kozmosit.

Atë vit kam ndier se si engjëjt e qiellit më shikonin me sytë e një gruaje të bukur dhe në të njëjtën kohë i kam parë edhe djajtë e skëterrës duke rrapëllitur e ulëritur në gjoksin e një njeriu mëkatar.

Ai që nuk arrin t'i njohë engjëjt dhe djajtë përmes bukuri-ve të jetës dhe anës së saj të shëmtuar, zemra e tij mbetet larg nga njohja, kurse shpirti i tij – i zbrazët nga ndjenjat.

DORA E FATIT

Rastisa të jem në Bejrut, në pranverën e atij viti përplot me çudira. Prilli tashmë i kishte nxjerrë lulet dhe barërat që u shfaqën në kopshtet e qytetit skur të ishin sekretet të cilat toka ia kumton qiellit.

Drunjtë e bajameve dhe mollave kishin veshur petka të bardha aromatike, duke u shfaqur mes godinave si të ishin hyritë e parajsës, me rroba të mrekullueshme, e të cilat natyra ua kishte dërguar si nuse poetëve dhe atyre nga bota e imagjinatës.

Pranvera është e bukur gjithkund, mirëpo në Siri është më shumë se e bukur. Pranvera është vetë shpirti i hyjnisë së panjohur, shpirt i cili e përshkon tokën me nxitim, e kur arrin në Siri, ec ngadalë dhe shikon mbrapa, duke kuvenduar me shpirtat e mbretërve dhe profetëve të cilët jetojnë në atë hapësirë.

Së bashku me përrenjtë këndon këngë hebreje dhe himne të lavdishme të Sulejmanit, kurse me cedrat libaneze i ngjall kujtimet e famës së vjetër.

Pranvera në Bejrut është më e bukur nga të gjitha stinët e vitit, meqë atëherë lirohet nga baltinat e dimrit, e njëherësh aty ende s'ka mbërritur pluhuri i verës, kështu që midis shirave të para dhe nxehtësisë, i ngjan bukuroshes së re e cila sapo është larë në ujërat e përroit, e mandej është ulur në bregun e tij për ta tharë trupin në rrezet e diellit.

Në njërën nga ato ditë, të mbushura me frymën dehëse të prillit dhe buzëqeshjet e tij përshëndetëse, shkova për vizitë te një mik imi i cili banonte në një shtëpi, larg nga rrëmuja e qytetit.

Dhe derisa ne bisedonim, duke vizatuar me fjalët skicat e shpresave dhe dëshirave tona, në dhomë hyri një plak i fisëm që kishte gjashtëdhjetë e pesë vjet.

Rrobat e tij të thjeshta dhe shprehja serioze e fytyrës më shtynë që të ngritem në këmbë në shenjë respekti dhe para se ta përshtëndesja me dorë, miku im u afrua dhe tha:

“Ky është zotëriu Faris-efendi Kerame”.

Pastaj e shqiptoi emrin tim me fjalët lavdëruese, kurse plaku më vështroi kujdesshëm për një çast, duke prekur me majat e gishtërinjve ballin e tij të lartë, të stolisur me flokë të bardha si bora, sikur donte ta kujtonte ndonjë pamje të vjetër, të humbur që moti.

Pas pak, buzëqeshi çiltërisht e me gëzim, m'u afrua pranë dhe më tha:

“Ti je biri i mikut tim të dashur e të vjetër me të cilin kam kaluar kohën më të bukur të jetës. Gëzohem shumë që po të shoh dhe jam fort i përmalluar që me pamjen tënde po e takoj babanë tënd”.

Fjalët e tij lanë gjurmë në mua dhe ndjeva sikur diçka e padukshme, por e papërballueshme më tërheq kah ai njeri, njëjtë sikur instinkti që e tërheq zogun kah foleja e tij në prag të stuhisë.

Sapo u ulëm, plaku zuri t'na rrëfejë lidhur me miqësinë që e kishte me të atin tim, duke i kujtuar ditët e rinisë të cilat i kaloi me të.

Na fliste për vitet që kaluan, e të cilat koha i ruajti në zemrën e tij. Njerëzit e moshuar kthehen me mendime te ditët e rinisë si i huaji që përmallovhet për vendlindjen e tij.

Ata i lakmojnë me gjithë shpirt rrëfimet mbi ditët e rinisë sikurse poeti i cili lakmon ta rimojë poezinë e tij më të bukur.

Me shpirt, ata jetojnë në viset e së kaluarës së lashtë, meqë e tashmja u kalon pa i vënë re, ndërsa e ardhmja u duket sikur tanimë ka vënë mbi vete kordonet e zhdukjes dhe errësirën e varrit.

Pas një kohe që kaloi në biseda e kujtime, si hija e degëve që largohen mbi gjelbërime, Faris Kerame u ngrit për të shku-

ar. Kur iu afrova për t'u përshëndetur me të, ai ma kapi dorën time me të djathtën e tij, kurse të majtën ma vendosi mbi supë duke më thënë:

“Qe njëzet vjet s’e kam parë babanë tënd, prandaj mbes me shpresë që mungesën e tij të gjatë të ma zëvendësosh me vizita të shpeshta”.

Unë u përkula duke e falënderuar dhe njëherësh i premtova se do ta përmbush obligimin që e ka djali ndaj mikut të të atit.

Sapo doli Faris Kerame, unë e luta mikun tim që t’më tregojë diçka më tepër për të, me ç’rast ai më tha me një dozë kujdesi:

“Përveç tij, nuk njoh në Bejrut njeri tjetër të cilin pasuria e bëri të virtytshëm, e virtyti e bëri njeri të pasur. Ai është njëri nga ata njerëz të rrallë të cilët vijnë në këtë botë dhe e braktisin para se ta prekin me nënçmim shpirtin e një krijese të gjallë. Mirëpo, ata njerëz janë kryesisht fatkeq dhe u bëhen padrejtësi-
ra të shumta, pasi që nuk i njohin dredhitë me të cilat do të shpëtonin nga marifetet dhe djallëzitë e njerëzve. Faris Kerame ka një vajzë të vetme e cila jeton me të në një shtëpi të madhe në periferi të qytetit. Ajo është e virtytshme sikurse ai. Nuk ka grua më të bukur se ajo, mirëpo edhe ajo do të jetë fatkeqe, ngase pasuria e të atit qysh tani e vë në buzë të greminës së errët e të frikshme”.

Derisa miku im i shqiptonte fjalët e fundit, në fytyrë iu shfaqën shenjat e shqetësimit dhe keqardhjes, e më pas shtoi:

“Faris Kerame është një burrë që ka zemër të çiltër dhe ti-pare fisnike, mirëpo – vullnet të dobët, kështu që hipokrizia e njerëzve e udhëheq sikurse të verbërin, kurse lakmia e tyre e ndal sikurse memecin. Bija e tij i nënshtrohet plotësisht vullnetit të dobët të të atit, ndonëse shpirti i saj i madh ka fuqi e dhunti të shumta. Ja, ky është sekreti neveritës i cili fshihet në jetën e babait dhe bijës së saj. Këtë sekret e kishte kuptuar një

njeri, në personalitetin e të cilit janë gërshetuar lakmia dhe hipokrizia e fëlliqësia dhe dredhia. Ky njeri quhet Mutran. Shëmtirat e tij i mbulon përmes Ungjillit, ashtu që njerëzve u dukën si virtyte. Ai është një prijës fetar në vendin e feve dhe sekteve, ku shpirtrat dridhen nga prijësit fetarë, ndërsa trupat bien barkas para tyre, ngjashëm sikur bagëtitë kur i përkulin qafët para kasapit. Ky Mutran ka një nip tek i cili ngërthehen elementet e shthurjes dhe dredhisë sikurse akrepat dhe gjarpërinjtë – në skajet e shpellave dhe moçaleve. Nuk është larg dita kur Mutrani, në rrobat e tij solemne, do të qëndrojë afër nipit të cilin do ta vendos në anën e tij të djathtë, kurse bijën e Farisit – në të majtën, me ç’rast me dorën e tij mëkatore do ta ngrisë kurorën e martesës përmbi kokat e tyre, kur me zinxhirët priftërorë dhe të magjisë do ta lidhë trupin e pastër me kufomën erëkeqe, kur me pëllëmbën e prishur të ligjit do ta bashkojë shpirtin qiellor me qenien baltake, kur zemra e ditës do të vendoset në kraharorin e natës. Kjo është e tëra që mund të të them tani për Faris Keramen dhe bijën e tij. Mos më pyet më shumë, meqë edhe vetë përmendja e fatkeqësisë e bën atë të afërt, mu ashtu siç vdekjen e afron vetë frika nga ajo”.

Miku im e ktheu kokën duke shikuar nëpër dritare sikur në eterin delikat kërkonte fshehtësitë e fatit.

Atëherë, unë u ngrita dhe duke ia dhënë dorën për t’u përshëndetur me të, i thashë:

“Nesër do ta vizitoj Faris Keramen për ta përmbushur premtimin që ia dhashë dhe në shenjë respekti ndaj kujtimeve të cilat ia kishte lënë miqësia me të atin tim”.

Miku më vështroi shkurt, me habi dhe me shprehje të ndryshuar të fytyrës, sikur ca fjalët e mia të thjeshta nxitën tek ai një ide të re e të frikshme.

Pastaj, më shikoi në sy gjatë dhe çuditshëm – me dashuri, keqardhje dhe frikë – si një profet i cili depërton me shikim në thellësi të shpirtit, thellësi kjo e cila edhe për vetë shpirtin është e panjohur.

Më në fund, buzët iu dridhën pak, mirëpo nuk tha gjë. E la shë dhe u nisa në drejtim të derës me mendime të shpërndara.

Para se të kthehesha mbrapa, i pashë sytë e tij duke më vështruar edhe më tej me atë shikim të çuditshëm, një shikim domethënien e të cilit nuk arrita ta kuptoj derisa shpirti im u çlirova nga bota e ligjeve dhe kriterëve dhe fluturoi kah lartësitë madhështore ku zemrat kuptohen me shikime, ndërsa shpirtrat kaliten edhe më shumë përmes të kuptuarit të ndërsjellë.

PRANË DERËS SË TEMPULLIT

Pas disa ditësh, kur isha mërzhitur mjaft nga vetmia, e sytë më ishin lodhur duke i shikuar fletët e errëta të librave, u ula në karrocë dhe u nisa për ta kërkuar shtëpinë e Faris Kerames. Pas pak, arrita pranë pyllit me drunj qiparisi, atje ku bota shkon për shëtitje.

Aty, karrocieri e drejtoi kalin nga rruga kryesore dhe u nis kah bulevardi, i mbuluar me hije nga plepa të shumtë, ndërsa nga të dyja anët valëviteshin barërat dhe bimët e stolisura si dhe lulet e prillit që buzëqeshnin me buzët e kuqe si rubini, të kaltërta si smeraldi dhe të verdha si floriri.

Pas pak, karroca u ndal para një shtëpie të vetmuar, me një kopsht të gjerë, në skajet e të cilit degët përqafoheshin, kurse ajri e mbushte me aromën e luleve dhe jaseminëve.

Sapo i bëra disa hapa në atë kopsht, pranë derës së shtëpisë u shfaq Faris Kerame, i cili doli për t'më takuar, sikur zëri i karrocës në atë oazë të vetmuar i kishte lajmëruar për ardhjen time.

Duke ma uruar mirëseardhjen, më futi brenda në shtëpi përzemërsisht dhe si një prind i përmalluar më ofroi të ulem pranë tij. E filloi bisedën duke më pyetur për të kaluarën time dhe duke u interesuar njëkohësisht për synimet dhe ambiciet e mia në të ardhmen.

Unë i përgjigjesha duke i shqiptuar në formë rime ato ëndrra dhe shpresa të cilat të rinjtë, në fakt, i shqiptojnë para se valët e imagjinatës t'i hedhin në bregun e përditshmërisë, ku nuk ka gjë tjetër pos mundit dhe përpjekjes.

Rinia ka krahë me pupla nga poezia, ka nerva – të thurur nga iluzionet që i ngrisin të rinjtë përtej reve, me ç'rast shohin se si e

tërë bota është e vërsuar nga rrezet e ngjyrave të ylberit si dhe e dëgjojnë jetën duke kënduar këngë epike dhe madhështore.

Mirëpo, ato krahë poetike shumë shpejt i shqyejnë stuhitë e sprovimit, me ç'rast ata bien në botën e realitetit – kurse bota e realitetit paraqet një pasqyrë të çuditshme në të cilën njeriu e sheh veten si diçka të imtë dhe të deformuar.

Në atë moment, nga dera me perde belluzi, shfaqet një vajzë, e veshur me një rrobë mëndafshi të bardhë e të butë, e cila ecte kah unë ngadalë. U ngritëm unë dhe plaku, i cili tha:

“Kjo është bija ime, Selma”.

Dhe pasi e shqiptoi emrin tim, vazhdoi duke thënë:

“Mikun tim të vjetër të cilin koha e ka rrëmbyer nga unë, tani po ma kthen në pamjen e birit të tij, kështu që tani po e shoh pikërisht atë mikun tim, ndonëse nuk ndodhet para meje”.

Vajza u afrua pranë meje dhe më vështroi për një çast në sy, sikur donte të nxirte prej tyre të vërtetën për mua dhe të kuptonte shkakun e ardhjes sime në atë vend.

Më pas, e kapi dorën time me dorën e saj, e cila me bardhësi dhe prekje të butë ta kujtonte zambakun.

Gjatë prekjes së dorës më pushtoi një ndjenjë e çuditshme dhe e re, që i ngjante idesë poetike e cila sapo fillon të formohet në fantazinë e krijuesit.

Të gjithë u ulëm të heshtur, sikur Selma me hyrjen e saj në atë dhomë futi një frymë madhështore që ngjall heshtje dhe nemitje.

Duke ndier këtë, Selma u kthye kah unë dhe më tha duke buzëqeshur:

“Babai im shpeshherë më ka folur për babain tënd, duke m'i rrëfyer ndodhitë nga rinia e tyre. E nëse edhe babai yt t'i ka rrëfyer po ato ndodhi, atëherë ky, mbase, nuk është takimi ynë i parë”.

Plaku u gëzua me fjalët e bijës së tij, filloi t'i shkëlqejë fytyra, e më pas tha:

“Selma është mjaft e prirë në ëndërrime, prandaj edhe i duket sikur gjithçka noton në botën shpirtërore”.

Pastaj, Faris Kerame iu kthye bisedës me mua, me vëmendjen dhe butësinë kulmore – sikur zbuloi tek unë një fshehtësi magjike e cila mbi krahët e kujtimeve e kthen te ditët e kaluara pranverore.

Ai më vështronte duke i ngjallur kujtimet nga rinia e tij, ndërsa unë e vështroja atë duke ëndërruar për të ardhmen time. Ai më shikonte në atë mënyrë sikur degët e drurit të lartë që ngërthejnë në vete përvojat e të gjitha stinëve të vitit, dhe njëherësh e mbulojnë një bimë të vogël, të mbushur me energji të përgjumur dhe jetë të papjekur.

Ai ishte si një trung i ngulitur, me rrënjë të forta – një trung i cili e kishte shijuar tashmë verën dhe dimrin e jetës, kështu që tani po qëndron para stuhive të kohës, kurse unë isha një bimë e imët, e dobët dhe e brishtë, e cila ka përjetuar vetëm pranverën dhe ka filluar të lëkundet gjatë puhisë së mëngjesit.

Selma heshte, duke hedhur vështrimin herë kah unë, e herë kah i ati i saj, sikur nga njëra fytyrë lexonte kapitullin e parë nga romani i jetës, kurse nga tjetra – kapitullin e fundit.

Dita kalonte duke psherëtirë mes atyre kopshteve dhe parqeve, e dielli perëndonte duke lënë si gjurmë një puthje të verdhë mbi majat e larta të Libanit, përballë asaj shtëpie, derisa Faris Kerame edhe më tutje ma rrëfente historinë e tij e cila më mahniste, kurse unë i këndoja atij këngë të rinisë sime me çka e mallëngjeja.

Selma, ndërkaq, ishte ulur pranë dritares duke shikuar nëpër të me sy të pikëlluar dhe pa lëvizur fare.

Ajo e dëgjonte bisedën tonë dhe fare nuk fliste, sikur e dinte që bukuria flet me një gjuhë qiellore e cila ngritet përtej zërave dhe fjalëve që shqiptohen me buzët e gjuhët, një gjuhë e përhershme e cila përmban të gjitha poemat e njerëzimit, duke

i shndërruar në ndjenja të heshtura, ngjashëm sikur liqeni i qetë i cili i tubon këngët e përrenjve në thellësitë e tij, me ç'rast i shndërron në heshtje të përhershme.

Bukuria është një fshehtësi të cilën e kuptojnë shpirtrat tanë, i gëzohen asaj dhe rriten përmes ndriçimit të saj.

Në të njëjtën kohë, mendimet tona ndalen para bukurisë – të stepura, duke u përpjekur ta kufizojnë e ta jetësojnë me fjalë, por nuk arrijnë dot.

Bukuria është rrëke që rrjedh nga një burim duke u shku-mëzuar mes brigjeve të ndjenjave të atij që e vështron dhe realitetit i cili shihet.

Bukuria e vërtetë paraqet rrezet të cilat përhapen nga yl-beri i shpirtit dhe e shpërndan ndriçimin jashtë trupit, sikurse jeta që lind nga thellësia e farës, për t'u veshur më pas në lule me ngjyrë e aromë.

Ajo është mirëkuptim i plotë ndërmjet mashkullit e fem-rës, një mirëkuptim i cili realizohet në një moment dhe pikëri-sht në një moment e lind atë dëshirë, e cila lartësohet mbi të gjitha dëshirat e tjera. Kjo është ajo kthesë shpirtërore të cilën e quajmë “dashuri”.

A e kuptoi vallë shpirti im kështu shpirtin e Selmës në prag të asaj dite, dhe a thua, falë atij mirëkuptimi, e kam parë atë si grua më të bukur në botë, apo ishte ajo dehje e rinisë përmes së cilës i imagjinojmë skicat dhe figurat të cilat, në fakt, fare nuk ekzistojnë?

A thua, më kishte verbuar rinia, me ç'rast i kam përfytyruar ato rreze në sytë e Selmës, atë ëmbëlsi në buzët e saj dhe hollësi në belin e saj, apo ato rreze, ajo ëmbëlsi dhe hollësi m'i hapën sytë për t'm'i shfaqur gëzimet e dashurisë dhe pikëllimet e saj?

Nuk e kuptoj këtë, por e di se kam përjetuar një ndjenjë çfarë nuk kisha përjetuar asnjëherë më parë.

Një ndjenjë tërësisht e re ma pushtoi zemrën me një qetësi që i ngjan valëzimit të shpirtit mbi detin e hapur para fillimit të kohërave.

Ajo ndjenjë kishte lindur lumturinë dhe vuajtjen time, mu siç lindin dhe transformohen qeniet me vullnetin e atij shpirti.

Kështu kaloi ajo kohë e shkurtër në të cilën u takova me Selmën për herë të parë. Kështu deshi vullneti i qiellit i cili më çliroi papritmas nga robërimi i hutisë dhe rinisë ashtu që të ec i lirë në procesin e dashurisë.

Pasi, dashuria është liria e vetme në këtë botë, duke qenë se ajo e ngrit shpirtin në një pozitë të lartë, të cilën nuk e arrijnë dot ligjet dhe traditat e njerëzve, e as nuk e sundojnë ligjet dhe parimet e natyrës.

Kur u ngrita për të shkuar, Faris Kerame m'u afrua dhe me një zë plot sinqeritet, më tha:

“Duke qenë se tani e di rrugën te kjo shtëpi, duhet të vish me ndjenjën e sigurisë, ashtu siç shkon te shtëpia e babait tënd, dhe të më konsiderosh mua dhe Selmën si babanë dhe motrën tënde – a nuk është ashtu, Selma?”

Selma tundi kokën në shenjë miratimi, e më pas më shikoi si një jabanxhi i humbur i cili e kishte gjetur një mik të njohur.

Ato fjalë që m'i tha Faris Kerame paraqisnin melodinë e parë e cila më solli pranë vajzës së tij, para fronit të dashurisë.

Ishte kjo hyrje në poemën qiellore e cila përfundoi me pikëllim dhe vajtim – një forcë e cila i nxiti shpirtrat tanë, me ç'rast u afruan kah drita dhe zjarri. Ajo ishte kupa nga e cila pimë nektarin dhe pelinin.

Derisa po dilja, plaku më përcillte deri tek fundi i kopshtit, ku u përshëndeta me ta, sa kohë që zemra më rrihte ashtu siç dridhen buzët e të eturit kur e prekin majën e gotës.

PISHTARI I BARDHË

Prilli po ikte ngadalë, derisa unë e vizitoja herë pas here shtëpinë e Faris Kerames dhe takohesha me Selmën.

Ulesha përballë saj në atë kopsht, duke e vështruar bukurinë e saj. Isha i mahnitur me talentin e saj dhe e dëgjoja qetësinë e pikëllimit të saj, duke ndier praninë e duarve të fshehta që më tërhiqnin kah ajo.

Secila vizitë ma zbulonte një domethënie të re të hijeshisë së Selmës dhe një fshehtësi të thellë të shpirtit të saj, sa që për sytë e mi ajo u bë një libër, rreshtat e të cilit i lexoj dhe e këndoj poemën e tij duke mos mundur të arrij deri në fund.

Gruaja, së cilës Perëndia ia dhuroi shpirtin e bukur krahas trupit të bukur, paraqet një realitet të dukshëm, por misterioz të cilin e kuptojmë me dashuri dhe e prekim me ndershmëri. E nëse përpiqemi ta përshkruajmë me fjalë, do të fshihet nga ne prapa perdes së hutisë dhe paqartësisë.

Selma Kerame kishte shpirt dhe trup të bukur, e si mund t'ia përshkruaj, vallë, atij që nuk e njeh?

A mundet dikush që rrin ulur nën hijen e krahëve të vdekjes, të sjellë cicërimën e bilbilit, pëshpëritjen e lules dhe gurgulimën e përroit?

A mundet një rob i lidhur në pranga t'i ndjek puhitë e mëngjesit?

Megjithatë, a nuk është heshtja më e rëndë se fjala? A mund t'më pengojë frikërespekti që ta shpërfaq një paraqitje përfytyruese për Selmën me fjalë të zbehta, nëse nuk arrij dot ta pikturoj pamjen e saj reale me vija të arta?

Udhëtari i uritur në shkretëtirë nuk refuzon të hajë bukën e thatë nëse qielli nuk i zbret mjalt e thëllëzë.

Selma ishte një vajzë truphollë, e cila me rrobat e saj të bardha të mëndafshhta dukej sikur rrezet e hënës kur hynin nëpër dritare.

Lëvizjet e saj ishin të ngadalta e të harmonishme që u ngjnin pjesëve të melodive isfahanase. Kishte një zë të qetë dhe të këndshëm, të ndërprerë me psherëtima. Një zë që ridhte nga buzët e saj të purpurta sikur pikët e vesës në kurorën e luleve mbi flladin e erës.

E fytyra e saj! Ah, kush ka mundësi, vallë, ta përshkruajë fytyrën e Selma Kerames? A thua, me çfarë fjalë mund ta përshkruajmë atë fytyrë pikëlluese dhe të qetë, fytyrë e cila njëkohësisht është dhe nuk është e mbuluar me verdhësi të tejdukshme?

Me çfarë gjuhe mund të flasim për vijat e fytyrës të cilat në çdo çast shfaqin ndonjë fshehtësi të madhe të shpirtit që shkakton dhembje brenda trupit, duke ua kujtuar faktin atyre që e shikojnë se si bota shpirtërore është larg nga kjo materialja?

Bukuria e fytyrës së Selmës nuk ishte në proporcion me kriteret që i vendosën njerëzit për bukurinë.

Ajo ishte e çuditshme sikur ëndrra, sikur vizioni, apo sikur një ide e lartë e cila nuk krahasohet e as kufizohet dot. Nuk mund të pikturohet me penelin e piktorit e as të formësohet me mermer.

Bukuria e Selmës nuk ishte në flokët e saj të arta, por në aureolën e pastër që i rrethonte. Bukuria e saj nuk ishte në sytë e saj të mëdhenj, por në ndriçimin që shpërhapej prej tyre. Nuk ishte në buzët e saj të trëndafilta, por në ëmbëlsinë që ridhte nga to. Nuk ishte në qafën e saj të fildishtë, por në mënyrën se si ishte e përkulur pak përpara.

Bukuria e Selmës nuk ishte në përsosurinë e trupit të saj, por në veçantinë e shpirtit të saj, si një pishtar i bardhë shndritës i cili noton mes tokës dhe pafundësisë.

Bukuria e Selmës ishte një lloj i gjenialitetit poetik, reflektimet e të cilit i vërejmë në poezitë madhështore, në piktura

dhe në himne të përhershme, ndonëse njerëzit gjenialë janë të pafat, pasi, sado që shpirtrat e tyre të jenë madhështorë, prapëseprapë mbesin të mbuluar me lot.

Selma mendonte shumë, kurse fliste pak, mirëpo heshtja e saj ishte muzikore, një heshtje e cila e bartte bashkëbiseduesin te hapësirat e largëta të ëndrrave, e nxiste atë t'ua vë veshin rrahjeve të zemrës së tij, t'i vështrojë imagjinatat e ideve të tij dhe ndjenjat personale, të drejtuara para syve të tij.

Kurse veçoria e cila i theksonte virtytet e Selmës dhe e pasqyronte natyrën e saj ishte melankolia e thellë që e lëndonte.

Ajo melankoli ishte si një kordon abstrakt të cilin e vishte, gjë që ia shtonte bukurisë së trupit të saj dalldinë dhe habinë.

Rrezet e shpirtit të saj shfaqeshin përmes vijave si ato të pemës së lulëzuar prapa mjegullës së mëngjesit.

Kjo melankoli krijoi një afërsi mes shpirtit tim dhe atij të Selmës, me ç'rast secili nga ne shihte në fytyrën e tjetrit atë që ndiente zemra e tij dhe në zërin e tij dëgjonte jehonën e ndjenjave të tundura në gjoks.

Dukej sikur Perëndia e bëri secilin nga ne gjysmën e atij tjetrit me të cilin lidhet me ndershmëri dhe kështu bëhet qenie e plotë, e kur ndahet prej tij, ndien mangësi të dhembshme në shpirt.

Shpirti i pikëlluar dhe i vuajtur gjen rehati gjatë bashkimit me një shpirt tjetër i cili i përngjan me ndjenja dhe i ndan ato me të, siç kuvendon i huaji me të huajin në një vend, larg nga vendlindja e tyre.

Zemrat të cilat i afrojnë dhembjet e melankolisë, nuk mund t'i ndajë shkëlqimi i gëzimit, meqë lidhja e pikëllimit është më e fortë në shpirtra se sa lidhjet e kënaqësisë dhe gëzimit.

Dashuria e cila lahet me lot, mbetet e pastër, e bukur dhe e përhershme.

STUHIA

Pas disa ditësh, Faris Kerame më ftoi për darkë në shtëpinë e tij. U nisa, e shpirti im ishte i uritur për atë bukë të lartësuar të cilën qielli ia dhuroi Selmës, atë bukë shpirtërore të cilën e kapërdijmë me gojët e zemrave tona, me ç'rast na shtohet uria edhe më tepër. Atë bukë magjepsëse të cilën e shijoi Kajsi arab, Danteja italian dhe Safo greke, me ç'rast shpirtrat iu flakëruan e zemrat iu shkri-në. Atë bukë të cilën Perëndia e përgatiti me ëmbëlsinë e zemrës dhe hidhësinë e lotëve dhe e bëri ushqim për shpirtrat e ndieshëm vigjilentë për t'i gëzuar me shijen e tij, po edhe për t'i dënuar me të.

Kur arrita pranë shtëpisë, e gjeta Selmën të ulur në një karrige të drunjtë, në një skaj të kopshtit, ndërsa kokën e kishte mbështetur për një trung.

Me fustanin e saj të bardhë, ajo dukej si një zanë imagjinare që e ruante atë vend.

Iu afrova i heshtur dhe u ula pranë saj si një adhurues zjarri, i përlulur para zjarrit të shenjtë.

U përpoqa të flas, mirëpo gjuhën e kisha të lidhur, e buzët – të palëvizshme. Prandaj, iu bashkova me heshtje, pasi, ndjenja e thellë dhe e pafund e humb një pjesë të domethënies së saj reale kur formësohet me fjalët e kufizuara.

E ndieja se si Selma e dëgjonte në qetësi përgjërimin e vazhdueshëm të zemrës sime dhe i shikonte në sytë e mi reflektimet e dridhura të shpirtit tim.

Pas pak, në kopsht u shfaq Faris Kerame i cili afrohej drejt nesh, dhe si zakonisht ma uroi mirëseardhjen duke ma zgjatur dorën, sikur dëshironte ta bekojë me këtë atë fshehtësi të thellë e cila e lidh shpirtin tim me shpirtin e bijës së tij.

Pastaj tha duke buzëqeshur:

“Ejani bijtë e mi të hymë brenda. Darka është gati”.

U ngritëm dhe shkuaam pas tij, derisa Selma, nën qerpikë të lyer, më vështronte me butësi dhe dhembshuri, sikur fraza e të atit “bijtë e mi” kishte ngjallur brenda saj një ndjenjë të re dhe të ëmbël, e cila ngërthen dashurinë e saj ndaj meje, sikur e ëma kur e përqafoi të birin.

U ulëm në tryezë duke ngrënë, pirë e duke biseduar. U ulëm në atë dhomë duke u kënaqur me llojloj ushqimesh të shijshme dhe me llojet e ndryshme verërash të kuqe, derisa shpirtat tanë notonin, pa dijen tonë, në një botë, të largët nga kjo e jona, duke ëndërruar për të ardhmen, të gatshëm që të përballen me tmerret dhe lemeritë e saj.

Ishin ata tre persona që janë zhytur në mendime të ndryshme për synimet e ndryshme në jetë, mirëpo zemrat e të gjithëve ishin të përfshira njësoj me dashuri dhe butësi.

Tri qenie të dobëta dhe të çiltërta të cilat ndiejnë fort, kurse dinjë pak, e kjo është pikërisht tragjedia që e godet shpirtin.

Personi i parë ishte një plak i mrekullueshëm dhe fisnik, i cili e donte bijën e tij dhe kujdesej vetëm për lumturinë e saj. Pastaj, një vajzë në vitet e njëzeta të jetës, e cila e shihte ardhmërinë, të afërt e të largët, dhe ia ngulte sytë për të parë se çfarë gëzimesh dhe vuajtjesh ia fsheh ajo. Dhe në fund, një djalosh i cili ëndërronte shumë, derisa ende nuk e kishte shijuar verën e jetës e as hidhësinë e saj. I lëvizte krahët për të notuar në hapësirën e dashurisë dhe njohjes, mirëpo nuk qe në gjendje të zbrësë, duke qenë se ishte i dobët.

Tre persona ishin të ulur në një tryezë elegante, në një shtëpi, larg nga qyteti të cilin e rrethonte qetësia e muzgut dhe të cilin e vështronin sytë e qiellit.

Ishin ata tre persona që hanin e pinin, derisa thellë në pjatat dhe gotat e tyre, fati e kishte fshehur hidhësinë dhe fatkeqësinë.

Ende pa e përfunduar darkën, në dhomë hyri një shërbëtore e cila iu drejtua Farisit duke i thënë:

“Zotëri, para derës është një njeri i cili dëshiron të takohet me ju”.

“Kush është ky njeri?” – e pyeti ai shpejt, kurse ajo iu përgjigj:

“Mendoj se është shërbëtori i Mutranit, zotëri”.

Ai heshti për një çast duke hedhur shikimin tek sytë e së bijës, siç shikon profeti në fytyrën e qiellit për të parë se çfarë sekretesh fsheh. Më pas, u kthye kah shërbëtorja dhe i tha:

“Lëre të hyjë!”

Shërbëtorja iku, e pas pak u shfaq një njeri me rroba të praruara dhe me mustaqe të përveshura.

Na përshëndeti me përkulje, e mandej iu drejtua Farisit:

“Shkelqësia e tij, Mutrani, më dërgoi me karrocën e tij të veçantë që t’ju lus të pranoni të vini tek ai, pasi që dëshiron të bisedojë me ju për disa çështje të rëndësishme”.

Plaku u ngrit në këmbë duke e ndryshuar formën e fytyrës, kurse buzëqeshja iu tret prapa perdes së vrojtimit dhe meditimit. Më pas, u afrua kah unë dhe më tha me një zë të butë e të ëmbël:

“Shpresoj se do të të gjej këtu kur të kthehem. Selmës do t’i bësh shoqëri dhe me bisedë do t’ia largosh vetminë e natës, e do t’ia zhdukësh ndjenjën e vetmisë me këngët e shpirtit tënd”.

Pastaj, iu kthye së bijës dhe shtoi duke buzëqeshur:

“A nuk është ashtu, Selma?”

Ajo e tundi kokën duke u skuqur pak dhe me një zë, butësisht e të cilit ta kujtonte melodinë e flautës, tha:

“Do të përpiqem, baba, që mysafiri ynë të jetë i lumtur”.

Plaku doli në shoqërimin e shërbëtorit të Mutranit, kurse Selma qëndronte në këmbë duke shikuar kah rruga nëpër dri-

tare derisa karroca iu largua nga sytë, prapa perdeve të errësirës, derisa u tret në distancë jehona e rrotave dhe heshtën trokëllimat e hapave të kuajve.

Më pas, u ul përballë meje, në një karrigë, të qepur me një stof të gjelbër mëndafshi, ashtu që në fustanin e saj shkëlqyes dukej sikur një manushaqe shtatin e së cilës puhitë e mëngjesit e mbështillnin në një qilim ngjyrë bari.

Kështu fati deshti që të mbetem vetë me Selmën, natën, në një shtëpi të vetmuar, të rrethuar me drunj dhe të zhytur në qetësi, në një shtëpi rreth së cilës kalojnë iluzionet e dashurisë, çiltërisë dhe bukurisë.

Për disa minuta ishim të heshtur, të shtangur dhe të zhytur në mendime, duke pritur tjetrin që t'ia fillojë bisedës.

Mirëpo, a thua, ekzistojnë fjalët të cilat mund të shprehin mirëkuptim derisa një gjë e tillë ndodh mes shpirtrave të dashuruar? A ekzistojnë, vallë, tingujt dhe fjalët të cilat përmes buzëve dhe gjuhëve mund t'i afrojnë zemrat dhe mendjet?

A ka diçka më të lartë se ajo që shqiptojnë gojët dhe më e pastër se ajo që me dridhje shprehin kordat e zërit?

A nuk është ajo qetësia në të cilën rrezet e një shpirti e shndrrisin tjetrin dhe e cila pëshpëritjet e zemrës ia bart zemrës tjetër?

A nuk është ajo qetësia e cila na ndan nga qeniet tona, me ç'rast notojmë në hapësirën e pakufishme të shpirtit duke iu afruar engjëjve e duke ndier se si trupat tanë nuk mund t'i lënë burgjet e ngushta dhe se kjo botë nuk paraqet asgjë më tepër pos internimit të largët?

Selma më vështroi në atë mënyrë që sytë e saj i zbulonin fshehtësitë e shpirtit, mandej tha me një qetësi magjike:

"Eja të dalim në kopsht, të ulemi mes drunjve e ta vështrojmë hënën se si del prapa malit".

U ngrita i bindur dhe thashë duke kundërshtuar:

“A nuk është më mirë të qëndrojmë këtu, Selma, derisa të dalë hëna e të shndrrisë kopshti? Tani, errësira po i mbulon drunjtë dhe lulet, prandaj nuk mund të shohim asgjë”.

Ajo ma ktheu:

“Nëse errësira i mbulon drunjtë dhe lulet nga shikimi, ajo, megjithatë, nuk e mbulon dot dashurinë nga shpirti”.

I shqiptoi ato fjalë disi çuditshëm, e më pas e drejtoi shikimin kah dritarja, ndërsa unë mbeta i heshtur, duke menduar rreth fjalëve të saj, duke ia dhënë kuptimin secilës fjali dhe duke ua caktuar atyre domethënien e vërtetë.

Pas pak, ajo më vështroi sërish, sikur ishte penduar për atë që kishte thënë dhe sikur përpiquej që me sytë e saj magjike t'i kthejë fjalët të cilat tashmë kishin mbërritur te veshët e mi.

Megjithatë, magjia e atyre syve nuk i ktheu ato fjalë. Përkundrazi, i vulosi ato edhe më thellë në gjoksin tim, i bëri më të qarta dhe më ndikuese, ashtu që të mbesin atje, të ngjitura për zemrën time, duke vezulluar me ndjenjat e mia deri në fund të jetës.

Çdo gjë madhështore dhe e bukur në këtë botë lind nga një ide apo nga një ndjenjë në brendësi të njeriut.

Të gjitha veprat e gjeneratave të kaluara që i shohim sot, para se të realizoheshin, ishin një ide e fshehtë në mendjen e një njeriu apo një ndjenjë suptile në gjoksin e një gruaje.

Revolucionet kolosale të cilët derdhën gjak si rrëke dhe bënë që liria të adhurohet si hyjni paraqitnin një ide përfytyruese që dridhej në gjarpërimet e trurit të një njeriu i cili jetonte mes mijëra njerëzve të tjerë.

Të gjitha luftërat e dhembshme të cilat i rrënonin fronet dhe i shkatërronin mbretëritë ishin fillimisht një ide e cila vërtitej në kokën e një njeriu.

Doktrinat e larta të cilat e ndryshuan rrjedhën e jetës njerëzore ishin një prirje frymëzuese në shpirtin e një njeriu të cilin talenti i tij e ndau nga mesi që e rrethonte.

Një ide i ngriti piramidat, një ndjenjë e rrënoi Trojën, një koncept hartoi madhështinë e Islamit dhe një fjalë e dogji bibliotekën e Aleksandrisë.

Një ide të çon në qetësinë e natës dhe të dërgon tek fama apo çmenduria. Një shikim i vetëm nga sytë e një gruaje të bën njeriun më të lumtur apo më fatkeq.

Një fjalë që del nga goja e një njeriu të bën të pasur pas varfërisë, apo të varfër pas pasurisë.

Një fjalë që e shqiptoi Selma atë natë të qetë më bëri të ndalem mes së kaluarës dhe së ardhmes sime, siç ndalet anija ndërmjet detit të hapur dhe hapësirës së pafund.

Një fjalë e vërtetë më kishte zgjuar nga gjumi i rinisë dhe më kishte shpënë në një rrugë të re, në hapësirat e dashurisë ku ndodhen jeta dhe vdekja.

Dolëm në kopsht dhe ecëm mes drunjve duke ndier se si gishtërinjtë e fshehtë të puhisë na i prekin fytyrat, se si shtati i luleve dhe barishtet e ulta lëkundeshin mes këmbëve tona.

E kur arritëm te druri i jaseminit, u ulëm të heshtur në atë karrigë të drunjve duke dëgjuar frymëmarrjen e natyrës së fjetur dhe duke i zbuluar me psherëtimat e ëmbla sekretet e zemrave tona para syve të qiellit që na shikonin nëpër kaltërsinë qiellore.

Në atë çast, prapa malit u shfaq hëna e cila me dritën e saj i mbuloi ato kodrina e brigje, me ç'rast fshatrat u shfaqën në skajet e luginave, sikur ishin mbirë nga asgjëja.

Dhe nën ato rreze të argjendta, i tërë Libani dukej si një djalosh, i mbështetur në krahun e tij nën një mbulesë delikate e cila ia fsheh dhe s'ia fsheh pjesët e tij të trupit.

Për poetët e perëndimit, Libani paraqet një vend të imagjinatës, një vend, realiteti i të cilit është shuar me zhdukjen e Davudit dhe Sulejmanit si dhe profetëve të tjerë, siç është fshehur parajsa me dëbimin e Ademit dhe Havasë.

Për ta, kjo paraqet një fjalë poetike, e jo thjesht një emër mali – një fjalë e cila simbolizon ndjenja të shpirtit dhe i kthen në kujtesë gjurmët e pyjeve me drunj qiparisi nga të cilët përhapen aromat e këndshme.

Ato janë kullat e bakrit dhe të mermerit që ngriten me famë dhe madhështi. Janë tufa gazelash që lëvizin mes rrafshinave dhe luginave.

Atë natë e kam parë Libanin si një ide poetike imagjorative e cila ngritet si ëndrra mes dy zhgëndrrave.

Kështu, gjërat para nesh ndryshojnë në përputhje me ndryshimin e ndjenjave tona. Në imagjinatë i shohim gjërat të zbkuruara me magji e bukuri, ndonëse magjia dhe bukuria janë vetëm në shpirtrat tanë.

Selma u kthye kah unë, derisa drita e hënës ia kishte mbuluar fytyrën, qafën dhe duart, kështu që dukej si një përmen-dore nga fildishi të cilën e gdhendën duart që e adhurojnë As-tartën, perëndeshën e bukurisë dhe dashurisë:

“Përse nuk flet? Përse nuk më rrëfen për të kaluarën tënde?”

I vështrova sytë e saj të shndërritshme dhe porsi një memec të cilin e befasuan fjalët nga goja, iu përgjigja:

“A nuk po dëgjon se si po flas që kur erdha në këtë vend? A nuk dëgjove gjithë ç’kam thënë që kur dolëm në kopsht? Shpirti yt i cili dëgjon pëshpëritjen e luleve dhe këngët e qetësi-së, mund ta dëgjojë vajtimin e shpirtit tim dhe shqetësimin e zemrës sime”.

Ajo e mbuloi fytyrën me duart e saj, e më pas me një zë të ndërprerë, tha:

“Të dëgjova ... po, të dëgjova. E dëgjova një zë vajtues që dilte nga thellësia e natës dhe një shqetësim të madh që shpërthente nga zemra e ditës”.

I thashë me nxitim, ndërsa e harrova të kaluarën dhe qenien time, i harrova të gjitha dhe nuk dija gjë tjetër pos Selmës, e as që ndieja se ekziston diç tjetër pos saj:

“Edhe unë të dëgjova ty, Selma. E dëgjova një poemë të madhe përshëndetëse e plagosëse me të cilën e tërë gjithësia noton dhe me të cilën dridhen edhe themelet e tokës”.

Selma i mbylli sytë, kurse në buzët e saj të purpurta u shfaq një buzëqeshje pikëlluese, e mandej pëshpëriti:

“Tani kam kuptuar se ekziston diçka më e lartë se qielli, më e thellë se deti, më e fortë se jeta, vdekja dhe koha. Sapo kuptova diçka që dje nuk e dija e as që për të fare ëndërroja”.

Nga ai çast, Selma Kerame m’u bë më e çmuar se miku, më e afërt se motra dhe më e dashur se e dashura. U bë një ide sublime që e ndiqte gjithnjë mendjen time, një ndjenjë subtile që ma push-tonte zemrën dhe një ëndërr e bukur që ma shoqëronte shpirtin.

Sa injorantë janë ata njerëz të cilët kujtojnë se dashuria lind nga bashkëjetesa e gjatë dhe shoqërimi i vazhdueshëm.

Dashuria e vërtetë është bija e mirëkuptimit shpirtëror dhe nëse ky mirëkuptim nuk arrihet në një çast, nuk do të arrihet për një vit, e as për një gjeneratë të tërë.

Selma e ngriti kokën dhe hodhi vështrim kah horizonti i gjatë, atje ku vijat e malit puqen me skajet e kozmosit, e më pas tha:

“Dje ishe për mua si një vëlla tek i cili afrohem e qetë dhe ulem pranë tij nën hijen e të atit. Ndërsa tani, sapo ndjeva se ekziston diç më e fortë dhe më e ëmbël se lidhja vëllazërore. Përjetova një ndjenjë të çuditshme, të zhveshur nga çdo lidhje. Një ndjenjë të fortë, të thellë, të frikshme e dehëse, e cila ma mbush zemrën me pikëllim dhe gëzim”.

Unë ia ktheva:

“A nuk është kjo ndjenjë, nga e cila frikësohemi dhe dridhemi nga përshkimi i saj në gjoksat tona, një pjesë e Ligjit unive-rsal i cili hënën e drejton rreth tokës, tokën rreth diellit, kurse diellin dhe çdo gjë që e rrethon – rreth Zotit?”

Selma vendosi dorën mbi kokën time dhe i zhyti gishtërin-jtë në flokët e mia. Fytyra i shndrriste e sytë iu mbushën me lotë, sikur pikët e vesës që shkëlqejnë në skajet e gjethëve të na-rcisit. Pastaj, tha:

“Cili njeri mund t’i besojë rrëfimit tonë? Kush mund të be-sojë se në një periudhë të shkurtër kohore nga perëndimi i diel-lit deri tek dalja e hënës, i kaluam të gjitha pengesat dhe i kapë-rcyem të gjitha portat që ekzistojnë mes dyshimit dhe bindjes? Kush do të besojë se prilli i cili na bashkoi për herë të parë, është, në fakt muaji i cili na dërgoi në vetë shenjtërinë e jetës?”

I tha këto fjalë duke e mbajtur ende dorën e saj mbi kokën time të përkulur, dhe sikur të mund të zgjidhja në atë moment, nuk do t’ia kisha dhënë përparësi kurorave të mbretërve e as kurorave dafinash ndaj asaj dore të mëndafshtë e cila m’i shpri-shte flokët.

Pastaj, i thashë:

“Njerëzit nuk do t’i besojnë rrëfimit tonë, meqë nuk dijnë se dashuria është lule e vetme e cila mbin dhe rritet pavarësisht nga stinët e vitit. Megjithatë, a është pikërisht prilli i cili na ba-shkoi për herë të parë? A është pikërisht ky moment i cili na solli në vetë shenjtërinë e jetës? Apo ndoshta, dora e Zotit na i ka bashkuar shpirtrat para se lidhja t’na bënte robër të kohës? Selma, jeta e njeriut nuk fillon në mitër, ashtu siç nuk mbaron tek varri, pasi, kjo gjithësi e gjerë, e mbushur me rrezet e hënës dhe të yjeve, nuk është pa shpirtra, të përqafuar në dashuri, shpirtra – të bashkuar në mirëkuptim”.

Selma e ngriti ngadalë dorën e saj nga koka ime, duke lënë në rrënjë të flokëve ngarkesa elektrike të cilat i guduliste puhia e natës, me ç'rast bëheshin më të forta e më të shpejta. Atëherë, e kapa atë dorë, qetë, si një i devotshëm që kërkon bekim për-mes vellos së flijuesit. Pastaj, e vura mbi buzët e mia të zjarrra dhe ia dhashë një puthje të gjatë, të thellë dhe të heshtur, një puthje e cila me ngrohtësinë e saj i shkrin të gjitha ndjenjat në zemrën e njeriut dhe me ëmbëlsinë e saj thekson në shpirtin hyjnor çdo gjë që është e pastër dhe e çiltër.

Kështu kaloi një orë, çdo minutë e së cilës ishte e mbushur me pasion dhe dashuri. Ishim pushtuar nga qetësia e natës dhe të mbuluar me rrezet e hënës, derisa gjithandej na rrethonin drunj të dhe lulet aromatike.

Kur arritëm në atë gjendje në të cilën njeriu harron çdo gjë përveç dashurisë së vërtetë, dëgjuam trokëllimën e kuajve dhe zërin e karrocës e cila po na afrohej me shpejtësi.

U zgjuam nga ajo dremitje e ëmbël dhe zhgjiëndrra na dërgoi nga bota e ëndrrave tek kjo botë e pasigurisë dhe mjerimit.

E kuptuam se Farisi ishte kthyer nga shtëpia e Mutranit, kështu që u ngritëm dhe u nisëm nëpër drunj të për ta pritur.

Karroca arriti pranë hyrjes së kopshtit dhe Faris Kerame zbriti e filloi të ecte kah ne, kokëulur dhe ngadalë.

Si një njeri i lodhur, i këputur nga barra e rëndë, iu afrua Selmës, i vuri të dy duart mbi supet e saj dhe e vështroi gjatë në fytyrë, sikur frikësohej mos po i tretet pamja e saj nga shikimi i tij i dobët.

Sakaq, i rodhën lotët nëpër faqet e tij të tharë, buzët iu dri-dhën me një buzëqeshje të pikëlluar dhe me një zë të thyer, tha:

“Së shpejti Selma ... së shpejti do të ikësh nga prehëri i ba-bait tënd tek prehëri i një tjetër njeriu. Së shpejti vullneti i Zotit do të të dërgojë nga kjo shtëpi e vetmuar në një botë të gjerë,

ndërsa ky kopsht do të përmallohet për trokëllimën e këmbëve tua, e babai yt do të mbesë larg teje.

Fati, tashmë, e ka thënë fjalën e tij, Selma. Le të të bekojë qielli dhe të të mbrojë ai!”

Sapo i dëgjoi Selma këto fjalë, fytyra iu ndryshua e sytë iu shtangën, sikur kishte parë hijen e vdekjes, të drejtuar para saj.

Pas pak, filloi të rënkojë dhe të belbëzojë dhembshëm, si një zog të cilin gjuetari sapo e qëllloi, me ç’rast bie në greminë duke u dridhur i tëri nga dhembjet.

Më në fund, me një zë, të ndërprerë nga rënkimet e thella, bërtiti duke thënë:

“Çfarë po thua? Çka domethënë kjo? Ku dëshiron t’më dërgosh?”

Pastaj, e vështroi atë, sikur me shikimet e saj donte ta hiqte veillon nga sekretet e gjoksit të tij. Pas një momenti, të rënduar me heshtje që i ngjante bërtimës së varreve, Selma, duke psherëtirë, tha:

“Tani kam kuptuar ... Çdo gjë kam kuptuar ... Nga dashuria jote Mutrani paska bërë grila kafazi të cilin e ka përgatitur për këtë zog me krahë të thyer. A është ky vullneti yt, baba?”

Ai u përgjigj vetëm me psherëtimat e thella, e më pas e futi në shtëpi, derisa rrezet e butësisë shndërrisnin nga fytyra e tij e mallëngjyer.

Unë mbeta në këmbë mes drunjve, derisa habia luante me ndjenjat e mia, siç luan stuhia me gjethet e vjeshtës.

Pastaj, shkova pas tyre në dhomë, dhe për të mos dukur si një mysafir i padëshiruar, i cili do të donte t’i hulumtonte intimitetet e tyre, ia zgjata dorën plakut për t’u përshëndetur dhe e vështrova Selmën si një i mbytur në ujë që e vështroi yllin shkëlqyes në kupën e qiellit.

Pastaj, dola qetë, ashtu që nuk ndien fare se kisha dalë. Mirëpo, sapo arrita në fund të kopshtit, e dëgjova zërin e plakut i cili më thërriste.

E ktheva kokën dhe pashë se po afrohet kah unë, prandaj u nisa ta takoj. Sapo u afrova tek ai, ma kapi dorën dhe me një zë të dridhur, më tha:

“Më fal bir që i kam dhënë fund natës tënde me lot, mirëpo ti do të vish tek unë gjithnjë, apo jo? A nuk do të më vizitosh as atëherë kur në këtë vend të mos mbesë gjë tjetër pos pleqërisë së pikëlluar? Rinia e këndshme nuk shoqërohet me pleqërinë e vyshkur ashtu siç mëngjesi nuk takohet me mbrëmjen. Megjithatë, ti do të vish tek unë për t’m’i përkujtuar ditët e rinisë të cilat i kam kaluar me babain tënd dhe do t’më flasësh për ndodhitë e jetës e cila nuk më konsideron se i takoj tashmë ... a nuk është ashtu? A nuk do t’më vizitosh kur të shkojë Selma, e unë do të mbetem tërësisht i vetmuar në këtë shtëpi, larg nga shtëpitë e tjera?”

Fjalët e fundit i shqiptoi me një zë të ulët e të ndërprerë, e kur ia kapa dorën dhe ia tunda i heshtur, i ndjeva lotët e tij të nxehta që kishin rënë në dorën time.

Shpirti m’u dridh nga brenda dhe ndjeva ndaj tij njëfarë ndjenje të ëmbël dhe pikëlluese e cila më formësohej në gjoks dhe ngritej deri në buzët e mia si frymëmarrja e rëndë, për t’u kthyer më pas thellë në zemër sikur rënkimet.

Kur e ngrita kokën dhe ai e pa se lotët e tij kishin bërë që edhe unë të derdh lot, u përkul pak dhe me buzë të dridhura e preku pjesën e sipërme të ballit tim, pastaj tha duke e kthyer fytyrën kah dera e shtëpisë:

“Natën e mirë ... natën e mirë, bir”.

Një lot i vetëm që shndrit në faqen e vyshkur të një plaku ka ndikim më të madh në shpirt se të gjithë lotët që i derdhin djelmoshat.

Lotët e shumta të rinisë derdhen me bollëk nga zemra e stërm bushur, ndërsa lotët e të moshuarve paraqesin përpëlitjet e fundit të jetës që derdhen nga sytë. Ato janë mbeturinat e jetës në trupin e dërrmuar.

Lotët në sytë e rinisë u ngjajnë pikave të vesës mbi fletët e luleve, kurse ato në faqet e pleqërisë u ngjajnë më tepër gjetheve të verdha të vjeshtës të cilat i shpërndajnë erërat kur afrohet dimri i jetës.

Faris Kerame humbi prapa dyerve. Unë dola nga kopshti, derisa zëri i Selmës ushtonte në veshët e mi, bukuria e saj ecte si imagjinatë para syve të mi, ndërkaq lotët e babait të saj thaheshin ngadalë në dorën time.

Dola nga ai vend siç pati dalë Ademi nga parajsja, mirëpo Hava e zemrës sime nuk ishte pranë meje që t'ma bënte tërë botën parajsë.

Dola duke ndier se ajo natë në të cilën u linda për herë të dytë, është në fakt nata në të cilën për herë të parë e kam prekur fytyrën e vdekjes.

LIQENI I ZJARRTË

Çdo gjë që bën njeriu fshehtas në errësirën e natës, ai edhe e shfaq haptas në dritën e ditës.

Fjalët të cilat i pëshpërisin buzët tona në qetësi, shndërrohen në bisedë të hapur edhe pa dijeninë tonë.

Punët të cilat sot përpiqemi t'i fshehim në qoshet e shtëpive tona, nesër dalin në shesh dhe shfaqen haptas në skajet e rrugëve.

Kështu, errësira e natës i shpalosi qëllimet e Mutran Galibit nga takimi i tij me Faris Keramen dhe kësajsoj eteri delikat i përçoi fjalët dhe llafet e tij nëpër tërë qytetin, derisa më në fund mbërritën edhe në veshët e mi.

Atë natë të ndritshme, Mutran Galibi nuk kërkoi të takohet me Faris Keramen që të bisedojë me të për vuajtjet e të varfërve dhe të pikëlluarve, apo të diskutojë me të për dhembjet e vejushave dhe bonjakëve, por e solli me karrocën e tij të shtrenjtë speciale për t'ia kërkuar dorën e së bijës, Selmës, për nipin e tij, Mensur-bej Galibin.

Faris Kerame ishte një njeri i pasur dhe nuk kishte trashëgimtar tjetër pos së bijës, Selmës, kurse Mutrani nuk e kishte zgjedhur si grua për nipin e tij për shkak të fytyrës së saj të bukur dhe shpirtit sublim, por për faktin se ajo ishte trashëgimtare e pasur e cila me pasurinë e saj të madhe do t'ia siguronte të ardhmen Mensur-beut dhe me pronat e saj të mëdha do t'i ndihmonte që të arrijë një pozitë të lartë mes njerëzve të dalluar e të ngritur.

Prijësit fetarë në Lindje nuk mjaftohen me famën dhe autoritetin që e kanë arritur, por bëjnë gjithë ç'është e mundur

për t'i vënë familjarët e vet në krye të popullit, ashtu që atë famile ta bëjnë të fortë e të pasur me udhëheqës arbitrarë.

Fama e emirit bartet përmes trashëgimisë tek biri i tij i parë pas vdekjes së tij, ndërsa fama e prijësit fetar bartet si epidemi tek vëllezërit dhe bijtë e tyre duke qenë ai ende në jetë.

Kështu, peshkopi i krishterë, imami musliman dhe prifti brahman bëhen si përbindësja deti të cilët e rrëmbejnë viktimën me shumë brirthe dhe ua thithin gjakun me disa goja.

Kur e kërkoi Mutrani dorën e Selmës nga i ati i saj, plaku iu përgjigj vetëm me heshtjen e thellë dhe lotë të nxehtë. Cilit prind nuk i vie rëndë ndarja me të bijën, edhe sikur të shkonte në shtëpinë fqinje apo në pallatin mbretëror? Cilit njeri shpirti nuk do t'i rënkonte kur ligji i natyrës e ndan nga e bija me të cilën luante derisa ishte e vogël, e edukonte si vajzë dhe shoqërohej me të si një femër e rritur?

Pikëllimi i prindërve për shkak të martesës së të bijës është proporcional me gëzimin e tyre për martesën e të birit, duke qenë se ky i fundit ia sjell familjes një anëtar të ri, derisa vajza e varfëron familjen me një anëtar të vjetër e të dashur.

Plaku e pranoi kërkesën e Mutranit, si i detyruar, dhe u përkul para vullnetit të tij duke e mposhtur kundërshtimin në shpirtin e tij. Ai ishte takuar që më parë me Mensur-beun dhe kishte dëgjuar se ç'flisnin njerëzit për të.

Ai e njihte vrazhdësinë, lakminë dhe moralin e tij të ulët, mirëpo, pavarësisht kësaj, cili i krishterë mund ta kundërshtojë peshkopin në Siri dhe të mbetet i mbrojtur në mesin e besimtarëve?

Cili njeri refuzoi t'i bindet prijësit të tij fetar në Lindje, e njëherësh mbeti i ndershëm mes njerëzve?

A mund të luftojë syri me shigjetat e të mos goditet, apo të ndeshet dora me shpatën e të mos prehet?

Edhe sikur plaku të ishte në gjendje ta kundërshtonte Mutranin dhe t'i kundërvihet lakmisë së tij, a thua nderi i bijës së tij do të ishte i sigurt nga dyshimet dhe komentimet? A do të mbetej i pastër emri i saj nga ndyrësitë që i shkaktojnë gojat dhe gjuhët? A nuk janë të thartë të gjithë kalaveshët që rriten lart sipas bindjes së hienave?

Kështu, fati e rrëmbeu Selmën dhe e dërgoi si një robëreshë të nënshtuar në vargun e grave të palumtura nga Lindja. Atë shpirt të veçantë sublim e lidhën me litarë pikërisht në kohën kur për herë të parë notoi me krahët e bardha të dashurisë nëpër lartësi, të mbushura me rrezet e hënës dhe të parfumosura me aromat e luleve.

Pasuria e prindërve në shumicën e vendeve bëhet shkak i vuajtjes së fëmijëve të tyre. Ato thesare të mëdha të cilat i mbush zelli i të atit dhe kursimi i së ëmës, shndërrohen në një burg të ngushtë e të errët për shpirtrat e trashëgimtarëve. Ajo hyjni madhështore të cilën e adhurojnë njerëzit në formën e dinarit, shndërrohet në një djall të frikshëm i cili i mundon shpirtrat dhe i mbyl zemrat.

Selma Kerame ishte si shumë vajza të tjera të cilat shkojnë si viktima të pasurisë së të atit shpresave të burrit.

Sikur Faris Kerame të mos ishte njeri i pasur, Selma sot do të ishte gjallë dhe do t'i gëzohej si ne, dritës së diellit.

Gjatë një jave, dashuria ndaj Selmës më shoqëronte në mbremje dhe më këndonte në vesh këngët e lumturisë, ndërsa në mëngjes më zgjonte për t'ma treguar qëllimin e jetës dhe sekretet e gjithësisë.

Dashuria sublime nuk e njeh zilinë, meqë është shumë e pasur dhe nuk i shkakton dhembje trupit, ngaqë ndodhet në brendi të shpirtit.

Dëshira e fortë e kënaq shpirtin me modesti. Uria e madhe e mbush zemrën edhe me pak. Ndjenja lind pasionin, mirëpo më pas nuk e nxit atë. Kështu, kjo magjepsje më bëri që tërë botën ta shoh si begati, kurse jetën – si një ëndërr të bukur.

Në mëngjes ecja nëpër fusha dhe gjatë zgjimit të natyrës shihja shenjat e përjetësisë. Ulesha pranë bregut të detit dhe nga valët e tij dëgjoja këngët e amshimit. Ecja nëpër rrugët e qytetit, me ç'rast në fytyrat e kalimtarëve dhe në lëvizjet e punëtorëve vëreja bukuritë e jetës dhe madhështinë e qytetërimit.

Ishin ato ditët që kaluan si fantazirat dhe u tretën si mjegulla, e prej tyre mua s'më mbeti gjë tjetër pos kujtimeve të dhe-mbshme – meqë, syri me të cilin e vështroja bukurinë e pranverës dhe zgjimin e fushave, tani nuk sheh asgjë tjetër pos zemërimit të stuhive dhe dëshpërimit të dimrit.

Veshi me të cilin dëgjoja këngën e valëve, tani nuk dëgjon gjë pos rënkimit të thellësive dhe ulërimit të humnerës.

Shpirti i cili përulësisht qëndronte para aktivitetit njerëzor dhe famës së qytetërimit, nuk ndien më asgjë pos mjerimit të të varfërve dhe fatkeqësisë së të ngratëve.

Ah, sa të ëmbla janë ditët e dashurisë dhe ëndrrat e tyre, e sa të hidhura janë netët e pikëllimit dhe sa të shumta – tmerret e tyre!

Kah fundi i javës, kur shpirti im tashmë ishte dehur me ndjenja, u nisa në mbrëmje për te shtëpia e Selma Kerames – ai tempull të cilin e ngriti bukuria dhe e shenjtëroi dashuria, ashtu që shpirti, duke u lutur, të bie përmbys, e zemra të për-kulet përulësisht.

Kur arrita pranë shtëpisë dhe hyra në atë kopsht të qetë, ndjeva njëfarë force e cila më rrëmbente, më tërhiqte, më largonte nga kjo botë dhe ngadalë më afronte kah një botë magjike, ku nuk kishte zënka e mundime.

Si një mistik të cilin qielli e tërheq në sipërfaqet e vizion-eve, ecja mes atyre drunjve të gërshetuara dhe luleve të përqa-fuara. Kur u afrova pranë derës së shtëpisë, e ktheva kokën dhe e pashë Selmën, të ulur, në atë karrigë, nën hijen e drurit të ja-seminit, aty ku ishim të ulur para një jave, në atë natë të cilën Perëndia e zgjodhi midis shumë netëve dhe e bëri fillimin e lumturisë dhe fatkeqësisë sime.

Iu afrova asaj në heshtje, ndërsa ajo as nuk lëvizi e as nuk foli, sikur e dinte se unë po vij edhe para se të vija. Sapo u ula pranë saj, ajo më vështroi një çast dhe psherëtiu gjatë e thellë, e më pas e hodhi shikimin kah horizonti i largët, atje ku fillimi i natës luan me fundin e ditës.

Pas një kohe të shkurtër, të mbushur me atë qetësi magjike e cila shpirtrat tanë ia bashkëngjiste vargut të shpirtrave të padukshëm, Selma e ktheu fytyrën kah unë, ma mori dorën me dorën e saj të dridhur e të ftohtë dhe me një zë që i ngjante psherëtimit të një të urituri i cili nuk ka forcë të flasë, më tha:

“Ma shiko fytyrën, mik ... ma shiko mirë fytyrën. Vështroje gjatë dhe lexo prej saj çdo gjë që do të doje të kuptoje nga unë për-mes fjalëve ... ma shiko fytyrën, i dashur ... shikoje mirë, vëlla!”

E shikova fytyrën e saj. E shikova gjatë dhe i pashë ata sy të cilët para disa ditësh buzëqeshnin si buzët dhe lëviznin si kra-hët e mëllenjës. Tani ishin shuar e tharë dhe ishin ngjyrosur me imagjinatat e dhembjes dhe vuajtjes.

E pashë atë lëkurë e cila rishtas ishte si petla e një luleje të bardhë që kënaqej me puthjet e diellit, tani ishte zverdhur e ishte tharë dhe ishte mbuluar me vellon e dëshpërimit.

I pashë buzët të cilat më parë dukeshin si akacie që derdh-nin ëmbëlsi, tani ishin bërë të thatë dhe dukeshin si dy lule të dridhura që i ka lënë vjeshta në skaj të degës.

E pashë qafën e cila ishte e lartë si shtylla e fildishtë, tani ishte e përkulur kah ana e përparme, sikur nuk është më në gjendje të bart gjithë atë që zihet në kokën e saj.

I vëreja këto ndryshime të dhembshme në fytyrën e Selmës. Të gjitha i vëreja, mirëpo, prapëseprapë, mua m'u dukën si një re e butë që e mbulon hënën, me ç'rast e bën edhe më të bukur e më tërheqëse.

Vijat e fytyrës të cilat i zbulojnë fshehtësitë e thella të personalitetit, i japin fytyrës bukuri dhe hijeshi, sado që ato fshehtësi të jenë të dhembshme e të rënda.

Ndërkaq, fytyrat të cilat me heshtjen e tyre nuk flasin për brendësitë dhe fshehtësitë e shpirtit, nuk janë të bukura e të hijshme, sado që të jenë të harmonishme vijat dhe pjesët e tjera të tyre.

Gotat nuk i joshin buzët tona derisa kristali t'na e zbulojë ngjyrën e verës.

Kështu, Selma Kerame, në mbrëmje të asaj dite ishte si një gotë e mbushur me nektar qiellor, në suptilitetin e të cilit përzihej hidhësia e jetës me ëmbëlsinë e shpirtit.

Ajo e pasqyronte, pa e ditur fare këtë, jetën e gruas nga Lindja, e cila largohet nga shtëpia e dashur prindërore vetëm për ta vënë qafën nën zgjedhën e ashpër të burrit – e cila e lë prehërin e butë të nënës vetëm për të jetuar në robërinë e vrazhdë të nënës së burrit të saj.

Mbeta duke e vështruar fytyrën e Selmës, duke i dëgjuar frymëmarrjet e saj të ndërprera, i heshtur dhe i zhytur në mendime, duke vuajtur me të dhe për të.

Atëherë, ndjeva sikur koha ishte ndalur në ecurinë e saj, sikur bota ishte zhdukur e tretur, dhe nuk shihja më asgjë pos dy syve të mëdha, të ngulitura në thellësinë time. E ndjeja vetëm një dorë të ftohtë e të dridhur që e mbante timen.

Nga kjo dremetje jam zgjuar vetëm atëherë kur e dëgjova Selmën e cila thoshte qetë:

“Eja të flasim tani, miku im. Eja të përpiqemi ta shohim ardhmërinë para se ajo të lëshohet mbi ne me tmerret dhe lemeritë e saj. Babai im ka shkuar tek shtëpia e njeriut i cili do të jetë shoqërues imi deri në varr. Njeriu, të cilin e ka zgjedhur qielli si shkak i ekzistencës sime, ka shkuar për t’u takuar me njeriun të cilin toka e ka caktuar si zotëri për ditët e mia vijuese.

Në zemër të këtij qyteti, tani bisedon plaku i cili më shoqëronte gjatë tërë rinisë sime, me një djalosh i cili do t’më shoqërojë gjatë viteve të mbetura.

Në këtë natë, babai dhe i fejuari do të miren vesh rreth ditës së martesës e cila do të vijë shpejt, sado që ata e bëjnë të largët. Ah, sa i çuditshëm është ky moment dhe sa i rëndë që është!

Në një natë të këtillë gjatë javës së kaluar, nën drurin e këtij jasemini, dashuria e ka përqafuar për herë të parë shpirtin tim, derisa fati po e thurte fjalën e parë nga rrëfimi i ardhmërisë sime në shtëpinë e Mutran Galibit.

Në këtë çast, janë ulur babai im dhe i fejuari për ta thurur kurorën e martesës.

Po të shikoj se si rrin ulur pranë meje, duke ndier se shpirti yt dridhet rreth meje si një zog i uritur i cili duke rrahur krahët rrotullohet mbi burimin e ujit që e ruan një gjarpër i uritur i tmerrshëm.

Sa e errët është kjo natë dhe sa të thella janë sekretet e saj!”

Duke e parë dëshpërimin si një fantazmë e errët e cila e mbërtheu për qafe dashurinë tonë duke dashur ta mbysë qysh si embrion, i thashë:

“Ky zog edhe më tutje do të rrotullohet duke i rrahur krahët mbi burimin e ujit derisa etja ta dërrmojë e ta shkatërrojë apo ta mbërthejë gjarpëri i tmerrshëm, ta shqyejë e ta përpijë”.

“Jo, jo i dashur, – tha ajo e shqetësuar, derisa zëri i dridhej si telat e argjendta. Ky zog le të mbesë gjallë. Le të këndojë ky bilbil deri në mbrëmje, derisa të mbarojë pranvera, derisa të përfundojë kjo botë dhe sa të jetë jeta. Mos e hesht, ngase zëri i tij më jep jetë. Mos ia lidh krahët, meqë lëvizjet e tyre e largojnë mjegullën nga zemra ime”.

“Etja do ta vrasë, Selma, dhe frika do ta mbys”, – pëshpërita unë duke psherëtitur.

Ajo u përgjigj me fjalët të cilat shpërthyen vrullshëm nga buzët e saj të dridhura:

“Etja e shpirtit është më e shijshme se shuarja e etjes me ujë, kurse frika e shpirtit është më e dashur se rehatia e trupit. Mirëpo, dëgjo i dashur, më dëgjo mirë. Unë tani qëndroj para dyerve të një jete të re për të cilën nuk di asgjë. Unë jam sikur një e verbër e cila me dorën e saj i prek muret, nga frika që të mos rrëzohet. Unë jam një robëreshë të cilën pasuria e të atit e dërgon në tregun e skllëvërve dhe ndonjë njeri e blen.

Unë nuk e dua atë njeri ngase nuk e njoh, kurse ti e di se dashuria dhe mosnjohja nuk mund të takohen asnjëherë. Mirëpo, unë do të mësohem me dashurinë e tij, do t’i bindem, do t’i shërbej dhe do ta bëj të lumtur. Do t’i dhuroj gjithçka që një femër e dobët mund t’i dhurojë një mashkulli të fortë.

Ndërsa ti je ende në lulen e rinisë. Para teje është jeta si një rrugë e gjerë, e shtruar me lule e aroma. Ti do të dalësh në botën e gjerë duke bartur zemrën tënde si një pishtar i ndezur.

Do të mendosh lirshëm. Do të flasësh e veprosht lirshëm. Do të shkruash në fytyrën e jetës, meqë ti je mashkull. Do të jetosh si zotëri, ngase varfëria e të atit tënd nuk do të të bëjë rob.

Pasuria e tij nuk do të të dërgojë tek tregu i skllëvërve ku blihen dhe shiten vajzat. Do të martohesh me vajzën të cilën do ta zgjedhësh për vete dhe do ta vendosësh në zemrën tënde

para se ta vendosësh në shtëpi, e me të mendimet do t'i ndash para se ditët e netët t'i kalosh”.

Ajo heshti një çast për ta kthyer frymëmarrjen, pastaj shtoi me një zë që e përcillnin dënesat:

“Megjithatë, a thua, këtu na ndajnë rrugët e jetës për të të dërguar ty tek dinjiteti burror, ndërsa mua tek obligimet femërore? Vallë, kështu mbaron ëndrra e bukur dhe shpërhapet realiteti tërheqës? A kështu e përpin deti i hapur melodinë e mëllenjës, erërat i shpërndajnë fletët e lules, kurse këmbët i thyejnë gotat e verës? A thua, kot na ndali ajo natë para fytyrës së hënës dhe kot na bashkoi shpirti nën hijen e këtij jasemini? A thua, nxituam me shpejtësi për t'u ngjitur kah yjet, me ç'rast krahët na u ligështuan dhe kësisoj na përmbysën në humnerë? A e befasuam dashurinë e përgjumur, me ç'rast u zgjua e zemëruar që t'na dënojë, apo shpirtrat tanë i shqetësuan puhitë e natës të cilat me atë rast u shndërruan në një erë të fuqishme për t'na shqyer dhe hedhur si pluhurin në fund të luginës? Ne nuk e shkelëm besën, e as nuk e shijuam frytin e ndaluar. Përse, atëherë, të dalim nga kjo parajsë? Ne nuk thurëm komplote, e as nuk bëmë trazira, e pse, pra po hidhemi në skëterrë? Jo, jo dhe një mijë e një herë jo!

Delikatesa e cila na bashkoi është më e fortë se gjenerata të tëra. Rrezja e cila i ndriçoi shpirtrat tanë është më e fortë se errësira.

Edhe nëse stuhia na ndan në këtë det të hapur të tërbuar, valët do t'na bashkojnë në atë breg të qetë. Edhe nëse na mbyl kjo jetë, ajo vdekje do t'na ngjallë ...

Zemra e gruas nuk ndryshohet me kalimin e kohës, e as nuk transformohet me stinët e vitit. Zemra e gruas ndodhet gjatë në agoni, mirëpo nuk vdes. Zemra e gruas i ngjan stepës të cilën njeriu e përdor si hapësirë për luftërat dhe therjet e tij.

Aty, ai i shkëlqejte drunjtë, e ndez barin, shkëmbinjtë i lyen me gjak, kurse tokën e mbush me eshtra dhe kafka. Pavarësisht kësaj, ajo mbetet e qetë, e urtë dhe stabile. Pranvera në të mbetet pranverë, ndërsa vjeshta – vjeshtë, deri në mbarim të kohës. Tani, pra, çështja mori fund dhe ç’të bëjmë? Thuaj, ç’të bëjmë? Si do të ndahemi dhe kur do të takohemi? A mund ta konsiderojmë dashurinë si një mysafir të huaj të cilin mbrëmja na e sollti, kurse mëngjesi na e vodhi? A mund të konsiderohet kjo ndjenjë shpirtërore si ëndërr të cilën na e zbuloi dremitja, e më pas e fshehu zgjuarja? A mund të konsiderohet kjo javë si një çast dehjeje, i cili sakaq përfundoi me zhdehje dhe zgjim? Ngrite kokën që të t’i shoh sytë, i dashur. Hapi buzët që të ta dëgjoj zërin. Fol dhe më thuaj: A do t’më kujtosh edhe pasi stuhia ta ketë fundosur anijen time? A do ta dëgjosh rrahjen e krahëve në qetësinë e natës? A do t’i ndiesh frymëmarrjet e mia se si valëvitën rreth fytyrës dhe qafës tënde? A do t’i dëgjosh psherëtimat e mia që ngrihen me dhembje, e lëshohen me rënkime? A do ta shohësh imagjinatën time e cila të përcjell me imagjinatat e errësirës, kurse tretet me mjegullën e mëngjesit? Më thuaj, i dashur – më thuaj shpirt, çka do të jesh për mua, pasi që ishe dritë e syve të mi, melodia e veshëve të mi dhe krah i shpirtit tim. Çka do të jesh?”

Iu përgjigja, derisa e tërë zemra shkrihej në sytë e mi:

“Do të jem, Selma, ashtu siç ti dëshiron të jem”.

Ndërsa ajo tha:

“Dëshiroj të më duash. Dëshiroj të më duash deri në fund të jetës sime. Dëshiroj të më duash ashtu siç i do poeti mendimet e tij pikëlluese. Dëshiroj të më kujtosh ashtu siç e kujton udhëtari burimin e ujit të qetë në të cilin ka parë reflektimin e fytyrës së vet para se të pinte nga ai. Dëshiroj të më kujtosh ashtu siç e kujton nëna embrionin e saj i cili ka vdekur në bark-

un e saj para se ta shihte dritën. Dëshiroj të mendosh për mua ashtu siç mendon sundimtari i mëshirshëm për të burgosurin i cili ka vdekur pak para se t'i arrinte falja e tij. Dëshiroj që të jesh për mua vëlla, shok dhe mik. Dëshiroj nga ti që ta vizitosh babain tim në vetminë e tij dhe ta ngushëllosh në mërzë, meqë, unë së shpejti do ta lë dhe do të bëhem e huaj për të”.

Unë i thashë:

“Të gjitha këto do t'i bëj, Selma. Prej shpirtit tim do të bëj vello për shpirtin tënd, zemrën time do ta bëj shtëpi për bukurinë tënde, kurse gjoksin tim – varr për vuajtjet tua. Do të të dua, Selma, ashtu siç fushat e duan pranverën. Me ty do të jetoj ashtu siç jetojnë lulet me nxehtësinë e diellit. Do të këndoj me emrin tënd ashtu siç këndojnë luginat me jehonën e tingëllimit të kambanave që lëkundën mbi kishat e fshatrave. Do t'i dëgjoj bisedat e shpirtit tënd ashtu siç i dëgjojnë brigjet kallëzimet e valëve. Do të të kujtoj, Selma, ashtu siç e kujton i huaji i humbur vendlindjen e tij të dashur, si i varfëri i uritur – tryezën me ushqime të shijshme, si mbreti i përmbysur – që i kujton ditët e madhështisë dhe famës së tij, si robi i dëshpëruar – kohën e lirisë dhe rehatisë. Do të mendoj për ty ashtu siç mendon bujku për kallëzat dhe lëmenjtë e tij, si çobani i mirë – i cili mendon për korijet e gjelbërta dhe burimet e shijshme”.

Derisa unë po flisja, Selma shikonte errësirën e natës dhe kohëpaskohe psherëtinte. Rrahjet e zemrës së saj shpejtoheshin, e pas pak bëheshin më të ngadalta, sikur valët e detit kur ngriten e ulen. Pastaj tha:

“Nesër, e vërteta do të bëhet iluzion, kurse zhgëndrra – ëndërr. Prandaj, a mund të mjaftohet i përmalluari me përqaftimin e iluzionit dhe a mund ta shuajë etjen i eturi nga përrenjtë e ëndrrave?”

Unë iu përgjigja:

“Selma, nesër fati do të të dërgojë tek prehëri i familjes, e mbushur me rehati e qetësi. Kurse mua do t’me dërgojë në një botë ku ka vetëm përpjekje e përleshje. Ti do të shkosh tek shtëpia e njeriut të cilin do ta bëjë të lumtur bukuria jote dhe dëlirësia e shpirtit tënd, ndërsa unë do të drejtohem kah ditët e pasigurta të cilat do t’me torturojnë me pikëllime dhe do t’me frikësojnë me fantazma. Ti po shkon në jetë, ndërsa unë – në agoni. Ti po shkon tek shoqërimi dhe afërsia, kurse unë – te shkretia dhe vetmia. Megjithatë, në një luginë, nën hijen e vdekjes, unë do të ngris një përmendore të dashurisë të cilën do ta adhuroj. Dashurinë do ta marr si bashkëbisedues timin, do ta dëgjoj duke kënduar, do ta pi si verë dhe me të do të vishem. Në mëngjes, dashuria do t’me zgjojë nga gjumi dhe do t’me çojë tek stepa e largët. Në mesditë, do t’me dërgojë tek hija e pemëve ku do të pushoj me zogjtë që kërkojnë strehim nga vapa e diellit. Në mbrëmje, do t’me përcjellë kah perëndimi për ta dëgjuar këngën përshëndetëse të cilën natyra ia këndon dritës dhe do t’m’i shfaq iluzionet e qetësisë që notojnë në hapësirë. Natën, do t’me përqafojë, e do t’me zërë gjumi duke ëndërruar botët madhështore ku banojnë shpirtrat e të dashuruarve dhe poetëve.

Krah për krah me dashurinë, do të udhëtojmë në pranverë, duke kënduar mes kodrinave e shpateve. Duke ndjekur gjurmët e hapave të jetës të cilat i krijuan manushaqja dhe krizantema, do të pimë mbetjet e shirave me gotat e narcisit dhe zambakut.

Verës, unë dhe dashuria do t’i mbështesim kokat tona për mullarët e kashtës. Në bar do të shtrihemi, e me qiell do të mbulohemi, kurse me hënën dhe me yjet do të gdhihemi.

Në vjeshtë, unë dhe dashuria do të shëtisim nëpër vreshta, e do të ulemi pranë kullores për verë, duke i soditur drunjtë de-

risa e zhveshin petkun e tyre të artë, e duke menduar për tufën e zogjve që ikin kah bregu.

Kurse dimrit, unë dhe dashuria do të ulemi pranë vatrës duke biseduar për brezat e kaluar, e duke përsëritur ndodhitë e popujve dhe gjeneratave të shkuara.

Në ditët e rinisë, dashuria do t'më edukojë, në kohën e pjekurisë do t'më motivojë, kurse në pleqëri do t'më shoqërojë.

Dashuria do të mbesë me mua, Selma, deri në fund të jetës, derisa të vijë vdekja, derisa të më bashkojë Dora e Zotit sërish me ty”.

Fjalët gufonin me shpejtësi nga thellësia e shpirtit tim, si të ishin pishtarë zjarri që rritet e përhapet gjithandej, e më pas dalëngadalë shuhet e fiket në skajet e atij kopshti.

Selma dëgjonte, derisa lotët i ridhnin nëpër faqe, sikur sytë iu bënë buzët, e kësisoj më përgjigjej me lotë.

Ata të cilëve dashuria nuk u dhuroi krahë, nuk mund të fluturojnë përmbi retë për ta parë atë botë magjike rreth së cilës rrotulloheshin shpirti im dhe ai i Selmës, në atë çast, të mërzitur me gëzime dhe të gëzuar me dhembje.

Ata të cilët dashuria nuk i ka bërë ithtarë të vet, nuk dëgjojnë se si flet dashuria. Ky rrëfim nuk është shkruar për ta, meqë ata edhe nëse e kuptojnë domethënien e këtyre faqeve të zbehura, nuk do të jenë në gjendje t'i shohin siluetat dhe iluzionet që fshihen mes rreshtave, e të cilat nuk vishen me petkun e ngjyrës, e as nuk e përdorin letrën si vendbanim.

Megjithatë, cila qenie njerëzore nuk e ka shijuar nektarin e dashurisë nga ndonjë gotë e saj? Cili shpirt nuk është ndalur përulësisht në atë tempull të ndriçuar, të shtruar me farat e zemrës dhe të ndërtuar me sekrete, ëndrra e ndjenja? Cilës lule mëngjesi nuk ia ka derdhur një pikë vesë mes fletëve të saj? Cili përrua e ka humbur rrugën, e nuk shkon kah deti?

Në atë çast, Selma e ngriti kokën kah qielli, i zbukuruar me yje dhe i zgjati duart. Sytë i ishin zmadhuar, buzët i dridheshin, kurse në fytyrën e saj të zverdhur u shfaqën të gjitha ankesat, vuajtjet e dhembjet që pushojnë në shpirtin e gruas së trishtuar.

Pastaj klithi:

“Çfarë ka bërë gruaja, o Zot, që e meritoi zemërimin Tënd? Çfarë mëkatesh ka bërë që ta e përcjell gjithnjë mllëfi Yt? A ka bërë ndonjë krim pafundësisht të tmerrshëm ashtu që edhe dënimi Yt të jetë i pambarim? Ti je i fortë, o Zot, kurse ajo është e dobët. Përse po e shkatërron, pra, me dhembje? Ti je i lartësuar, kurse ajo zvarritet nën fronin Tënd. Përse, pra, e shtyp me këmbë? Ti je një stuhi e fuqishme, ndërsa ajo – si pluhur para fytyrës Tënde. Përse, pra, po e shpërndan në borëra? Ti je i fuqishëm, kurse ajo është e mjerë. Pse, pra, lufton kundër saj? Ti sheh dhe di gjithçka, ndërsa ajo bredh dhe është e verbër. Përse po e shkatërron, pra? Ti atë me dashuri e krijon, e përse, pra, me dashuri e shkatërron? Me dorën Tënde të djathtë po e ngrit tek Ti, ndërsa me të majtën e shtyen në humnerë, derisa ajo është një injorante e cila nuk kupton se kah po e ngrit dhe si po e gjuan. Në gojën e saj fryn frymën e jetës, kurse në zemrën e saj ia mbjell farat e vdekjes. E çon në shtigjet e lumturisë që të ecë në këmbë, e më pas mjerimi e dërgon kalorësin që ta ndjek nga pas. Nga fyti i saj përhap këngën e gëzimit, e mandej ia mbyll buzët me pikëllim, kurse gjuhën ia lidh me mjerim.

Me gishtërinjtë e tu të fshehtë i mbështjell me ëndje dhembjet e saj, ndërsa me gishtërinjtë e dukshëm i vizaton tmerret rreth gjërave me të cilat ajo kënaqet.

Në shtrat ia fsheh rehatinë e qetësinë, kurse pranë shtratit ia lë tmerret e mundimet. Me vullnetin Tënd i ngjall dëshirat e saj, kurse nga po ato dëshira lindin të metat dhe gabimet e saj. Me dëshirën Tënde ia shfaq hijeshitë e krijesave tua dhe me

dëshirën Tënde ia shndërron dashurinë e saj për të bukurën në dhembje e shkatërrim. Me ligjin Tënd e marton shpirtin e saj me një trup të bukur dhe me vendimin Tënd bën që trupi i saj të bëhet bashkëshort në pafuqi dhe poshtërim. Po e ujit me jetë nga gota e vdekjes, dhe me vdekje nga gota e jetës. Po e pastron me lotët e saj dhe po me ato lotë e dënon. Po ia mbush barkun me bukën e ndonjë njeriu, e më pas grushtin e atij njeriu e mbush me copat e zemrës së saj.

Ti, Ti, o Zot, me dashuri i pate hapur sytë e mi dhe me dashuri më verbove. Ti më puthe me buzët tua, ndërsa me dorën Tënde të fortë më godite. Në zemrën time Ti mbolle një lule të bardhë, e rreth kësaj lule bëre që të mbijnë gjemba e kaçuba. Të tashmen time, Ti e lidhe me shpirtin e djaloshit që e dua, kurse ardhmërinë time – me trupin e njeriut të cilin as që e njoh. Prandaj, më ndihmo që të bëhem e fortë në këtë përleshje vdekjeprurëse dhe më mundëso që të mbetem besnike dhe e dëlirë deri në vdekje. Le të jetë dëshira Jote, o Zot. Le të jetë i bekuar emri Yt përgjithmonë”.

Selma heshti, mirëpo shprehja e fytyrës i fliste edhe më tej. Pastaj, e uli kokën, i lëshoi duart dhe iu molis i tërë trupi, sikur forca gjallëruese tashmë e kishte lëshuar, me ç’rast mua më dukej si një degë të cilën stuhia e theu dhe e hodhi në tokë që të thahet e të thërrmohet nën këmbët e kohës.

Unë e kapa dorën e saj të akullt me dorën time të zjarrtë dhe ia putha gishtërinjtë e saj me sytë dhe buzët e mia, e kur tentova ta ngushëlloj me fjalë, hetova se unë vetë isha më i denjë për ngushëllim dhe dhembshuri.

Prandaj, edhe më tej mbeta i heshtur, i hutuar dhe i menduar, duke ndier se si fati po luan me ndjenjat e mia dhe duke dëgjuar thellë në brendi të shpirtit rënkimin e zemrës sime, duke u frikësuar për veten time nga shpirti im.

Askush prej neve, atë natë, nuk nxori më asnjë fjalë nga goja, pasi, kur vuajtja zmadhohet, bëhet e heshtur.

Prandaj, rrinim të heshtur, të palëvizshëm, si dy shtylla mermeri të cilat tërmeti i rrëzoi për toke.

Asnjëri prej nesh nuk dëshiroi më ta dëgjojë tjetrin duke folur, meqë arteriet e zemrave tona ishin dobësuar në atë masë, saqë psherëtimat mund t'i prenin pa fjalë.

Erdhi mesnata. Heshtja e frikshme gjithnjë shtoej, derisa hëna u shfaq e gjymtë prapa malit dhe dukej mes yjeve si një fytyrë e zbehtë e të vdekurit, të zhytur në jastëkët e zinj mes qirinjve të dobët që e rrethojnë arkivolin e tij.

Mali i Libanit dukej si një plak, shpina e të cilit është kërrusur nën barrën e viteve. Shtatin ia kishin përkulur vuajtjet, e gjumi i iku fare, kështu që vigjilon me errësirën duke pritur agimin, si një mbret i përmbysur që rri ulur mbi hirin e fronit të vet, mes rrënojave të pallatit të tij.

Malet, drunjtë dhe lumenjtë i ndryshojnë pamjet e tyre në përputhje me ndërrimet e kohës, njëjtë sikur ndryshojnë vijat e fytyrës së njeriut në përputhje me ndryshimet e mendimeve dhe ndjenjave të tij.

Kështu, druri i plepit, i cili gjatë ditës qëndron lart si një nuse e bukur me rrobat e së cilës fladi po lodronte, në mbrëmje duket si një shtyllë e tymit që ngjitet kah asgjëja.

Shkëmbi i madh që në mesditë duket si një despot i fuqishëm i cili s'e përfill fare ecurinë e kohës, natën duket si një varfanjak i gJORë i cili shtrihet në tokë, e mbulohet me qiell.

Përrenjtë të cilët në mëngjes i shohim të shndërritur si argjendi i shkrirë dhe i dëgjojmë duke kënduar këngën e përjetësisë, në mbrëmje shndërrohen në një govatë lotësh që shpërrthejnë nga brinjat e luginës dhe i dëgjojmë se si rënkojnë e vajtojnë si nëna e cila e ka humbur fëmijën.

Libani, i cili para një jave shfaqte tërë shkëlqimin dhe madhësinë e vet derisa hëna ishte e plotë, e shpirti – i kënaqur, atë natë ishte i pikëlluar, i thyer dhe dukej i egër para hënës së plogësht e të gjymtë, e cila bridhte nëpër hapësirën qiellore, derisa zemra që rrihte brenda gjoksit, ishte e lënduar.

U ngritëm për t'u përshëndetur, derisa midis nesh qëndronin dashuria dhe dëshpërimi si dy pamje të tmerrshme. Dashuria – me krahë të hapura përmbi kokat tona, kurse dëshpërimi me kthetrat e tij na shtrëngonte për qafe.

Dashuria qante me llahtari, ndërsa dëshpërimi qeshte me ironi. Kur e mora dorën e Selmës dhe e vendosa në buzët e mia në shenjë bekimi, ajo m'u afrua dhe ma puthi shtegun e flokëve, e mandej u tërhoq dhe u hodh në karrigën e drunjte, i mbylli sytë dhe pëshpëriti qetë:

“Mëshiro, o Zot, dhe forcoji të gjithë krahët e thyer!”

U largova nga Selma dhe dola nga ai kopsht duke ndier se si një vello e shpeshtë m'i mbulonte të gjitha shqisat, siç e mbulon mjegulla fytyrën e liqenit.

Filloja të ecja, derisa siluetat e drunjve që qëndronin në të dyja anët e rrugës lëviznin para meje si të ishin fantazma që kishin dalur nga thellësitë e tokës për t'më frikësuar.

Njëkohësisht, rrezet e dobëta të hënës vezullonin mes degëve si të ishin shigjeta të holla të cilat shpirtrat e xhinëve që notojnë nëpër gjithësi i hidhnin kah gjoksi im.

Qetësia e thellë më pushtonte sikur shuplakat e rënda të zeza të cilat errësira i hodhi mbi trupin tim.

Çdo gjë që ekziston në botë, çdo gjë që ekziston në jetë dhe çdo fshehtësi në shpirt, tashmë ishte bërë e shëmtuar dhe jash-tëzakonisht e tmerrshme.

Drita e brendshme e cila ma kishte zbuluar bukurinë e botës dhe shkëlqimin e të gjitha qenieve, tani ishte shndërruar në

një zjarr i cili ma digjte zemrën me flakën e tij, kurse shpirtin ma mbulonte me tym.

Kënga së cilës i bashkoheshin zërat e të gjitha krijesave dhe e shndërronin në një himn madhështor, në atë çast ishte transformuar në një gjësim më të frikshëm sesa ulërimi i luanit dhe më të thellë sesa ushtima e humnerës.

Më në fund arrita në dhomën time dhe u hodha në shtrat sikurse zogu që e kishte goditur gjuetari, me ç'rast u rrëzua mes vathave, me shigjetën në zemër.

Vetëdija ende më pluskonte mes zhgjëndrrës së frikshme dhe gjumit shqetësues, derisa shpirti im përsëriste në të dyja gjendjet fjalët e Selmës:

“Mëshiro, o Zot, dhe forcoji të gjithë krahët e thyer!”

PARA FRONIT TË VDEKJES

Në ditët e sotme martesë është thjesht një tregti qesharake dhe vajtuese, të cilën e bëjnë të rinjtë dhe baballarët e vajzave. Në shumicën e vendeve, të rinjtë fitojnë, ndërsa baballarët gjithmonë humbin.

Sa u përket vajzave të cilat barten si malli nga njëra shtëpi në tjetrën, shkëlqimi i tyre tregton dhe sikur gjërat e vlefshme antike, fati i tyre qëndron tek qoshtet e shtëpisë ku mbretërojnë errësira dhe zhdukja e ngadalshme.

Qytetërimi bashkëkohor ka zhvilluar në një masë intelektin e gruas, mirëpo në anën tjetër ka shtuar vuajtjet e saj me forcimin e ambicieve të mashkullit.

Gruaja, deri dje, ishte një shërbëtore e lumtur, kurse sot është bërë një zonjë fatkeqe. Deri dje ishte një grua e verbër e cila ecte në dritën e ditës, ndërsa sot është një grua që sheh dhe ec nëpër errësirën e natës.

Ishte bukuroshe me mosdijen e saj, e çmuar për thjeshtësinë e saj dhe e fortë pikërisht me dobësinë e saj, kurse tani është bërë e shëmtuar me përkryerjen e saj, me ndjenja të cekëta dhe larg nga njohja e zemrës.

A thua, do të vijë dita kur te gruaja do të bashkohen bukuria me arsimin, përkryerja me moralin dhe dobësia trupore me forcën shpirtërore?

Unë jam nga ata që pohojnë se ngritja shpirtërore është natyrshmëri e njerëzimit dhe se përparimi kah përsosja, ndonëse është ligj i ngadalshëm, megjithatë është efikas.

Prandaj, nëse gruaja zhvillohet në një fushë, e diku tjetër ngec, atëherë kjo ndodh për shkak se mes pengesave përmes të

cilave arrijmë deri tek maja e malit, ka skuta hajdutësh dhe gropa ujqish.

Në këtë mal që i ngjan dremitjes e cila e avancon zhgjiëndrën, në këtë mal i cili i mbërtheu për toke gjeneratat e kaluara dhe ata që do të vijnë – në këtë mal, me synime dhe shpresa të çuditshme, askund nuk ka grua e cila me jetën e saj simbolizon gruan e së ardhmes.

Selma Kerame në Bejrut paraqiste simbolin e gruas madhështore orientale, mirëpo ajo, sikur shumë të tilla të cilat jetojnë para kohës së tyre, u bë viktimë e së tashmes. Si një lule që e rrëmbeu dega e lumit, ajo është dërguar dhunshëm në rrjedhën e jetës dhe drejt në shkatërrim.

Mensur-beu u martua me Selmën. Ata u vendosën në një shtëpi të madhe, të ngritur pranë bregut të detit, në periferi të Bejrutit, aty ku banojnë aristokratët e popullit dhe pasanikët.

Faris Kerame mbeti i vetmuar në atë shtëpi të izoluar, mes kopshteve e parqeve, sikurse bariu në kopenë e tij.

Kaluan ditët e dasmës dhe përfunduan netët e gëzimit. Kaloi muaji të cilin njerëzit e quajnë ‘muaji i mjaltit’, e i cili ka lënë prapa muajt e vrerit dhe hidhësisë, siç i lënë sukseset e luftës kafkat e të vrarëve nëpër stepa të largëta.

Shkëlqimi i dasmave orientale i ngrit shpirtrat e djelmoshave dhe vajzave në lartësitë e shqiponjës para reve, e më pas i hedh si mokrën në thellësitë e detit.

Ato dasma, madje, u ngjajnë gjurmëve të këmbëve nëpër zallin e bregut, gjurmë të cilat shumë shpejt i fshijnë dallgët e detit.

Kaloi pranvera, e pas saj edhe vera. Pastaj erdhi vjeshta, ndërkaq dashuria ime ndaj Selmës shkallëzohej nga pasioni i një djaloshi në lulen e rinisë ndaj gruas së bukur, në një lloj adhurimi të heshtur të cilin e ndien fëmiu jetim ndaj shpirtit të nënës që banon në përjetësi.

Dashuria e cila e zotëronte tërë qenien time, ishte shndërruar në një dëshpërim të verbër që nuk sheh gjë tjetër pos saj. Dashuria e zjarrtë e cila m'i mbushte sytë me lotë, ishte shndërruar në vuajtje e cila ma derdhte gjakun nga zemra.

Psherëtimat e nostalgjisë të cilat ma mbushnin gjoksin, u shndërruan në një përgjërëm të zemrës, të cilin shpirti im në qetësi ia drejtonte qiellit, me shpresë që lumturia e Selmës të zgjasë, që bashkëshorti i saj të jetë i kënaqur dhe babai i saj të jetojë i rehatshëm.

Megjithatë, kot shkuan dhembshuria, përgjërimet dhe lutjet e mia, meqë fatkeqësia e Selmës paraqiste një sëmundje në thellësi të shpirtit, sëmundje të cilën vetëm vdekja mund ta shëronte.

Sa i përket bashkëshortit të saj, ai ishte nga ata njerëz të cilët pa mund arrijnë çdo gjë që e bën jetën komode, të cilët asnjëherë nuk kënaqen me atë çka kanë, madje lakmojnë gjithnjë pas asaj që nuk u takon atyre. Kësisoj, mbesin përgjithmonë të dënuar me lakminë e tyre.

Kot lutesha për rehatinë e Faris Kerames, ngase dhëndërrri i tij nuk e mori vetëm dorën e bijës së tij dhe pasurinë e saj, saqë e harroi dhe e shpërfilli tërësisht atë, mirëpo krahas kësaj, dëshironte edhe vdekjen e tij me qëllim që të shtijë në dorë edhe pjesën e mbetur të pasurisë së tij.

Mensur-beu ishte i ngjashëm sikurse xhaxhai i tij, Mutran Galib. Morali dhe shpirti i tij i ngjasonin plotësisht atij dhe dalloheshin vetëm aq sa dallohet hipokrizia nga rrokullisja.

Mutrani arrinte qëllimet e tij duke u fshehur nën petkat e tij ngjyrë vjollce, lakmitë e tij i ngopte duke u mbrojtur me kryqin e artë, të varur rreth qafe, kurse nipi i tij të gjitha këto i bënte haptas dhe dhunshëm.

Mutrani shkonte në kishë, në mëngjes, ndërsa pjesën tjetër të ditës e kalonte duke ua rrëmbyer pasurinë vejushave, jetimë-

ve dhe zemërdëlirëve, kurse Mensur-beu e kalonte tërë ditën duke shkuar pas qejfeve dhe duke i kënaqur epshtet e tij nëpër ato rrugica të errëta ku ajri ndotet me frymëmarrjet e shturjes.

Ditën e dielë, Mutrani qëndronte para altarit dhe ua këshillonte besimtarëve atë që vetë nuk e zbatonte, e ditët e tjera të javës i kalonte duke u marrë me politikën shtetërore.

Ndërkaq, nipi i tij i kalonte tëra ditët duke tregtuar me autoritetin e xhaxhait të tij tek ata që kërkonin nëpunësi dhe që dëshironin prestigj.

Mutrani ecte duke u fshehur nën mbulesën e natës, derisa Mensur-beu lëvizte guximshëm në pikë të ditës.

Kështu zhduken popujt mes hajdutëve e mashtruesve, siç zhduken kopetë mes nofullave të ujqve dhe kamave të kasapëve.

Kështu, popujt u nënshtrohen njerëzve me shpirt të përdhosur dhe atyre me moral të prishur, me ç'rast ngecin prapa, e më pas bien në humnerë, derisa koha kalon dhe i shtyp me këmbë siç i thërmojnë çekanët e hekurt enët keramike.

Çfarë po më shtyen, vallë, t'u kushtoj tani këto faqe rrëfimit për popujt e mjerë dhe të dëshpëruar, sa kohë që tanimë i kam veçuar për të shkruar rrëfimin mbi një grua fatkeqe si dhe për t'i pikturuar iluzionet e një zemre të lënduar të cilën dashuria e ka goditur me pikëllim sapo e ka prekur me gëzim?

Përse po i derdh lotët duke i përkujtuar popujt e plogët dhe të gjorë, duke qenë se lotët i kam derdhur në shenjë përkujtimi të një gruaje të dobët të cilën vdekja e ka marrë ngrykë sapo e ka përqaftuar jetën?

Mirëpo, a nuk është gruaja e dobët simbol i popullit të gjorë? A nuk është gruaja që vuan mes dëshirave të shpirtit dhe prangave të trupit sikurse populli që vuan nga qeveritarët dhe priftërinjtë e vet?

A nuk janë ndjenjat e fshehta të cilat femrën e bukur e çojnë në errësirën e varrit sikurse stuhitë e fuqishme të cilat e mbulojnë me dhë jetën e popujve?

Gruaja për popullin është sikurse flaka për fenerin. A thua, flaka e fenerit do të jetë e pakët nëse ka vaj me bollëk?

Kaluan ditët e vjeshtës dhe erërat i zhveshën drunjtë duke lozur me gjethet e verdha siç lozin shtrëngatat me shkumën e detit.

Pastaj erdhi dimri duke qarë e vajtuar, e unë po qëndroja në Bejrut pa askë, përveç ëndrrave të cilat herë ma ngritnin shpirtin saqë i arrinte yjet, e herë ma ulnin zemrën saqë e varrosnin në brendinë e tokës.

Shpirti i dëshpëruar gjen rehati në izolim e vetmi, prandaj edhe largohet nga njerëzit, mu siç largohet gazela e plagosur nga kopeja dhe fshihet në shpellën e saj derisa të shërohet apo të vdesë.

Një ditë dëgjova se Faris Kerame ishte i sëmurë, prandaj e lashë vetminë time dhe shkova ta vizitoj.

Ecja nëpër një vendkalim të vetmuar, mes atyre drunjve të ullirit, mbi gjethet plumbore të të cilit shndërrisnin pikat e shiut, dhe u largova nga rruga kryesore ku zhurma e karrocave e prish qetësinë.

Kur arrita në shtëpinë e plakut dhe hyra brenda, e gjeta të shtrirë në shtrat, me trup të dërrmuar dhe me fytyrë të zbehtë. Sytë i ishin zhytur nën vetulla ashtu që dukeshin sikur dy shpella të thella e të errëta, të rrethuara me vuajtje e dhembje.

Vijat e fytyrës të cilat rishtazi shprehnin gëzim dhe disponim, tani ishin rrudhur dhe errësuar dhe ishin bërë si një fletë e përhimtë e zhubrosur në të cilën sëmundja i shkruan rreshta të çuditshëm dhe enigmatikë.

Duart të cilat ishin të stolisura me dhembshuri e butësi, ishin dobësuar aq shumë saqë eshtrat e gishtërinjve nën lëkurë

dukeshin sikur degët e zhveshura që dridhen gjatë stuhisë. Kur iu afrova duke e pyetur se si ndihet, e ktheu fytyrën e tij të molisur kah unë, derisa në buzët e tij të dridhura u shfaq një buzëqeshje pikëlluese.

Me një zë të dobët e të ulët që dukej sikur vinte prapa mureve, tha:

“Shko, shko bir në atë dhomë, fshija lotët Selmës dhe qetësoje, e pastaj eja me të tek unë që të ulësh pranë shtratit tim”.

Hyra në dhomën fqinje ku e gjeta Selmën të shtrirë në shtirat. Kokën e kishte mbuluar me duar, fytyrën e kishte futur në jastëkë, derisa përmbahej nga frymëmarrja me qëllim që i ati të mos e dëgjojë duke qarë.

Iu afrova ngadalë dhe e shqiptova emrin e saj me një zë, i cili më shumë i ngjante psherëtimës sesa pëshpëritjes.

Ajo rrëqethi e tronditur, si një njeri i përgjumur të cilin e mendojnë ëndrrat e frikshme. Më pas, u drejtua në shtrat dhe hodhi shikimin kah unë me sytë e zgurdulluar, sikur kishte parë një fantazmë nga bota e ëndrrave, duke mos besuar se unë, vërtet, gjendesha në atë vend.

Pas një heshtjeje të thellë, e cila me nostalgjitë e saj magjike na ktheu në ato çaste kur deheshim me nektarin hyjnor, Selma i fshiu lotët me majat e gishtërinjve të saj dhe tërësisht e thyer, tha:

“A po e sheh se si janë ndryshuar kohërat? A e pe se si fati na çoi në rrugë të gabuar, e me shpejtësi u gjetëm në këto shpella të frikshme? Në këtë vend pranvera na bashkoi në prehërin e dashurisë, kurse tani, në po këtë vend dimri na tubon para fronit të vdekjes. Sa e bukur ishte ajo ditë, e sa e zymtë është kjo natë!”

I shqiptoi këto fjalë, në atë mënyrë që rrokjet e fundit i gëlltitën rënkimet. Pastaj, sërish e mbuloi fytyrën me duar, sikur kujtimet e së kaluarës ishin trupëzuar e drejtuar para saj, derisa nuk dëshiroi t'i shihte.

Unë e vura dorën mbi flokët e saj duke i thënë:

“Eja, Selma! Eja të drejtohem si shtylla para stuhisë! Eja të qëndrojmë si ushtarë para armikut, të kthyer kah tehet e shpatës me gjoksa e jo me shpina. Nëse pësojmë, do të vdesim si dëshmorë, e nëse ngadhënjëjmë, do të jetojmë si heronj.

Vuajtja e shpirtit, të patundur para fatkeqësive e mundeve, është më e ndershme sesa nënshtrimi për hir të sigurisë dhe rehatisë.

Flutura e cila nuk ndalet së rrotulluari rreth fenerit derisa të digjet, është më e ngritur se përjetësia e cila jeton në errësirë për hir të komoditetit dhe paqes.

Fara e cila nuk e përballon dot acarin e dimrit dhe tërbimin e furtunave, nuk do t’ia dalë mbanë ta çajë tokën dhe nuk do t’i gëzohet bukurisë së prillit.

Eja, Selma, të ecim me këmbë të forta nëpër këtë rrugë të gërryer, me sy të drejtuar kah dielli, ashtu që të mos i shohim kafkat e hedhura mes shkëmbinjve dhe gjarpërinjtë që zvarriten mes gjembave.

Nëse frika na ndal në mes të rrugës, fantazmat e natës do të na shtyjnë ta dëgjojmë bërtimën e mahitjes dhe përqeshjes. Nëse arrijmë me guxim deri te maja e malit, shpirtrat e gjithësisë do të këndojnë me ne himnin e fitores dhe ngadhënjimit.

Qetësohu Selma dhe fshiji lotët. Fshihe këtë pikëllim të hapur në fytyrën tënde dhe ngritu të ulemi pranë shtratit të babait tënd, ngaqë jeta e tij varet nga jeta jote, kurse shërimi i tij qëndron në buzëqeshjen tënde”.

Selma më vështroi me një shikim plot dhembshuri e butësi, e pastaj tha:

“A kërkon prej meje durim dhe vendosmëri, derisa nga sytë e tu shpërthejnë dëshpërimi dhe humbja e shpresës? A thua, varfanjaku i uritur mund t’ia japë bukën e tij një varfanjaku

tjetër të uritur? A thua, i sëmuri mund t'ia ofrojë ilaçin një të sëmuri tjetër, sa kohë që ai vetë është më nevojtar për ilaçin?”

Më pas, Selma u ngrit dhe kokëulur u nis para meje kah dhoma e të atit.

U ulëm pranë shtratit të plakut të sëmurë. Selma mundohej ta shprehte buzëqeshjen dhe gjakftohtësinë, kurse babai i saj shtirej sikur është i qetë dhe i fortë.

Secili prej tyre ndiente dhembje për tjetrin, dinte për plogështinë e tij dhe i dëgjonte rënkimet e zemrës së tij.

Ata dy ishin sikur dy forca të cilat reciprokisht treten në qetësi. I ati ishte një i sëmurë rëndë i cili shkrihej për shkak të fatkeqësisë së të bijës, derisa e bija e donte atë, prandaj edhe vyshkej në dhembje për shkak të sëmundjes së të atit.

Njëri shpirt në largim, kurse tjetri në dëshpërim po përqafoheshin para dashurisë dhe vdekjes.

Ndërkaq unë, në mesin e tyre, i duroja dhembjet e mia dhe e përballoja rëndë atë që po u ndodhte atyre.

Ishin ata tre persona të cilët i bashkoi dora e fatit, e më pas i mbërtheu aq fort saqë i thërrmoi tërësisht.

Plaku pasqyronte një shtëpi të vjetër të cilën e kishte rrënuar përmytja, kurse vajza – një manushaqe, qafën e së cilës ia kishte prerë kosa. E djaloshi i ngjante një bime të dobët, shtatin e së cilës ia mbështillnin borërat. Kështu, të gjithë ne ishim sikur një lodër në duart e fatit.

Atëherë, plaku lëvizi nën çarçafë, e zgjati dorën e tij thata-ke kah Selma dhe me një zë përplot butësi dhe dhembshuri të zemrës prindërore, përplot vuajtje dhe dhembje nga kraharoni i një të sëmuri, tha:

“Vëre dorën tënde në timen, Selma!”

Ajo e zgjati dorën dhe e vuri mes gishtërinjve të tij, me ç’rast ai e kapi me butësi dhe shtoi:

“Jam ngopur me jetën, bija ime. Kam jetuar gjatë. I kam shijuar të gjitha frytet që i prodhojnë stinët e vitit dhe jam kënaqur me të gjitha ato që i sjellin ditët e netët. Si fëmijë, vrapoja pas fluturave, si djalosh e përqafoja dashurinë, e si njeri i pjekur mblidhja pasuri dhe në të gjitha këto periudha të jetës isha i lumtur dhe i kënaqur. E humba nënën tënde, Selma, para se ti t’i mbushje tre vjet, megjithatë ajo ma la ty si një thesar të çmuar. Ti rriteshe shpejt si hëna, derisa në fytyrën tënde reflektoheshin vijat e nënës tënde ashtu siç reflektohen rrezet e yjeve në një liqen të qetë. Te ti theksoheshin morali, karakteri dhe tiparet e saj përmes veprimeve dhe fjalëve tua ashtu siç theksohen stolitë e arit prapa vellos së tejdukshme.

Prandaj edhe jam ngushëlluar me ty, bija ime, duke qenë se ti ishe e bukur dhe e urtë sikur ajo.

Tani jam një plak i dërrmuar, e rehatia e pleqve qëndron mbi krahët e buta të vdekjes. Ngushëllohu, bija ime, meqë arrita të të shoh si një grua të plotë, dhe gëzohu ngase me ty do të mbes gjallë edhe pasi të vdes.

Krejt një është a do të iki tani, nesër apo pasnesër, sepse ditët e jetës sonë janë sikurse gjethet e vjeshtës që bien dhe shpërndahen para rrezeve të diellit.

Nëse koha më dërgon me nguti në përjetësi, kjo është për arsye se ajo e kuptoi që shpirti im është përmalluar fort për t’u takuar me nënën tënde”.

Fjalët e fundit i shqiptoi me një ton, të stërm bushur me dhe-mbshuri e përgjërëm, derisa në fytyrën e tij të tkurrur u shfaqën ca rreze që i ngjanin atij shkëlqimi që shpërthen nga sytë e fëmijëve.

Mandej, e futi dorën nën jastëkë që e rrethonin kokën e tij dhe nxori një fotografi të vogël të vjetër me kornizë të artë, në skajet e së cilës kishin mbetur prekjet e duarve, ndërsa gdhendjet ishin fshirë nga puthjet e buzëve.

Më pas, duke mos e kthyer vështrimin nga fotografia, plakut tha:

“Afrohu, Selma! Afrohu tek unë, bija ime, të ta tregoj pamjen e nënës tënde. Eja dhe shikoje hijen e saj në një copë letre”.

Selma u afrua duke i fshirë lotët nga sytë ashtu që të mos i pengonin ta shohë fotografinë e zbehur. Pasi që e vështroi gjatë, sikur të ishte pasqyrë që e reflektonte vetë qenien e fotografisë dhe pamjen e së ëmës, e afroi tek buzët dhe me afsh e puthi disa herë pandërprerë, e më pas klithi:

“Ah, nënë! Nënë! Nënë!”

Duke mos e përsëritur më këtë fjalë, Selma sërish e vuri fotografinë në buzët e saj dridhëse, sikur me frymëmarrjet e saj të nxehta donte të fuste jetë në të.

Fjala më e ëmbël që e shqiptojnë buzët njerëzore është fjala ‘nëna’, kurse thirrja më e bukur është ‘Nënë!’

Ajo është një fjalë e vogël dhe e madhe në të njëjtën kohë, e mbushur me shpresë, dashuri, dhembshuri dhe me butësi e ëmbëlsi të pakufishme që ngërthen zemra njerëzore.

Nëna paraqet çdo gjë në këtë jetë. Ajo është ngushëllim gjatë pikëllimit, shpresë në dëshpërim dhe forcë në dobësi. Ajo është burim i butësisë, mëshirës, dhembshurisë e faljes. Ai që e humb nënën, e ka humbur prehërin ku do ta mbështes kokën, dorën e cila e bekon dhe syrin i cili e ruan dhe vigjilon mbi të.

Çdo gjë flet për amësinë dhe e simbolizon atë. Dielli është nëna e kësaj toke të cilën e tajit me ngrohtësinë, e përqafton me dritën e tij dhe në mbrëmje e lë vetëm pasi ta ketë vënë në gjumë me meloditë e dallgëve të detit, cicërimën e zogjve dhe gurgullimën e përrenjve.

Toka është nëna e drunjve dhe luleve të cilat i lind e i tajit, e pastaj i largon nga gjiri. Drunjtë dhe lulet bëhen në atë rast nëna të dhembshura për frytet e shijshme dhe farat e gjalla.

Ndërsa, nëna e çdo gjëje në gjithësi është shpirti i përjetshëm universal, i mbushur me bukuri e dashuri.

Selma Kerame nuk arriti ta njohte të ëmën, meqë ajo vdiq derisa Selma ishte ende fëmijë, prandaj edhe klithi e mallëngjyer posa e pa fotografinë e saj duke thirrur instinktivisht ‘në-në!’, meqë kjo fjalë fshihet në zemrat tona ashtu siç fshihet fara në zemrën e tokës.

Ajo shpërthen nga buzët tona në momentet e pikëllimit e gëzimit, ashtu siç ngritet aroma nga zemra e lules në ajër të pastër e me shi.

Selma e vështronte me ngulm fotografinë e së ëmës, e pastaj e puthte me afsh, e shtrëngonte në kraharorin e saj të shqetësuar dhe rënkonte duke psherëtitur.

Me çdo psherëtitje e humbte edhe një pjesë të forcës, derisa trupi i saj i ndrydhur u molis tërësisht, me ç’rast u përmbys pranë shtratit të të atit.

Ai i vuri të dy duart mbi kokën e saj duke i thënë:

“Ta kam treguar, bija ime, pamjen e nënës tënde në një copë letre, e tani dëgjomë të t’i tregoj fjalët e saj”.

Selma e ngriti kokën, siç bën trumcaku në çerdhe kur dëgjon të rrahurit e krahëve të së ëmës në degë, pastaj e shikoi të atin duke e dëgjuar me vëmendje, sikur e tërë qenia e saj ishte shndërruar në sy që vështrojnë me ngulm dhe veshë që dëgjojnë me kujdes. Mandej, i ati iu drejtua asaj:

“Ti ishe një foshnje në gji kur nëna jote e humbi babain e saj të plakur. Ishte pikëlluar shumë për humbjen e tij dhe qante si një i pangushëllueshëm. Mirëpo, sapo u kthye nga varrimi i të atit, u ul pranë meje në këtë dhomë, ma mori dorën dhe më tha:

‘Faris, babai im ka vdekur, por ti më mbete dhe ky është ngushëllimi im i vërtetë. Zemra, me ndjenjat e saj të degëzuara, i ngjan qiparisit me degët e tij të shpërndara.

Sa herë që druri i qiparisit e humb një degë të fortë, ndien dhembje, mirëpo nuk vdes, por e bart forcën e vet jetësore tek dega fqinje në mënyrë që ajo të rritet e të ngritet lart si dhe ta plotësojë vendin e degës së prerë me degë të reja’.

Kështu thoshte nëna jote, Selma, kur vdiq babai i saj. Kështu duhet të thuash edhe ti kur vdekja ta ketë marrë trupin tim në qetësinë e varrit dhe shpirtin tim nën hijen e Zotit”.

Duke ndier dhembje, Selma iu përgjigj:

“Nëna ime e humbi të atin, mirëpo i mbete ti, e kush do të më mbesë mua kur të të humb ty, baba? Babai i saj vdiq, mirëpo ajo kishte përkrahjen e burrit të dashur, të mirë e besnik. Babai i vdiq, mirëpo asaj i mbeti vajza e cila e fuste kokën e saj të vogël në gjinjtë e saj dhe me duart e saj e mbërthente për qafe. E kush do të më mbesë, vallë, mua, kur të të humb, baba? Ti për mua je baba dhe nënë, bashkëbisedues imi dhe edukator në rininë time, e kush do t’ m’i zëvendësojë këto kur ti të ikësh nga unë?”

Duke thënë këtë, i drejtoi kah unë sytë e saj të përbotur, ma preku skajin e veshjes sime me dorën e saj të djathtë dhe vazhdoi:

“Unë nuk kam askë tjetër përveç këtij miku, baba, dhe nuk do të më mbetet kush tjetër pos tij kur ti t’ më lësh. A thua, do të mund të ngushëllohem me të kur edhe ai të vuajë si unë? A mund ta ngushëllojë zemërthyeri një tjetër me zemër të thyer? Krijesa e pikëlluar nuk mund ta përballojë një pikëllim tjetër afër vetes, ashtu sikurse edhe pëllumbesha e cila nuk mund të fluturojë me krahët e thyer.

Ai është miku i shpirtit tim, megjithatë unë ia rëndova aq shumë barrën e tij me dhembjet e mia, sa që ia lakova shpinën. Me lotët e mi ia plagosa sytë ashtu që tani nuk shih gjë tjetër pos errësirës. Atë e kam vëlla të cilin e dua dhe më don, sikurse të gjithë vëllezërit. Merr pjesë në fatkeqësi, por nuk e lehtëson

dhe ndihmon në qarje duke i bërë lotët edhe më të hidhura dhe zemrën edhe më flakëruese”.

E dëgjoja Selmën duke folur derisa ndjenjat më gufonin e gjoksi më ngushtoj, ashtu që më dukej sikur brinjët do t’me pëlcitnin në britma e ulërime.

Ndërkaq, plaku e vështronte derisa trupi i tij i plogët molisej ngadalë mes jastëkëve dhe mbështetësve. Shpirti i tij i dërrmuar dridhej sikur flaka e fenerit në erë. Pastaj, i zgjati duart dhe tha qetë:

“Më lër të shkoj në paqe, bija ime. Sytë e mi tashmë vështrojnë prapa reve dhe nuk do t’i kthej sërish kah këto shpella. Më lër të fluturoj, duke qenë se me krahët e mi i kam thyer tanimë grilat e këtij kafazi. Nëna jote më ka thirrur, Selma, prandaj mos më ndal. Ja, era po bëhet e këndshme dhe po e shpërndan mjegullën nga deti i hapur, kështu që anija po i ngrit velat duke u përgatitur për lundrim. Mos e ndal anijen dhe mos ia shkul timonin. Lëre trupin tim të pushojë me ata që tashmë pushojnë, dhe lëre shpirtin tim të zgjohet, meqë agimi tashmë ka dalë, e ëndrra ka marrë fund. Ma dhuro puthjen e shpresës dhe mos derdh lotë të hidhur mbi trupin tim që të mos i pengosh barërat e lulet t’i thithin lëngjet e tij.

Mos derdh lotë dëshpërimi mbi dorën time, pasi, në atë rast prej saj do të mbijnë gjemba mbi varrin tim. Mos e vizato vijën në ballin tim me psherëtimat e dëshpërimit, meqë aty pranë mund të kalojë puhia e detit dhe ta e kuptojë, me ç’rast pluhuri i eshtrave të mia nuk do të mund të depërtojë te korijet e gjelbërta.

Të kam dashur gjatë jetës, bija ime, dhe do të të dua edhe në vdekje, ashtu që shpirti im do të mbesë edhe më tej pranë teje, të të mbrojë e ruajë”.

Plaku u drejtua kah unë, derisa qerpikët i ishin mbyllur deridiku, kështu që nuk shihja tjetër pos dy vijave të përhimta në

vend të syve. Më pas, derisa qetësia e shkrirjes i zbuste fjalët e tij, tha:

“Kurse ti, biri im, ji vëlla i Selmës ashtu siç ishte babai yt vëlla imi. Qëndro pranë saj në çastet e vështirësisë dhe ji mik i saj deri në fund. Mos e lër të pikëllohet, sepse pikëllimi për të vdekurit është njëri prej gabimeve të gjeneratave të mëhershme. Por, rrëfeji asaj tregimet e gëzimit dhe këndoji këngët e jetës ashtu që të kënaqet e të përpiqet të harrojë. Thuaji babait tënd të më përkujtojë. Kërko prej tij të të rrëfejë për ditët e kaluara kur rinia na rrethonte lart tek retë. Thuaji atij se e kam dashur përmes figurës së të birit në momentet e fundit të jetës sime”.

Për një çast plaku heshti, derisa jehonat e fjalëve të tij vazhdonin të kumbonin nëpër muret e dhomës. Mandej, sërish na shikoi mua dhe Selmën njëkohësisht dhe tha duke pëshpëritur:

“Mos e thirrni mjekun që me anë të pluhurave t’i zgjasë orët e burgimit tim, ngase ditët e robërisë tashmë kanë kaluar, kurse shpirti im kërkon liri në horizontin e gjerë. Mos e thirrni as priftin pranë shtratit tim, meqë “ngushëllimet e tij” nuk do t’i fshijnë mëkatet e mia nëse i kam bërë, e as nuk do t’më dërgojnë me shpejtësi në parajsë, nëse kam qenë mirëbërës. Vullneti i njeriut nuk e ndryshon dëshirën e Zotit, ashtu si edhe astronomët që nuk mund ta ndërrojnë orbitën e yjeve. Ndërsa, pas vdekjes, mjekët dhe priftërinjtë le të bëjnë ç’të duan, pasi, deti i hapur tani e thërret detin, kurse anija do të vazhdojë të lundrojë derisa të arrijë tek bregu”.

Në mesnatën e frikshme, Faris Kerame i hapi sytë e zhytur në errësirën e agonisë, i hapi për herë të fundit dhe i drejtoi kah bija e tij e gjunjëzuar pranë shtratit të tij. Pastaj, tentoi të fliste, por nuk mundte, duke qenë se vdekja tashmë ia kishte pirë zërin, kështu që nga buzët e tij përmes një grahme të thellë dolën vetëm këto fjalë:

“Ja, iku nata ... dhe erdhi dita ... Selma ... Selma ...”.

Pastaj, e vari kokën, fytyra iu zbardh, buzët i buzëqeshën dhe dha shpirt.

Selma e shtriu dorën dhe e preku dorën e të atit të cilën e ndjeu se ishte e ftohtë si bora. Pastaj, e ngriti kokën, e vështroi dhe pa se fytyrën e tij tanimë e kishte mbuluar velloja e vdekjes.

Ajo mbeti e shtangur në vend, kurse lotët i ishin tharë në fyt. Nuk lëvizte, nuk kukaste, e as nuk rënkonte, por mbeti me shikim të ngulitur në të, me sy të ngrira si të shtatores.

Gjymtyrët i kishte të molisura si skajet e rrobave të grisura, me ç’rast u rrëzua saqë balli ia preku tokën, e më pas tha qetë:

“Mëshiro, o Zot, dhe forcoji të gjithë krahët e thyer”.

Faris Kerame vdiq dhe përjetësia e përqafoi shpirtin e tij. Dheu e mori prapa trupin e plakut, ndërsa Mensur-beu e shtiu në dorë pasurinë e tij.

Bija e tij mbeti e burgosur në mjerimin e vet. Ajo e shihte jetën si një tragjedi që e pasqyronin tmerret para syve të saj.

Ndërkaq unë isha i humbur mes ëndrrave dhe shqetësimeve. Ditët dhe netët më shqyenin ashtu siç e shqyejnë shqiponjat mishin e viktimës.

Sa e sa herë kam tentuar të jepem me mish e me shpirt pas leximit të librave, me shpresë se do të gjeja prehje në figurat e atyre që i mbuloi koha! Sa e sa herë kam provuar ta harroj realitetin tim ashtu që me leximin e librave të shenjta të kthehem tek bota e gjeneratave të kaluara!

Megjithatë, e tëra shkoi kot. Për më tepër, unë i ngjaja atij që tentonte ta shuante zjarrin me vaj, meqë, në të gjitha gjeneratat unë nuk kam parë gjë tjetër pos figurave të zeza, ndërsa këngët e popujve të kaluar i kam dëgjuar vetëm si vajtime e kukatje.

Kështu, libri i Ejubit ishte më i bukur për mua sesa psalmet e Davudit. Elegjitë e Eremijas ishin më të dashura tek unë sesa

himni i Sulejmanit. Tragjedia e Bermekidëve më linte më shumë mbresë në shpirtin tim sesa madhështia e Abasidëve. Poema e Ibn Zurekut më mallëngjente më tepër sesa rubairat e Hajjamit. E rrëfimi i Hamletit ishte më afër zemrës sime nga çdo gjë që shkruan të huajt.

Kështu, dëshpërimi e dobëson largpamësinë tonë, prandaj i shohim vetëm siluetat tona të tmerrshme. Kështu, dëshpërimi na i mbyll veshët, prandaj nuk dëgjojmë gjë tjetër pos rrahjeve shqetësuese të zemrave tona.

NDËRMJET ASTARTËS DHE KRISHTIT

Mes atyre kopshteve e bregoreve të cilat me anët e malit të Libanit arrijnë deri tek skajet e Bejrutit, ndodhet një tempull i vogël i lashtë, i skalitur në zemrën e një shkëmbi të bardhë, i rrethuar nga drunjtë e ullirit, bajameve e plepave.

Ndonëse ky tempull nuk është më larg se gjysmë milje nga rruga ku kalojnë karrocat, të paktë janë ata dashamirës të antikiteve dhe gërmadhave të lashta që dijnë për të.

Ky tempull, sikur edhe shumë gjëra të tjera të rëndësishme në Siri, është fshehur me perdet e pakujdesisë. Sikur mospërfillja e ka lënë të fshehur nga sytë e dashamirësve të antikiteve për ta bërë një vend vetmie për shpirtrat e të dërrmuarve dhe vend vizite për të dashuruarit dhe të vetmuarit.

Ai që hyn në këtë tempull të çuditshëm, në murin e tij lindor sheh një afresk të vjetër fenikas, të gdhendur në shkëmb. Dora e fatit tashmë i kishte fshirë disa vija të tij, kurse pasojat e kohës i kishin ndryshuar disa shenja.

Afresku paraqet Astartën, perëndeshën e dashurisë dhe bukurisë, të ulur mbi një fron madhështor, e rrethuar nga shtatë virgjëresha lakuriqe të cilat qëndrojnë në pozita të ndryshme.

E para mban në dorë një pishtar, e dyta – kitarë, e treta – temjanicë, e katërta – një poç vere, e pesta – një degë luleje, e gjashta – një kurorë dafinash dhe e shtata – harkun dhe ca shigjeta.

Të gjitha ato e shikojnë Astartën, derisa fytyrat e tyre shprehin nënshtrim dhe përulje.

Në murin tjetër gjendet një tjetër afresk, më i ri dhe më i qartë i cili paraqet Krishtin e kryqëzuar, ndërsa pranë tij qën-

dron nëna e tij e pikëlluar, Marija Magdalena dhe dy gra të tjera të përlostura.

Kjo pikturë e stilit bizantin tregon se është punuar në shekullin e pestë apo gjashtë të erës sonë.

Në murin perëndimor ndodhen dy vrima të rrumbullakëta përmes të cilave depërtojnë rrezet e diellit në pikë të ditës, duke u derdhur mbi këto dy piktura, me ç'rast dukeshin sikur janë lyer me ujin e artë.

Në mes të tempullit ndodhet një gur i mermertë në formë katrori. Në anët e tij shihen skalitjet dhe vizatimet e stilit të vjetër, disa prej të cilave ishin mbuluar nga gjurmët e ngurosuras gjaku, gjë që tregon se njerëzit në kohën antike i prenin flijimet e tyre mbi këtë gur, si dhe derdhnin mbi të verë, aromë e vaj.

Asgjë tjetër nuk kishte në këtë tempull të vogël përveç një qetësie të thellë që e kaplonte shpirtin dhe një dinjiteti magjepsës që përmes lëkundjeve të veta i zbulon fshehtësitë e hyjnive, flet pa fjalë mbi fatet e gjeneratave të kaluara dhe mbi ecurinë e popujve nëpër shekuj, nga njëra gjendje në tjetrën dhe nga njëra fe në fenë tjetër.

Këto e joshnin poetin në një botë, të largët nga kjo e jona, ndërsa filozofin e bindnin se njeriu është një krijesë fetare, meqë ndien diçka që nuk e sheh dhe imagjinoi atë që nuk mund ta kapë me shqisë. Kështu, ndjenjat e veta i pikturon në formë simbolesh të cilat me domethënien e tyre vënë në pah sekretet e shpirtit, si dhe e personifikon imagjinatën e tij me fjalët, meloditë, pikturat e shtatore, të cilat me format e tyre shfaqin synimet e tij të shenjta në jetë dhe dëshirat më të bukura pas vdekjes.

Në këtë tempull të panjohur takohesha me Selmën një herë në muaj. Aty i kalonim orë të tëra duke i vështruar ato dy piktura të çuditshme, duke medituar për djaloshin e kryqëzuar

mbi Golgotë⁶ dhe duke i evokuar në imagjinatën tonë figurat e djelmoshave dhe vajzave fenikase të cilët jetonin, dashuronin dhe adhuronin bukurinë në pamjen e Astartës, me ç'rast i ndiznin aromat para shtatores së saj dhe derdhnin gjak me flimimet që i dërgonin. Më pas, toka i gëlltiti që të gjithë, ashtu që prej tyre nuk mbeti gjë tjetër pos emrit që e përsërit koha para fytyrës së përjetësisë.

Sa vështirë e kam tani t'i rrëfej me fjalë kujtimet e atyre çasteve që i kalova me Selmën! Ishin ato momentet qiellore, përplot me kënaqësi e dhembje, gëzim e pikëllim, shpresë e dëshpërim. Pra, e tërë ajo që e bën njeriun njeri, ndërsa jetën – një enigmë të përhershme.

Sado e kam vështirë ta e kujtoj atë kohë, nuk mund të mos tentoj ta paraqes me fjalë të pakta njërin prej atyre momenteve, me qëllim që të shërbejë si mostër për pasardhësit e dashurisë dhe dëshpërimit.

Tërhiqeshim në vetmi në atë tempull të vjetër dhe uleshim afër derës së tij, duke i mbështetur shpinat për mur dhe duke përsëritur jehonën e së kaluarës sonë.

Vuanim për të tashmen dhe i frikësoheshim së ardhmes. Pastaj, e shfaqnim ngadalë tërë atë që ndodhej në thellësitë e shpirtrave tanë, e secili prej nesh ankohej për dhembjen dhe zjarrin e zemrës dhe për vuajtjen dhe brengën e rëndë. Më pas, e inkurajonim njëri-tjetrin duke i shtruar nga shpresa brenda gjoksit iluzionet e gëzuara dhe ëndrrat e ëmbla.

Kështu, e qetësonim trishtimin, i thanim lotët dhe i kthjellonim fytyrat. Pastaj buzëqeshnim, duke harruar çdo gjë përveç dashurisë dhe gëzimeve të saj, duke lënë mënjanë gjithçka pos shpirtit dhe synimeve të tij.

⁶ Golgota – mali ku, sipas të krishterëve, u kryqëzua pejgamberi i Zotit, Isau. (shën. i përkth.)

Mandej përqafoheshim, duke u shkrirë nga dashuria e afshi. Selma e puthte shtegun e flokëve të mia, çiltërisht dhe me ndjenjë të thellë, duke e mbushur zemrën time me dritë, ndërsa unë ia puthja majat e gishtërinjve të saj të bardhë, derisa ajo i mbyllte sytë, e lakonte qafën e saj të fildishtë, kurse faqet e fitonin pamjen me një skuqje të butë që u ngjante rrezeve të para të cilat agimi i hedh mbi majat e kodrave.

Pastaj, heshtnim dhe shikonim gjatë në drejtim të horizontit të largët ku ndodhen retë e ngjyrosura me dritat e portokallta të mbrëmjes.

Takimet tona nuk përqendroheshin vetëm në këmbimin e ndjenjave dhe ankimeve, por ne kalonim edhe pa e vërejtur fare në gjëra të përgjithshme, me ç'rast i shkëmbenim mendimet e idetë rreth çështjeve të kësaj bote të çuditshme.

Diskutonim lidhur me mesazhet e librave që i kemi lexuar, duke i kujtuar njëherësh anët e tyre të mira e të këqija, paraqitjet imagjinare dhe parimet shoqërore.

Selma fliste rreth pozitës së gruas në shoqërinë njerëzore, rreth ndikimit të gjeneratave të kaluara në moralin dhe për synimet e saj, rreth lidhjes martesore në ditët tona si dhe rreth llojlloj sëmundjeve e çoroditjeve në ato lidhje.

Kujtoj se njëherë pati thënë:

“Shkrimtarët dhe poetët përpiqen ta rrokin realitetin e gruas, mirëpo deri më sot nuk arritën t'i kuptojnë sekretet e zemrës dhe shpirtit të saj, meqë e vështrojnë nëpër vellon e pasioneve, prandaj edhe nuk shohin gjë tjetër pos vijave të trupit të saj, apo e vendosin nën thjerrën e përbuzjes, duke parë në të vetëm dobësi dhe nënshtrim”.

Një herë tjetër, duke bërë me dorë kah dy piktura, të skalitura në muret e tempullit, kishte thënë:

“Në zemrën e këtij shkëmbi, gjeneratat kanë gdhendur dy simbole që shprehin thelbin e synimeve të gruas dhe zbulojnë sekretet e shpirtit të saj i cili jeton mes dashurisë dhe pikëllimit, mes simpatisë dhe flijimit, mes Astartës, të ulur mbi fron dhe Marisë e cila qëndron në fund të kryqit. Mashkulli blen famën, pushtetin dhe namin, mirëpo është femra ajo që paguan çmimin”.

Për takimet tona të fshehta nuk dinte askush përveç Zotit dhe tufës së zogjve që fluturonin nëpër ato kopshte.

Selma vinte me karrocë deri tek vendi i quajtur “Kopshti i Pashës”, e pastaj ecte ngadalë nëpër shtigjet e vetmuara derisa arrinte tek tempulli i largët, ku hynte e mbështetur në ombrellën e saj, e në fytyrë i dukeshin shenjat e sigurisë dhe qetësisë.

Më gjente duke e pritur me një përmallim të papërballueshëm, ashtu siç nuk përballohen dot uria e etja.

Asnjëherë nuk jemi frikësuar nga syri i spiunit, e as nuk kemi ndier brejtjen e ndërgjegjes, ngase shpirti i pastruar me zjarr dhe i larë me lotë, ngritet përmbi atë që njerëzit e quajnë ves e turp, lirohet nga robërimi ndaj ligjeve dhe parimeve që i kanë vendosur traditat për ndjenjat e zemrës njerëzore dhe qëndron kokëlartë para froneve të perëndive.

Shoqëria njerëzore tashmë shtatëdhjetë shekuj u nënshtrohet ligjeve të prapa dhe nuk është më në gjendje ta kuptojë domethënien e ligjeve qiellore, primare e të përhershme.

Syri i njeriut tanimë është mësuar ta shikojë dritën e qirinjve të dobët dhe nuk mund ta vështrojë më shkëlqimin e diellit.

Brezat kanë trashëguar njëri nga tjetri sëmundjet dhe veset shpirtërore, kështu që ato u bënë gjithëpërfshirëse, madje u bënë veçori të domosdoshme të njeriut, prandaj edhe njerëzit nuk i shohin më si vese e sëmundje, por i konsiderojnë si veçori të natyrshme fisnike të cilat Zoti ia dha njeriut.

Po të paraqitej në mesin e tyre ndonjë njeri pa ato veçori, do ta konsideronin të mangët dhe të privuar nga përsosuritë shpirtërore.

Sa u përket atyre të cilët do ta cenonin Selma Keramen, duke tentuar ta njollosin emrin e saj për shkak se e linte shtëpinë e bashkëshortit ligjor për t'u takuar në vetmi me një tjetër njeri, ata janë të sëmurët të shkretë të cilët njerëzit e shëndoshë i konsiderojnë kriminelë, ndërsa shpirtmëdhenjtë – kryengritës.

Përkundrazi, ata janë sikur insektet që zvarriten në errësi, duke u frikësuar të dalin në dritën e ditës që të mos i shtypin kalimtarët me këmbë.

I burgosuri pa të drejtë i cili mund t'i rrënojë muret e qelisë së tij, po nuk e bën këtë, është frikacak.

Selma Kerame ishte një e burgosur pa të drejtë dhe nuk mund të lirohej, prandaj a duhet të qortohet për shkak se nëpër dritarën e qelisë së saj shikonte fushat e gjelbërta dhe hapësirën e gjerë?

A do ta konsiderojnë njerëzit tradhtarë, ngase largohej nga shtëpia e Mensur bej-Galibit që të ulej pranë meje mes Astartës së shenjtë dhe kolosit të kryqëzuar?

Le të thonë njerëzit ç'të duan, mirëpo Selma i kapërceu moçalet në të cilat zhyten shpirtrat e tyre dhe arriti në atë botë tek e cila nuk mund të arrijë ulërima e ujqve dhe vërshëllima e gjarpërinjve.

Le të thonë njerëzit ç'të duan edhe për mua, por shpirtin i cili e ka parë fytyrën e vdekjes, nuk mund ta frikësojnë fytyrat e hajdutëve.

Luftëtari i cili i ka parë shpatat, të nxjerra nga milli mbi kokën e tij dhe përrenjtë me gjak që rrjedhin nën këmbët e tij, nuk çan kokën për guralecët të cilat i hedhin në të fëmijët e sokakëve.

FLIJIMI

Në një ditë kah fundi i qershorit, kur nxehtësia i kishte rënduar tashmë brigjet e detit, e njerëzit i kërkonin lartësitë e maleve, u nisa si zakonisht kah ai tempull duke shpresuar se do ta takoja Selmën.

Në dorë mbaja një libërth me poema andaluziane të cilat më linin përshtypje në atë kohë dhe vazhdojnë t'ua joshin shpirtin edhe sot e kësaj dite.

Arrita në tempull në mbrëmje dhe u ula ta vëzhgoj rrugën që çonte mes drunjve të limonit dhe shëlgut.

Kohë pas kohe ia hidhja sytë kopertinës së librit, duke pëshpëritur në eter vargjet *muveshshesh*⁷ të cilat e joshin zemrën me format e tyre sublime, me melodinë e metrin e tyre, të cilat e kthejnë kujtimin në famën e mbretërve, poetëve e kalorësve që e braktisën Granadën, Kordobën e Seviljen, duke i lënë në pallatet, kështjellat dhe kopshtet e tyre të gjitha shpresat e synimet, e më pas tretën prapa perdeve të kohës, me lotë në sy e dhembje në zemër.

Pas pak, u ktheva mbrapa dhe e pashë Selmën e cila ecte duke e tundur belin e saj të hollë mes drunjve të gërshetuar. Ajo po afrohej kah unë duke u mbështetur në ombrellën e saj, sikur bartte të gjitha brengat e hallet e kësaj bote.

Kur arriti pranë derës së tempullit dhe u ul afër meje, i shikova sytë e saj të mëdhenj dhe vëreja në ta disa botëkup-time e sekrete të reja dhe të çuditshme të cilat shprehnin kujdes e vëmendje, por edhe nxisnin kureshtje e informim.

⁷ Shih shënimin 3.

Selma ndjeu se diçka më vlonte në kokë dhe nuk deshi që unë të mundohem gjatë në mëdyshjet e mia. Prandaj, e vuri dorën mbi flokët e mia dhe më tha:

“Afrohu tek unë, afrohu tek unë, i dashur. Afrohu, ashtu që shpirti im krahas teje të jetë edhe më i madh, meqë u afrua çasti i cili do të na ndajë përgjithmonë”.

“Çfarë thua, Selma? Cila forcë mund të na ndajë përgjithmonë” – bërtita unë, kurse ajo ma ktheu:

“Forca e verbër e cila na ndau dje, do të na ndajë edhe sot. Forca memece e cila ligjet njerëzore i merr për komentues të saj, e ka ndërtuar me duart e robërve të jetës një mur të fortë mes nesh. Forca e cila i shpiku djajtë dhe i shndërroi në shenjtorë përmes shpirtrave të njerëzve, ka vendosur që të mos dal më nga ajo shtëpi, e ndërtuar nga eshtrat dhe kafkat”.

E pyeta:

“A e kuptoi burri yt që po takohemi, prandaj ke filluar t’i frikësohesh zemërimit dhe hakmarrjes së tij?”

Ajo m’u përgjigj:

“Burri im nuk më kushton vëmendje fare, e as nuk e di se si e kaloj kohën, pasi që u është përkushtuar tërësisht atyre vajzave të gjora të cilat varfëria i dërgon tek tregjet e sklevërve, me ç’rast parfumohen e pispilloren që t’i shesin trupat e tyre për një copë bukë, të gatuar me gjak e lot”.

I thashë:

“Ç’të pengon, atëherë, të vish në këtë tempull e të ulesh pranë meje, para madhështisë së Zotit dhe hijeve të gjeneratave? A je mërzhitur t’i shikosh sekretet e shpirtit tim, prandaj shpirti yt kërkon të përshëndetet e të ndahet?”

Me sy të mbushur me lotë, Selma tha:

“Jo, i dashur. Shpirti im nuk kërkon të ndahet prej teje, duke qenë se ti je gjysma e tij. Sytë e mi nuk janë mërzhitur duke të shi-

kuar ty, pasi ti je drita e tyre. Mirëpo, duke qenë se fati më kishte caktuar që t'i kaloj pengesat e jetës, e rënduar me pranga e zinxhirë, si mund të pranoj që hiseja jote e fatit të jetë sikur e imja?”

“Fol Selma, – i thashë – më trego gjithçka dhe mos më lër të humbur mes këtyre përgjithësimeve”.

“Nuk mund të të them gjithçka, – tha ajo – pasi që gjuha të cilën e lidhën dhembjet, nuk mund të flasë. Buzët, mbi të cilat është vulosur dëshpërimi, nuk mund të lëvizin. E tëra që mund të të them është se kam frikë për ty që të mos biesh në grackën e atyre të cilët mua m'i kurdisën kurthat dhe më kapën”.

“Çfarë don të thuash në të vërtetë, Selma? Kush janë ata prej të cilëve frikësohesh për mua?”

Selma e mbuloi fytyrën me dorën e saj dhe psherëtiu dhe mbshëm, e më pas tha:

“Mutran Galibi tashmë ka kuptuar se njëherë në muaj po dal nga varri në të cilin më ka vendosur”.

“A e di Mutrani se po takohesh me mua në këtë vend?” – e pyeta unë.

“Sikur ta dinte këtë, nuk do t'më shihje tani, të ulur pranë teje – tha ajo. Mirëpo, e kanë kapluar dyshimet dhe në kokë i vlojnë mendime të ndryshme. Ka dërguar spiunë të më ndjekin dhe i ka urdhëruar shërbëtorët që t'i spiunojnë lëvizjet e mia, ashtu që fillova të ndiej se shtëpia ku banoj dhe rrugët nëpër të cilat ec, janë përplot me sy që më vëzhgojnë, gishtërinj që bëjnë me shenjë kah unë dhe veshë që e dëgjojnë psherëtimën e mendimeve të mia”.

Selma uli kokën për një çast, e pastaj vazhdoi të fliste, derisa lotët i ridhnin nëpër faqe:

“Unë nuk ia kam frikën Mutranit për veten time, meqë i zhyturi nuk i frikësohet lagies, mirëpo kam frikë për ty, sepse ti që je i lirë si drita e diellit, mund të biesh si unë në kurthat e tij,

me ç'rast do të të mbërthejë e do të të shqyejë me thonjtë dhe dhëmbët e tij. Nuk ia kam frikën fatit, ngase i ka hedhur tashmë të gjitha shigjetat në gjoksin tim, mirëpo kam frikë për ty, duke qenë se ty që je në lulen e rinisë gjarpëri mund të t'i kafshojë këmbët dhe të ta ndërpresë ecjen kah maja e malit, ku të pret e ardhmja e gëzuar dhe e ndritur”.

Unë i thashë:

“Ai të cilin nuk e kafshojnë gjarpërinjtë e ditës dhe nuk e shqyejnë ujqit e natës, mbetet i humbur si gjatë ditës ashtu edhe gjatë natës. Mirëpo, dëgjo Selma, më dëgjo me kujdes. A nuk kemi zgjidhje tjetër pos ndarjes, për t'u ruajtur nga poshtërsia e njerëzve dhe të këqijat e tyre? A thua, janë mbyllur para nesh rrugët e dashurisë, jetës dhe lirisë, kështu që nuk na mbeti gjë tjetër pos nënshtrimit ndaj dëshirës së robërve të vdekjes?”

Me një ton, të përfshirë nga dëshpërimi e keqardhja, Selma tha:

“Na mbetet vetëm përshëndetja dhe ndarja”.

E kapa për dore, derisa shpirti im thellë brenda meje shpërrthente me furi, e nga zjarri i rinisë sime tymi shpërndahej gjithandej.

Atëherë, i eksituar thashë:

“U jemi nënshtruar për një kohë të gjatë tekave të njerëzve, Selma. Që nga ai çast kur jemi takuar për herë të parë e deri më tani, ne iu nënshtrohemi të verbërve dhe përulemi para idhujve të tyre. Që kur të njoha, ne jemi në duart e Mutran Galibit si dy topa me të cilët ai luan si të dëshirojë dhe na gjuan ku të dojë. Vallë, do të mbetemi të bindur ndaj tij, duke i ngulur sytë në errësirën e shpirtit të tij derisa t'na mbulojë dheu e t'na përpijë toka? A thua, Zoti na ka dhuruar frymën e jetës që ta vëmë nën këmbët e vdekjes? A na ka dhënë lirinë që të jetojmë të robëruar nën hijen e saj? Ai që e shuan zjarrin e shpirtit të tij me

dorën e vet, i tilli është mosmirënjohës ndaj qiellit i cili e ndezi atë zjarr. Ai që e duron padrejtësinë dhe nuk ngre krye kundër dhunës, konsiderohet aleat i së shtrembërës kundrejt së vërtetës dhe ortak i atyre që derdhin gjakun e të pafajshmëve. Unë të desha, Selma, e edhe ti më deshe mua, kurse dashuria është një thesar i shtrenjtë të cilin Zoti e mbjell tek shpirti i madh e i ndieshëm. Atëherë, a do ta hedhim, vallë, thesarin tonë në vathat e derrave që ta shpërndajnë me feçkat e tyre e ta shkelin me këmbë? Para nesh është një botë e gjerë, e mbushur me bukuri e çudira. Përse atëherë duhet të banojmë në këtë tunel të ngushtë të cilin e gërmuan Mutrani dhe argatët e tij? Para nesh është jeta e lirë dhe e tërë kënaqësia e lumturia që ngërthehet në liri. Përse, pra, të mos e heqim zgjedhën e rëndë nga qafat tona e t'i thyejmë prangat e forta nga këmbët, dhe më pas të nisemi drejt rehatisë e qetësisë?

Eja Selma, të ikim nga ky tempull i vogël tek faltorja madhështore e Zotit! Eja të largohemi nga ky vend dhe nga skllavëria e marrëzia që mbretërojnë në të, e të drejtohem kah viset e largëta ku nuk arrijnë duart e hajdutëve, e as nuk mbërrijnë cytjet e djajve.

Eja, të nxitojmë kah bregu nën përcjelljen e natës dhe të him në anijen e cila do t'na dërgojë prapa deteve, ku do të jetojmë një jetë të re, të mbushur me çiltërsi e mirëkuptim, ku gjarpërinjtë nuk do t'na fryjnë me frymat e tyre, e as egërsirat nuk do t'na shkelin me këmbë.

Mos ngurro, Selma, pasi që këto momente janë më të shtrenjta se kurorat e mbretërve dhe më të larta se sekretet e engjëjve. Eja të shkojmë pas shtyllës ndriçuese, e cila do t'na nxjerrë nga kjo djerrinë e fishkur tek fushat ku mbijnë lule dhe borzilokë”.

Selma tundi kokën, sa kohë që i kishte zgurdulluar sytë në diçka të padukshme në hapësirën e atij tempulli. Në buzët e saj

u shfaq një buzëqeshje pikëlluese e cila shprehte vuajtje e dhembje në shpirtin e saj. Pastaj tha qetë:

“Jo, jo i dashur. Qielli tashmë ka vënë në dorën time një gotë, të mbushur me helm e vrer dhe unë e kam pirë të kulluar, e në të mbetën vetëm edhe disa pika të cilat do t’i pi me durim ashtu që të zbuloj se çfarë sekretesh fshihen në fundin e saj.

Sa i përket jetës së re e madhështore, të mbushur me dashuri, rehati e siguri, unë nuk e meritoj, e as nuk kam mundësi t’i përballoj gëzimet dhe kënaqësitë e saj, ngase zogu me krahët e thyer zvarritet mes shkëmbinjeve dhe nuk mund të fluturojë në lartësi.

Sytë e sëmurë mezi i shohin gjërat e zbehta, ndërsa dritat shndritëse nuk mund t’i vështrojnë fare. Prandaj, mos më fol për lumturi, meqë vetë përmendja e saj më dhemb sikurse mjerimi. Mos ma përshkruaj kënaqësinë, ngase hija e saj më frikëson sikur vuajtja. Mirëpo, shikoje hirin e gjoksit tim. Ti e di se unë të dua si nëna të vetmin e saj, e ajo është dashuri e cila më mësoi të të mbroj edhe nga vetja ime.

Ajo është një dashuri e pastruar me zjarr, e cila më pengon tani që të vij me ty në tokën e largët dhe më shtyen t’i varros ndjenjat dhe ambiciet e mia në mënyrë që ti të jetosh i lirë, i pastër dhe i sigurt nga smira e njerëzve dhe përgojimet e tyre të poshtëra.

Dashuria e kufizuar kërkon zotërimin e të dashurit, ndërsa dashuria e pakufishme nuk kërkon gjë tjetër pos vetë qenien e saj. Dashuria e cila zhvillohet aty diku mes vrullit të rinisë dhe shkujdesjes së saj, kënaqet me takime, i mjafton bashkimi dhe rritet me puthje e përqafime. Ndërkaq, dashuria e cila lind në prehërin e pafundësisë dhe zbret tek ne me sekretet e natës, kënaqet vetëm me përhershmërinë, e pranon vetëm përjetësinë dhe qëndron me përulje vetëm para Zotit.

Kur mësova dje se Mutran Galibi dëshiron t’më pengojë që të dal nga shtëpia e nipit të tij, e t’më privojë nga kënaqësia e

vetme që e kam ndier që kur jam martuar, u ndala para dritares së dhomës sime dhe i hodha sytë kah deti, duke vrarë mendjen rreth asaj se çfarë ka në ato vende të largëta dhe se çfarë është liria e vërtetë dhe pavarësia personale.

E paramendova veten duke jetuar pranë teje, e rrethuar me imagjinatat e shpirtit tënd dhe e zhytur në dhembshurinë tënde, mirëpo këto ëndrra të cilat i ndriçojnë kraharorët e grave të shtypura dhe i nxisin që të ngriten kundër traditave të kota ashtu që të jetojnë nën hijen e së vërtetës e lirisë, sa herë që më vinin ndërmend, më bënë ta nënvlerësoj e ta nënçmoj edhe më shumë veten time, ashtu që dashurinë tonë e shihja të dërrmuar e të kufizuar në atë masë, saqë nuk ka fuqi të qëndrojë para diellit.

Kam qarë sikurse mbreti i cili e humbi mbretërinë dhe si pasaniku i cili mbeti pa pasuri. Megjithatë, sapo e shikova nëpër lotë fytyrën tënde dhe pashë se si më vështroon ngultas, për njëherë m'u kujtua se ç'më kishe thënë njëherë:

'Eja Selma, të qëndrojmë para armiqve, duke i pritur tehat e shpatave me gjoksat tanë. Nëse pësojmë, do të vdesim si dëshmorë, e nëse ngadhënjëjmë, do të jetojmë si heronj, pasi, vuajtja e shpirtit, të patundur para fatkeqësive e mundimeve është më e nderhme sesa nënshtrimi për hir të sigurisë dhe rehatisë'.

Kështu më thojë, i dashur, kur rrihnin krahët e vdekjes mbi shtratin e të atit tim. Dje e kuptova këtë, derisa krahët e dëshpërimit goditnin rreth kokës sime, me ç'rast u forcova e u trimërova dhe duke qenë në burgun e errët fillova të ndiej një lloj lirie shpirtërore e cila i shpërfill vështirësitë dhe nuk çan kokën për vuajtje.

Kuptova se dashuria jonë ishte e thellë si deti, e lartë si yjet dhe e gjerë si gjithësia. Ja, sot erdha te ti me një forcë të re në shpirtin e dhembshëm e të rraskapitur, një shpirt i cili është në

gjendje të flijojë një gjë të madhe për të arritur diçka edhe më të madhe. Jam në gjendje ta flijoj lumturinë time pranë teje me qëllim që ti të mbetesh i ndershëm para syve të botës, larg nga tradhtia dhe torturat e tyre.

Më herët vija në këtë vend me pranga të rënda në këmbët e mia të dobëta, ndërsa sot erdha me një ndjenjë vendosmërie e cila nuk çan kokën për prangat e rënda dhe rruga i duket më e shkurtër.

Më herët vija si një vegim i frikshëm, kurse sot erdha si një grua e vërtetë e cila ndien nevojën e flijimit duke ditur vlerën e dhembjeve, dhe e cila dëshiron ta mbrojë të dashurin nga njerëzit e marrë dhe nga shpirti i saj i uritur.

Më parë ulesha pranë teje si një hije dridhëse, ndërkaq sot erdha të ta tregoj qenien time reale para Astartës së shenjtë dhe Krishtit të kryqëzuar.

Isha një pemë që rritej në hije, kurse sot i kam zgjatur degët me qëllim që të përtëriten në dritën e ditës.

Erdha të përshëndetem me ty, i dashur, prandaj le të jetë lamtumira jona madhështore e mbresëlënëse sikurse dashuria jonë. Le të jetë lamtumira jonë sikur zjarri i cili e shkrin arin që ta bëjë edhe më shkëlqyes”.

Selma nuk më la mundësi që të flas e të protestoj, madje më vështroi me sy të shndritur, ashtu që shkëlqimi i tyre e përfshiu tërë qenien time. Shenjat e fytyrës ia mbulonte një vello e dinjitetit dhe suptilitetit, me ç’rast dukej si një mbretëreshë e cila ngjall heshtje dhe përulje.

Pastaj, u hodh në kraharrorin tim me një lloj ndjenje të fortë çfarë nuk kam parë tek ajo para atij çasti, ma mbështolli qafën me duart e saj të buta dhe m’i puthi buzët me një puthje të gjatë, të thellë e të zjarrtë, e cila ngjalli jetë në trupin tim, nxiti sekretet e fshehta në shpirtin tim dhe bëri që qenia fizike të cilën e quaj ‘unë’ të ngritet kundër tërë botës ashtu që të përulet

e heshtur para ligjit qiellor, i cili zemrën e Selmës e bëri tempull, kurse shpirtin e saj – altar.

Kur përëndoi dielli dhe dalëngadalë u zhdukën edhe rrezet e tij të fundit nga kopshtet e parqet, Selma nisi të dridhej, e mandej qëndroi në mes të tempullit duke i shikuar gjatë muret dhe qoshet e tij, sikur dëshironte ta derdhte dritën e syve të saj nëpër ato vizatime e simbole. Më pas, eci pak përpara dhe u gjunjëzua me përulje para afreskut të Jezusit, duke ia puthur disa herë pandërprerë këmbët e tij të plagosura. Pastaj, pëshpëriti:

“Ja, e kam zgjedhur kryqin tënd, o Jezu Krisht, duke i lënë mënjatë të kremtet dhe gëzimet e Astartës. Mbi kokë kam vënë kurorë me gjemba në vend të kurorës me dafina. Jam larë me gjakun dhe lotët e mi në vend të parfumave të llojlojshme dhe kam pirë helm e vrer me gotën e cila është bërë për ujë e verë. Prandaj, më prano mes pasuesve tu të cilët janë të fortë me dobësinë e tyre. Më dërgo me butësi kah Golgota, sikur ata që të zgjodhën ty, të kënaqur me dhembjet e tyre dhe të lumtur me dëshpërimin e zemrave të tyre”.

Pastaj, u drejtua dhe u kthye kah unë duke thënë:

“Tani, do të kthehem e gëzuar në shpellën e errët ku vallëzojnë fantazmat e frikshme. E ty i dashur, mos të të vijë keq për mua dhe mos u pikëllo për shkak timin, ngase shpirti i cili sheh njëherë mëshirën e Zotit, nuk u frikësohet më pas as vetë dajve. Syrin, i cili stoliset njëherë me një shkëlqim të engjëjve, nuk mund ta mbyllin tëra vuajtjet e fatkeqësitë e kësaj bote”.

Mandej, Selma doli nga ai tempull, e mbështjellur me rrobat e saj të mëndafshhta dhe më la të habitur, të humbur e të zhytur në mendime, duke u sorollatur në botën e vizioneve ku hyjnitë ulen mbi frone, ku engjëjt i regjistrojnë veprat e njerëzve, ku shpirtrat i rrëfejnë dramat e jetës, e ku nuset e imagjinatës i recitojnë poemat e dashurisë, pikëllimit dhe përjetësisë.

Kur erdha në vete nga kjo dehje, e nata tashmë e kishte përfshirë botën me vrullet e saj, vërejta se jam duke bredhur mes atyre kopshteve, duke tentuar ta kthej në kujtesë jehonën e çdo fjale që e shqiptoi Selma, duke ia kthyer shpirtit tim lëvizjet dhe qetësinë e saj, vijat e fytyrës së saj dhe prekjen e butë të duarve, derisa më në fund e kuptova realitetin e ndarjes dhe dhembjen e vetmisë e cila do të vijë pas pak.

Përmallimi i hidhur ma paralizonte idenë e ma copëtonte zemrën dhe atëherë kuptova për herë të parë se njeriu, ndonëse lind i lirë, prapëseprapë ai vazhdon të mbetet rob i ligjeve të ashpra të cilat i vendosën stërgjyshërit e tij dhe se fati të cilin e përfytyrojmë si mister të pakapshëm, në fakt paraqet nënshtrimin e së sotmes ndaj ndodhive të së djeshmes dhe përluljen e së nesërme përmes kërkesave të së sotmes.

Sa e sa herë, që nga ajo natë e deri në këtë moment, kam vrarë mendjen rreth ligjeve të shpirtit të cilat e shtynë Selmën ta zgjedh vdekjen në vend të jetës!

Sa e sa herë e kam vënë karakterin e flijimit përballë lumturisë së rebelëve që të shoh se ç'është më madhështore dhe më suptile, mirëpo deri më tani kam arritur të kuptoj vetëm një fakt, e ai është se:

“Sinqeriteti, të gjitha veprimet i bën të bukura e të ndershme, kurse Selma Kerame ishte vetë personifikimi i sinqeritetit dhe vetë mishërimi i besimit të drejtë”.

SHPËTIMTARI

Edhe pas pesë vitesh nga martesë, Selma nuk lindi fëmijë, i cili me praninë e tij do të krijonte lidhje shpirtërore mes asaj dhe bashkëshortit të saj dhe me buzëqeshjet e tij do t'i afronte shpirtrat e tyre të ndryshme, ashtu siç e bashkon agimi fundin e natës me fillimin e ditës.

Gruaja sterile është e urryer gjithkund, duke qenë se egoizmi ua përfiton shumicës së njerëzve vazhdimësinë e jetës në trupat e bijve të tyre, prandaj edhe dëshirojnë pasardhës që të mbesin përjetësisht në tokë.

Njeriu materialist e vështroi gruan e tij sterile në atë mënyrë që sheh në të vetëvrasjen e vet të ngadalshme, prandaj edhe ndien neveri ndaj saj, e braktis dhe dëshiron që ajo të vdesë, sikur ajo është një armik i pabesë i cili dëshiron ta vrasë atë.

Mensur-bej Galibi ishte një materialist si toka, i ashpër si çeliku dhe i pangopur si varreza.

Dëshira për të pasur një djalë i cili do ta trashëgonte emrin dhe prestigjin e tij bëri që ai ta urrejë Selmën e gjorë, e bukuria e saj në sytë e tij u shndërrua në vese të ferrit.

Pema e cila rritet në shpellë, nuk jep fryte. E Selma Kerame "rritej" në hijen e jetës, prandaj nuk lindte fëmijë. Bilbili nuk ndërton fole në kafaz që të mos ua lë në trashëgimi robërinë zogjve të vet.

Edhe Selma Kerame ishte e burgosur në vuajtje, prandaj qielli nuk e ndau jetën e saj në dy sklevër.

Lulet e luginave përbëjnë fëmijë të cilët i lindin dashuria dhe mëshira, ndërkaj Selma Kerame nuk ndjeu asnjëherë fry-

mën e mëshirës dhe prekjen e dashurisë në atë shtëpi të madhe, të ngritur në breg të detit, në pjesën kryesore të Bejrutit.

Megjithatë, në qetësinë e natës ajo vazhdimisht lutej duke iu përgjëruar qiellit për t'ia dhuruar një fëmijë i cili me gishtërinjtë e tij ngjyrë trëndafili do t'ia fshinte lotët dhe me shkëlqimin e syve të tij do t'ia largonte nga zemra fantazmën e vdekjes.

Selma lutej duke ndier dhembje, derisa e tërë bota u mbush me lutje e përgjërim. Ajo kërkoi ndihmë me përlulje derisa vajtimi i saj i çau retë, kështu që qielli e dëgjoi thirrjen e saj dhe futi në barkun e saj frytin që deh me ëmbëlsinë dhe hijeshinë e tij.

Pas pesë vitesh nga martesja e saj, e përgatiti që të bëhet nënë, duke ia larguar njëherësh ndjenjën e nënçmimit dhe sterilitetit.

Pema që rritej në shpellë, më në fund lulëzoi që të japë fryte. Bilbili, i burgosur në kafaz, tashmë i është përkushtuar thurjes së folesë nga puplat e krahëve të tij.

Kitara, e cila është hedhur nën këmbë, tani është vënë në fladin e mëngjesit, ashtu që telat e mbetur të lëvizin me dallgët e tij.

Selma e gjerë i kishte zgjatur duart e saj të lidhura me pranga, me qëllim që ta pranojë dhuratën e qiellit.

Ndër gëzimet e jetës nuk ka diçka që i ngjason gëzimit të gruas sterile kur ligjet e përjetësisë e përgatisin që të bëhet nënë.

E tërë bukuria në zgjimin e pranverës dhe i gjithë gëzimi, i përmbledhur në ardhjen e agimit bashkohen në kraharorin e gruas të cilën Zoti më parë e privoi, e mandej ia dhuroi.

Nuk ekziston dritë më e fortë dhe më shkëlqyese sesa rrezet të cilat i shpërndan embrioni, i mbyllur në errësirën e barkut të së ëmës.

Prilli tashmë kishte mbërritur duke lëvizur mes kodrave e shpateve kur erdhi koha që Selma të lind fëmijën e parë.

Edhe natyra sikur ishte dakorduar dhe ishte marrë vesh me të, me ç'rast filloi t'i çelë lulet dhe me ngrohtësinë e shpërgënjve t'i mbështjellë barërat dhe jaseminët e njomë.

Kaloi edhe muaji në të cilin Selma e priste lindjen, ashtu siç e pret udhëtari daljen e yllit të mëngjesit. Me lotë në faqe e shikonte të ardhmen të cilën e shihte si ndriçon, ndërkaq gjërat të cilat dikur ishin të errëta, tani po shkëlqenin.

Një natë, derisa hijet e errësirës vërtiteshin nëpër ato shtëpi në pjesën kryesore të Bejrutit, Selma ishte shtrirë në shtratin e lindjes e dhembjeve, me ç'rast u paraqitën vdekja dhe jeta që të përlesheshin pranë shtratit të saj.

Mjeku dhe mamia u përgatitën që ta pranojnë në këtë botë një mysafir të ri. Lëvizjet e kalimtarëve të rrugës pushuan, e melodia e dallgëve të detit filloi të ulet, kështu që në tërë atë lagje nuk u dëgjua gjë tjetër pos një britme të tmerrshme që dilte nga dritaret e shtëpisë së Mensur-bej Galibit.

Ishte ajo një britmë e ndarjes së një jete nga tjetra, britmë e dashurisë së përjetësisë në hapësirën e asgjësë dhe mosekzistencës, britmë e forcës së kufizuar të njeriut para qetësisë së forcave të pafundme, britmë e Selmës së dobët, të shtrirë nën këmbët e dy viganëve: vdekjes dhe jetës.

Në agun e dritës, Selma lindi djalë. Sapo e dëgjoi klithjen e tij, ajo i hapi sytë, të mbyllura me dhembje, vështroi rreth e rrotull dhe i pa fytyrat e ngazëlluara në skajet e asaj dhome.

Kur shikoi sërish, hetoi se si jeta dhe vdekja edhe më tej përlesheshin pranë shtratit të saj. Selma përsëri i mbylli sytë dhe klithi për herë të parë: "Biri im!"

Mamia e mbështolli foshnjën në shpërgënj dhe e vendosi pranë së ëmës. Mjeku, ndërkaq, e vështroi Selmën me sy të pikëlluar dhe herë pas here e tundte kokën i heshtur.

Zhurma e gëzimit i zgjoi ca fqinj të cilët me pizhame erdhën për t'ia uruar babait lindjen e djalit. Mjeku edhe më tutje, me sy të pikëlluar, e vështronte nënën dhe djalin e saj.

Shërbëtorët nxituan te Mensur-beu që të marrin myzhde për lindjen e trashëgimtarit dhe t'i mbushin duart me dhuratat e tij. Kurse mjeku qëndronte njësoj, duke e vështruar pandërprerë Selmën dhe birin e saj me një shikim dëshpërues.

Kur lindi dielli, Selma e afroi djalin e saj te kraharoni, me ç'rast ai i hapi sytë për herë të parë dhe hodhi shikim kah sytë e së ëmës. Pastaj, përnjëherë u dridh dhe i mbylli sytë përgjithmonë.

Mjeku u afrua dhe e mori atë nga duart e saj, derisa dy pika të mëdha loti i rodhën nëpër faqe, me ç'rast pëshpëriti në vete: "Erdhi e shkoi".

Djali vdiq, derisa banorët e lagjes dëfreheshin pa pushim me Mensur-beun në sallën e madhe ku ngrenin dolli që fëmija të rrojë gjatë.

Selma e gjorë e vështronte mjekun me ngulm, e pas pak klithi: "Ma jep djalin tim ta përqafoj!"

Kur sërish vështroi kujdesshëm, Selma pa se vdekja dhe jeta ende po përlesheshin pranë shtratit të saj.

Djali vdiq, derisa kërcëllima e gotave bëhej edhe më e zhurmshme në duart e atyre që dëfreheshin për lindjen e tij.

Lindi në agim, kurse vdiq gjatë lindjes së diellit.

A thua, cila qenie njerëzore mund ta masë kohën që t'na informojë se a është koha që kalon nga agimi deri në lindjen e diellit më e shkurtër se ajo që kalon nga momenti kur popujt paraqiten e zhduken?

U lind si ide, e vdiq si psherëtimë dhe u "fsheh" si hije.

Ai bëri që Selma të shijojë shijen e amësisë, mirëpo nuk mbeti në jetë që ta bëjë të lumtur dhe ta e largoj dorën e vdekjes nga zemra e saj.

Një jetë e shkurtër që filloi nga fundi i natës dhe mbaroi në fillim të ditës.

Ishte kjo një jetë sikurse pika e vesës të cilën e derdhin qerpikët e errësirës, e pastaj e thajnë prekjet e ndriçimit.

Një fjalë të cilën e shqiptuan ligjet e përjetshme, e më pas u penduan për këtë dhe e kthyen në qetësinë e përhershmërisë.

Një margaritar të cilin batica e hedh në breg, e më pas zbatua e rrëmben në thellësitë e detit.

Një zambak i cili sapo nisi të bulëzojë nga sytha, përnjëherë u thërrmua nën këmbët e vdekjes.

Një mysafir i çmuar të cilin Selma e priste me padurim, mirëpo sa erdhi, përnjëherë shkoi. Posa i hapi dyert e derës, menjëherë u zhduk.

Një foshnje e cila nuk arriti të bëhej fëmijë, por përnjëherë u shndërrua në dhé.

E këtillë është jeta e njeriut, madje edhe jeta e popujve. Poashtu, e këtillë është edhe jeta e diejve, hënave e yjeve.

Selma e drejtoi shikimin kah mjeku, psherëtiu me një përmallim të dhembshëm, e më pas bërtiti:

“Ma jep birin tim ta përqafoj ... ma jep djalin tim t’i jap gji”.

Mjeku e uli kokën dhe duke gulçitur, tha:

“Biri juaj ka vdekur, zonjë. Prandaj, përmbajeni veten dhe kini durim që të jetoni pas tij”.

Atëherë, Selma klithi trishtueshëm, e pastaj për një çast u qetësua. Mandej, buzëqeshi gëzueshëm e hareshëm, kurse fytyra i shndriti, sikur kishte kuptuar diçka që më parë nuk e dinte.

Më pas, tha qetë:

“Ma jep trupin e djalit tim. Ma afro të vdekur”.

Mjeku e mori fëmijën e vdekur dhe e vendosi në duart e saj. Ajo e shtrëngoi në kraharor, e ktheu shikimin kah muri dhe filloi t’i fliste:

“Ti ke ardhur t’me marrësh mua, biri im. Ke ardhur t’ma dëftosh rrugën që çon kah bregu. Ja ku jam, biri im, prandaj ec para meje që të ikim bashkë nga kjo shpellë e errët”.

Pas pak, rrezet e diellit hynë nëpër perdet e dritares dhe shpërndaheshin mbi dy trupa të pajetë, të shtrirë në një shtrat mbi të cilin vigjilonte dinjiteti i amësisë dhe të cilit i bënë hije krahët e vdekjes.

Mjeku doli prej asaj dhome duke qarë, e kur mbërriti në sallën e madhe, klithjet e atyre që uronin u shndërruan në britma e kukama.

Ndërkaq, Mensur-bej Galibi, as nuk bërtiti e as nuk pshe-rëtiu. Nuk derdhi as edhe një lot dhe nuk tha asnjë fjalë, por mbeti i shtangur dhe i drejtuar si një statujë, derisa mbante go-tën e pijes në dorën e djathtë.

Ditën e nesërme, Selmën e mbështollën me rrobat e bardha nusërie dhe e vendosën në një arkivol, të qëndisur me kadife shndritëse.

Ndërkaq, qefinët e fëmijës ishin shpërgënjtë, arkivoli i tij – prehëri i së ëmës, kurse varri i tij – kraharori i saj i qetë.

I bartën dy trupa në një arkivol të vetëm dhe ecnin ngadalë, me një ritëm që u ngjasonte rrahjeve të zemrës në gjoksat e atyre që janë në agoni.

Kështu ecnin përcjellësit, e edhe unë në mesin e tyre, ndërkaq ata nuk më njihnin, e as nuk parandienin se ç’po ndodh me mua.

Kur arritën tek varreza, Mutran Galibi u shpërfaq duke lexuar e kënduar, ndërsa priftërinjtë e tjerë qëndronin rreth tij duke kënduar e bekuar, derisa në fytyrat e tyre të errëta vërehej shprehja e gjakftohtësisë dhe pakujdesisë.

Kur e lëshuan arkivolin në gropën e thellë, dikush pësh-përiti:

“Kjo është hera e parë që po shoh dy trupa, të varrosur në një arkivol”.

Tjetri tha:

“Fëmija erdhi që ta merr me vete të ëmën dhe ta e shpëtojë nga tortura e të shoqit”.

I treti, ndërkaq, shtoi:

“Vështrojeni me kujdes fytyrën e Mensur-beut! Ai po shikon në horizont me sy të kthjellët, sikur nuk e humbi gruan dhe të birin në një ditë”.

Dikush tjetër tha:

“Që nesër, xhaxhai i tij Mutrani do ta martojë me ndonjë grua tjetër, më të pasur e më të përmbajtur”.

Priftërinjtë pandërprerë këndonin e bekonin derisa varrmihësi e mbuloi gropën me dhé, me ç’rast përcjellësit e pranishëm në varrim, një nga një filluan t’u afroreshin Mutranit dhe nipit të tij, duke u shprehur ngushëllim dhe mbështetje me fjalë të ëmbla.

Ndërkaq unë po qëndroja në këmbë, i vetmuar dhe askush nuk vinte të më ngushëlloj për fatkeqësinë time, sikur Selma dhe djali i saj nuk ishin personat më të afërt tek unë.

Përcjellësit u kthyen, ndërkaq varrmihësi po qëndronte pranë varrit të ri, derisa në duar mbante lopatën e kazmën.

Unë iu afrova dhe e pyeta:

“A të kujtohet ku është varri i Faris Kerames?”

Ai më vështroi gjatë, e më pas bëri me shenjë kah varri i “Selmës” dhe tha:

“Në këtë gropë, bija e tij është shtrirë mbi gjoksin e babait, e mbi gjoksin e së bijës është shtrirë djali i saj. Mbi të gjithë ata kam hedhur dhé me këtë lopatë”.

Unë i thashë:

“Në këtë gropë është varrosur gjithashtu edhe zemra ime, njeri. Sa të forta janë duart tua!”

Kur varrmihësi u largua prapa drunjve të qiparisit, mua më tradhtoi durimi e vetëpërmbajtja, kështu që u hodha mbi varrin e “Selmës”, duke qarë e duke vajtuar.

Xhubran Halil Xhubran ka lindur në Liban, në vitin 1883. Pjesën më të madhe të jetës e ka kaluar në SHBA, ku edhe ka vdekur në vitin 1931. Ai konsiderohet njëri prej shkrimtarëve më të mëdhenj bashkëkohorë dhe për më shumë se gjysmë shekulli gëzon famë botërore të njërës prej poetëve më të lexuar të kohës sonë. Është autor i shtatëmbëdhjetë veprave të ndryshme. Ka shkruar njëloj suksesshëm si në gjuhën arabe, po ashtu edhe në atë angleze.

Krahët e thyer konsiderohet njëri prej romaneve më të njohura të tij në gjuhën arabe, madje paraqet njërën prej përpjekjeve të para të romanit arab. Për herë të parë vepra u botua në fillim të vitit 1912, nga botuesi *Mir'atu-l-garb*, në Njujork dhe për më shumë se katër dekada, ishte libri më i shitur në tërë botën arabe. Pas një shekulli nga dalja në dritë e botimit të parë të veprës në gjuhën arabe, lexuesit shqiptar i ofrohet përkthimi i romanit nga burimi origjinal.

Përkthyesi

Shënimi i katalogut CIP të këtij libri ndodhet në
Bibliotekën Kombëtare Universitare "Shën Kliment Ohridski", Shkup

821.411.21'06-31

821.411.21'06-31.09 Xhubran, H.

XHUBRAN, Halil

Krahët e thyer / Halil Xhubran; përktheu nga arabishtja

Jahja Hondozi. - Shkup: Logos-A, 2013. - faqe 120; 20 cm. -
(Biblioteka Divan)

Titulli në origjinal në gjuhën arabe. - Φ usnota drejt tekstit.

- Shënime për autorin: faqe. [117]. - Parathënie: faqe. 7-19

ISBN 978-9989-58-489-3

a) XHUBRAN, Halil (1883-1931) - Kritika dhe interpretime

COBISS.MK-ID 93979658

www.logos-a.com

Copyright©Logos-A, 2013



LOGOS-A



LOGOS·A